

Tregimi “Kërxfhaliu” i **Pushkinit**, dy skica origjinale të tij për **luftëtarët shqiptarë** dhe kontaktet ruso-shqiptare në Besarabi



(fq.8)

nga Dr Dorian Koçi

SHËNIME PËR LIBRAT

Romani “Pikaso prej ajri”, botuar
nga Buzuku, Prishtinë

PIKASO MODERN I ROLAND GJOZËS

Nga Behar Gjoka

(fq.7)

Gjoza me tregimet e dikurshme, po kaq a diç më tepër
me lëvrimin e romanit, dëshmon se është mjeshtër i
rrëfimit, që pavarësisht unit të krijuar në kaq tekste,
shpesh të fanit vatrës rrëfimore kuteliane...

Bajram Sefaj: “40 Gjyshër rrëfejnë”,
botuar nga “Faik Konica”, Prishtinë

RRËFIME PËR MJALTIN E MJALTIT TË SHPIRTIT

Nga Skënder Zogaj

(fq.10)

PYETËSORI “LIBRAT E JETËS SIME”

YLLJET ALIÇKA:

Libri me të cilin dua
të mbahem mend?
“Metamorfoza e një
kryeqyteti”

(fq.12)

Rreth satirës së Gjergj Fishtës “Metamorphosis”,
botuar më 1907. Qenësia e mesazhit:

“UN MÂ ME SODJET, SHQYPTAR NUK JAM”

Nga Anton Nikë Berisha

(fq.2-4)

Poezia *Metamorphosis*, ndër krijimet më të fuqishme që ka dalë prej penës së Fishtës dhe të satirës shqiptare të të gjitha
kohëve, në qenësinë e vet ka ruajtur edhe sot e gjithë ditën aktualitetin e saj. Rrjedha dhe ndodhitë e viteve të fundit...

SHKON ESEJA TE LETËRSIA APO LETËRSIA VJEN TEK ESEJË?

Nga Floresha Dado

(fq.5)

Si ndodh ky kalim dhe ku qëndron thelbi i kësaj
interference në eseistikën e Kadaresë?

Sigurisht fshirja, shpesh here e theksuar, e ku-
firit midis krijimit artistik dhe krijimit eseistik...

JORGE LUIS BORGES KOPSHTI ME SHTIGJE QË BIGËZOHËN

Përktheu nga origjinali

Mira Meksi

(fq.22)



BIBLIOTEKË

- Luljeta Lleshanaku (fq. 17)
E hëna në shtatë ditë
- Adil Olluri (fq. 16)
Më jepni diçka ta fshij gjakun
- Antoine Simon (fq. 11)
Tashti ti ecën (Përkth. Anton Papleka)
- Shqiponja Axhami (fq. 15)
Qeni i fëmijërisë
- Artur Spanjoli (fq. 14)
Djali nga qyteti
- T. S. Eliot (fq. 12)
Kënga e dashurisë e J. Alfred
Prufrokut (Përkth. Arb Elo)

POETIKA E MUZAVE

Nga Skënder Karriqi

(fq.8)

Zanafilla e rrëfimit poetik tek grekët, por jo vetëm tek
ta, domosdoshmërisht reflekton masën e njeriut...

Arsyeja e shqyrtimit

Poezia e Fishtës *Metamorphosis*, botuar në përmbledhjen “Anzat e Parnasit” (1907), hyn në rrethin më të ngushtë të krijimeve më cilësore të satirës fishtiane. Ajo është dëshmi e pandërmjeme e konceptit krijues satirik, por edhe poetik e kombëtar të Fishtës. Disa nga vargjet e kësaj poezie si

“T’a dijë Shqypnija /
Prá, e sheklli mbarë, /
Se mâ mbas sodit /
Un s’jam Shqyptár”
ose
“Un mâ me sodjet /
Shqyptár nuk jam”

tash gati një shekull përdoren në biseda dhe në shkrime me kuptime të ndryshme: herë për të dëshmuar ndjenjën kombëtare të poetit, herë për të mohuar atë e për ta shpallur autorin antishqiptar (siç u veprua gjatë sistemit komunist), herë për të mohuar vetë kombin shqiptar dhe shqiptarizmin. Me pak fjalë, ky mesazh, që shqiptohet nëpërmjet disa vargjeve të përdorura në poezinë *Metamorphosis*, u shfrytëzua e u keqpërdor në mënyra e në raste të ndryshme, më së shpeshti duke i shkëputur vargjet nga konteksti ku ato gjenden, nga koncepti krijues satirik fishtian ose edhe nga koncepti krijues poetik i tij në përgjithësi. Interpretimet e këtilla, herë nga mosdija e herë nga qëllime të ndryshme, bënë ndikimin e tyre dhe shkaktuan mëdyshje, mbështjellime dhe ngatërresa. Së këndejmi, jo një herë dhe jo vetëm në një kohë, kam menduar rreth këtij mesazhi të poetit e atdhetarit tonë të madh. Mirëpo, herë-herë krijuesi me vështirësi i shpjegon disa punë që i zvarris prej një dite në tjerën dhe prej një viti në tjetrin!

Konteksti ynë i sotëm më bëri që t’i kthehem poezisë *Metamorphosis* të Fishtës dhe t’i shpreh disa mendime e përsiatje rreth saj.

Satira fishtiane - jehonë e realitetit konkret shqiptar

Në fillim të shekullit tonë, kur Fishta shkroi e botoi disa nga poezitë e veta patriotike e satirike, pastaj këngët e para të epit *Lahuta e Malcís* si dhe shkrime të llojeve të tjera, jetën e përditshme shqiptare e cilësonte një gjendje e rëndë, goftë në rrafshin shoqëror, ekonomik e politik, goftë në atë shpirtëror e moral. Për këtë arsye është fare e natyrshme që krijimet e para të Fishtës, siç ndodh edhe me ato të shkruara e të botuara më vonë, të jenë të lidhura me ngjarjet dhe me gjendjen konkrete ose jehonë e pandërmjeme e tyre.

Fishtën, si dhe intelektualët e tjerë shqiptarë, e shqetësonte pa masë gjendja e popullit dhe e atdheut, për shumëçka e padurueshme, prandaj ai gjakoi forma të ndryshme për t’i bërë të ditur njeriut të tij domosdonë e një veprimi aktiv për ndërrimin e kësaj gjendje – për një zotim më këmbëngulës për mirëqenien e botës e të jetës shqiptare si dhe përparimin e

Rreth satirës së Fishtës “*Metamorphosis*”, botuar më 1907

QENËSIA E MESAZHIT: “UN MÂ ME SODJET/ SHQYPTAR NUK JAM”

Nga Anton Nikë Berisha

“Fundi i shekllit të nandëmbëdhetë, mund të thuhet se e gjet popullin shqiptar gati krejt të mpím; vetëm vepra e disa atdhetarve të pakët e zgjoi nga gjumi, e një pjesë shumë të randsishme në ket zgjim kombëtar e ka sigurisht puna e ndritun e prodhimtare e At Gjergjit.”

KARL GURAKUQI

atdheut, Shqipërisë.

Fishta ishte i vetëdijshëm për faktin se sundimi i gjatë osmano-turk kishte lënë pasojë të rënda në mendësinë shqiptare, prandaj ishte i bindur se te një shtresë e shqiptarëve, te të cilët ishin shuar në një masë të ndjeshme fryma patriotike e epike si dhe cilësitë dhe virtytet që i kishin dalluar paraardhësit e tyre, *Të Parët tanë*, poezia satirike, e gërshetuar me sarkazmë, me ironi e me groteskë, mund të ndikonte në mënyrë të veçantë. Pra, vetëm nëpërmjet kritikës, përqeshjes e thumbimit dhe prekjës në sedër, do të mund të “trokitej” në ndërgjegjen e përfaqësuesve të

kësaj shtrese, e cila edhe kishte rol të rëndësishëm në mirëvajtjen dhe në zhvillimin shoqëror e kulturor të vendit. Së këndejmi, kritika e drejtpërdrejtë dhe e ashpër do t’i nxitte ata të mendonin një herë e mirë për fatin dhe përparimin e botës e të atdheut të tyre.

Duke u përcaktuar për një gjë të tillë dhe duke qenë i vetëdijshëm për mundësinë e ndikimit të artit të fjalës, sidomos të poezisë, Fishta sikur kishte parasysh mendimin e Eliotit, i cili, duke bërë fjalë për kritikën që bëjnë shkrimtarët, për rëndësinë dhe rolin e saj, shkruante: “Kritika është po aq e pashmangëshme sa edhe frymëmarrja...

Unë jam i mendimit se kritika e përdorur nga një shkrimtar i ushtruar e i shkathët në veprën e vet është më qenësorja, është lloji më i lartë i kritikës dhe disa shkrimtarë kreativë janë superiorë ndaj të tjerëve, vetëm ngase aftësia e tyre kritike është superiore.”

Njëjtësim e vijimësi

Në vitin 1907 Fishta shkroi poezitë satirike *Metamorphosis*, *Nakdomonici-pedija* dhe *Koha e arit në Shqypni*, të cilat ndërlidhen mes veti për shumë tipare.

Në poezinë satirike *Nakdomonici-pedija* (satira *Metamorphosis* për herën e parë u botua si pjesë e fundit e kësaj; më vonë poeti e botoi si poezi më vete) Fishta vë në thumb të kritikës gjendjen e rëndë shoqërore e shpirtërore të shqiptarëve, të cilët, të dhënë pas fitimit e interesave vetjake, kishin lënë anash kujdesin ndaj atdheut. Poezia është shtjelluar në formën e një letre, dërguar Dom Ndoc Nikajt, intelektual e shkrimtar i shquar, i cili atë kohë kishte botuar një libër të historisë së popullit shqiptar. Në fillim të kësaj satire Fishta i përkujton autorit të librit të historisë:


*Sod n’Shqynpi, more lum miku,
Histori është meteliku.*

dhe se shqiptarët po ia thoshin këngës

*“Haja qëniti - pija qëniti, /
Edhë bjer karaduzëni!”.*

Pra, gjërat që nuk “pjellnin” napoleona, siç ishte historia, shkrimi e botimi i vjershave ose veprimtari të tjera artistike e shpirtërore, s’kishin asnjë vlerë. Me fjalë të tjera, siç shprehet Fishta, në Shqipëri dija, kënga e historia merreshin për punë dokrrash!

Nga fakti se në Shqipëri njerëzit mirreshin vetëm me punë dhe interesa vetjakë, përbuznin dhe mohonin të mirën kombëtare dhe mirëqenien e atdheut, gjallimin e përditshëm e





cilësonte një situatë e rëndë dhe e pazakonshme: të mirës i thuhej e keqe ose të bardhës i thuhej e zezë dhe anasjelltas. Domethënë, në kontekstin përkatës ishte përmbysur logjika normale dhe e natyrshme e veprimit dhe e mendimit.

*Pse nder né kjo kohë ká ardhë,
Qi një e zezë me u thirrë e bardhë:
M'ëmen t'vet sendet s'duen qujtë
Per ndon qyqja mos me t'mujtë
E me t'fry era n'kuletë...*

Pra, ndër shqiptarë punët po shkonin si ishte më keq “*Ke na shkojn pûnët kambë e krye*” dhe një shkallëzim më i rrezikshëm e me pasoja “*Shoqi shoqit m'ia xjerrë trût*.” Një kohë e tillë kishte shkaktuar përsëritjen e së keqes e tragjikës, që ishte dëshmuar edhe në të kaluarën: mospërfillja e njëri-tjetrit, kundërvënja, përçarja, mashtrimi, tradhtia:

*“Medét per né!
Pse heret si n'e s' vonit /
Skem' mujtë dy vetë me u vû kurr m'
nji hulli: /
Njani bje thumbit, tjetri patkonit”*

ose dy vargjet e njohura të Fishtës

*“Sod mâ shpejt një thes me pleshta/
Ti bân bashkë se dy Shqyptarë.”*

(nga satira “Koha e arit në Shqypni”).

Po qe se do të vazhdonte edhe më tej kjo gjendje dhe kjo sjellje e shqiptarëve, thekson poeti, atëherë për ta s'do të ketë as mëkëmbje e as përparim kombëtar; në qoftë se ata nuk do të kthehen për së mbari e nuk do të bashkohen dhe nuk do të kujdesen për atdheun e tyre, për ta nuk do të ketë më agim, po natë, varfëri dhe turp. Këtë Fishta e thotë në mënyrë të pandërmjeme e të qartë:

*Pá një bashkim t'vertetë s'ká per t'ague
Per né agimi kurr; gjithmonë por nata
E marrja e skami kanë per t'na ngushtue.
(Nakdomonicipedija)*

Rrënimi i logjikës së natyrshme

Poezia *Metamorphosis* dëshmon me një anë jehonën e drejtpërdrejtë të gjendjes së rëndë shoqërore, shpirtërore e morale të botës e të gjallimit konkret shqiptar dhe, më anë tjetër, ndjenjën e madhe atdheadashëse të Fishtës. Poeti është i shqetësuar deri në paskaj për shkallën e ulët të vetëdijes kombëtare te një pjese të shqiptarëve, për përmasën e shprishjes e të rrënimit shpirtëror të tyre, për qëndrimin mëdyshës po shpesh edhe përbuzës ndaj atdheut dhe ndaj trashëgimisë shpirtërore e materiale, për zvetënimin ose lënien anash të virtyteve: burrërisë, besës, bujarisë, mikpritjes, gjë që vërehej sidomos tek ata që ishin në pushtet ose që ishin pasuruar e po pasuroheshin në mënyra të ulëta, duke shfrytëzuar djersën e të tjerëve dhe gjendjen e vështirë në të cilën po gjallonte pjesa dërrmuese e popullit shqiptar. Pra korrupsioni, mitoja, mashtrimi, tradhtia kishin marrë një përmasë të ndjeshme. Sa më shumë që individi tregonte indiferencë ose e mohonte atdheun, prejardhjen dhe të kaluarën kombëtare, çmohej e nderohej më shumë, zinte pozita më të larta dhe bënte një jetë të pasur e të rahatshme për t'u shpallur më në fund edhe udhëheqës shpirtëror e kombëtar! Në të kundërtën e kësaj, ai që bënte e vepronte për të mirën e popullit dhe të atdheut të vet, që synonte në forma të ndryshme të nxiste e të zgjonte ndërgjegjen kombëtare pas sundimit shumëshekullorë osmano-turk dhe zotohej për përparimin e vendit në pajtim me kohën, merrej si njeri i dështuar, i mjerë, madje edhe i marrë!

Katër vargjet e para të satirës *Metamorphosis* e përcaktojnë dhe e shprehin në mënyrë të pamëdyshtë këtë gjendje të pazakonshme të gjallimit konkret shqiptar. Poeti është i shqetësuar thellë, prandaj me qëllim flet në veten e parë dhe që në këto vargje prek çështjen thelbsore.

*Qe besa, o burra,
Nuk dij kah t'çajë,
Mbasi do t'thirret
Sot derri dajë...*

Domethënë, në një kontekst të tillë të jetës kishte pushuar logjika e zakonshme dhe e natyrshme e gjallimit, e vlerësimit, e mendimit dhe e veprimit. Derrit i thuhej dajë! Një krahasim e kontrast i pazakonshëm: derr quhet daja, vëllai i nënës, njeriu më i afërt për nga vija e qumështit dhe e gjakut! Pra, obstrukcioni ishte bërë bazë e vlerësimit dhe e gjallimit të përditshëm dhe kishte marrë përmasa gjithkunduese, për këtë arsye çdo mendim e veprim jashtë asaj logjike çmohej si jo normal. Kështu, merrej punë e parëndësishme, për të mos thënë e kotë ose e marrë, interesimi për çështjen kombëtare dhe veprimi në të mirë të saj; përpjekja për ruajtjen e trashëgimisë dhe pasurimin e mëtejshëm shpirtëror, kujdesi për gjuhën amtare, për arsimin. Me një fjalë: çdo gjë që nënkuptonte përtëritjen e jetës shqiptare në të gjitha rrafshet e saj.

Nëpërmjet ligjërimit në veten e parë Fishta na bën të kuptojmë se, si individ, ai mjaft kohë ishte përpjekur për t'i ardhur në ndihmë njeriut të tij dhe çështjes kombëtare; kishte luftuar pa frikë kundër armiqve të Shqipërisë dhe kishte qenë i gatshëm të presë e të durojë çdo ndëshkim e flajm.

*Me anmiq t'Shqypni
Un pa u frigje
Mjaft jam, i mjeri,
Kacagjelue.
Pse kam pasë thânun
Deri sivjet:
Lum aj qi shkrihet
Per atme t' vet.*

Një punë e këtillë për *atdhe* - brenda logjikës së përmbysur - nuk ishte pranuar e nuk ishte çmuar, përkundrazi ishte nënçmuar e përbuzur dhe si individ ai kishte pësuar për arsye se nuk kishte gjetur përkrahjen pikërisht të atyre që ishin në pushtet dhe duhej të punonin e të ndihmonin për mirëqenien e bashkimit kombëtar. Së këndejmi:

*Po, po; kujdesi
Per Gegë e Toskë
Mue sod m'ka hjedhun
Si hût n'ketë prroskë...*

Pra, po të kishte punuar ndryshe, siç vepronin shumë të tjerë, atëherë edhe ai do të ishte në një gjendje tjetër, do t'i kishte punuar kuleta e fjala; do të ndihej pikërisht si ata, të cilëve nuk u interesonte as e kaluara, as të Parët, as Shqipëria e kohës.

*Porsi njatyne,
Qi ndëjë n' Shqypni,
Kujtojn se gjinden
Shi n'Australi;
E per dhë t'Parvet
S'u bjen nder mend
Me sa per kpurdha
Qi bijn ndervend.*

Konteksti i tillë kishte rrënuar qenësinë e veprimit të zakonshëm dhe të sjelljeve të njerëzve dhe kishte kushtëzuar që të çmoheshin e të zgjedheshin në pozita me rëndësi shoqërore e politike njerëz që ishin

zhveshur nga cilësitë kombëtare dhe si të tillë, më së paku, e meritonin të ishin në ato vende e t'u besoheshin detyra të tilla. Fishta vë në dukje se ata “*Kanë spaten n'mjaltë*” dhe përherë ngriten lart e më lart, po edhe

*Per ditë t'u mâjun,
Si mâjet njala,
U punon n'shekull
Kuleta e fjala.*

Ky kod sociokulturor, mbi bazën e të cilit çmoheshin njerëzit dhe puna e tyre, e shqetëson poetin dhe të thuash e rrënon shpirtërisht, prandaj shpreh sa zhgënjimin, po aq mospajtimin dhe kundërshtimin e tij. Kjo nuk bëhet me mjete e në mënyrë tradicionale, duke i dhënë përparësi vetëm pohimit të pandërmjemë. Të keqes poeti i qaset këtu nga një strategji dhe nga një mënyrë e veçantë: kalohet formalisht në anën e së keqes dhe prej andej rrëfëhet e bëhet vlerësimi për të, shqiptohet qenësia e saj.

Akti i indentifikimit me bazën e kodit të tillë sociokulturor e me logjikën e njerëzve të tillë, ku e keqja mirret për të mirë, antikombëtarja për kombëtare, e bardha për të zezë, ka një shenjëzim të qenësishëm dhe thellësor. Poeti deklaron se për arsye “*Me kënë i vetit*” (lexo: ta shikojë vetëm punën dhe interesin vetjak) do të shporret nga Shqipëria e do të heqë dorë nga ajo që kishte bërë deri në atë çast. Shkallëzimi arrin pikën kulminante:


*T'a dijë Shqypnija
Prá, e sheklli mbarë
Se mâ mbas sodit
U' s'jam Shqyptár.*

Këto vargje japin qëndrimin dhe përcaktimin e poetit në një rrafsh të përgjithshëm. Adresanti i mesazhit është, para së gjithash, atdheu, Shqipëria, por dhe më gjerë: shekulli (lexo: bota). Shndërrimi, përkatësisht metamorfoza e tij nuk duhet të kalojnë në heshtje; akti i tillë është për shumçka i rëndësishëm dhe për të duhet t'u bëhet e ditur atyre që kanë pozita në jetën shoqërore e politike, pra që heqin peshë dhe vendosin në Shqipëri për – *zotërinjtë* - *sundimtarët*. Katër vargjet pasuese, që në esencë e përsëritin mesazhin e vargjeve të përmendura më lart, përcaktojnë në mënyrë të pandërmjeme e të qartë adresantin e vërtetë, të cilit i drejtohet mesazhi fishtian.

*A ndiet, Zotni,
Qi rrini n' shkam?
Un mâ me sodjet
Shqyptár nuk jam.*

“*A ndiet, Zotni / “Qi rrini n' shkam?”*, bëhet pyetja e prerë (shih shkrimin e fjalës Zotni me shkronjë të madhe), që shenjëzon përcaktimin e rëndësishëm. Pra, mesazhi fishtian në qenësinë e vet u drejtohet zotërinjve, njerëzve të pasur, atyre që pasuria u ishte bërë ideal veprimi e jete, përkatësisht njerëzve të pushtetit, që me qëndrimet e tyre kishin kushtëzuar gjendjen e tillë tejet të rëndë e të padurueshme të jetës shqiptare.

Pse zgjedhet kjo strategji e shqiptimit dhe e ligjërimit dhe pse veprohet në këtë mënyrë? Pse ky mohim i përkatësisë kombëtare i atdhetarit të madh, pse ky



“shndërrim” në një person me qëndrime krejt të kundërta nga ato që i kishte mbrojtur me aq këmbëngulësi deri në atë çast, pra që ishte “kacagjelue” (lexo: kacafytur, luftuar) pa frikë me armiq të e Shqipërisë? Pse ky përnjësime pohues me atë grup individësh, të cilët nuk çanin kokën për punët e atdheut e të mirëqenies shqiptare, me ata të cilët, edhe pse jetonin në Shqipëri, e ndienin veten të huaj pikërisht në atdheun e vet: “Kujtojn se gjinden ? Shi n’Australi”?

Ashpërsia e protestës dhe thellësia e sarkazmës

Në poezinë *Metamorphosis* Fishta dëshmon vetëdijësimin atdhetar e poetik, strategjinë e krijesit të madh, që jo vetëm e di detyrën e vet, por di ta mbërrijë qëllimin në një mënyrë të veçantë e të rrallë: pohon identifikimin me këtë shtresë njerëzish të zhveshur nga ndjenja kombëtare e morale për të shprehur më plotnisht e më gjithashëm shpirtin e tyre, për t’i vënë në pah veset dhe tiparet e ulëta: lakminë, karrierizmin, poshtërsinë, tradhtinë, korrupcionin, dyfytërsinë, zbrazëtinë shpirtërore dhe morale. Njësime formal me këta njerëz synohet të bëhet sa më i plotë për arsye se në këtë mënyrë shpalohej më bindshëm, nga një anë, thelbi i veprimit, i karakterit dhe i shpirtit të korruptuar, ndërsa, nga ana tjetër, shprehej ironizimi, kundërshtimi dhe urretja ndaj tyre, pra vihet në pah shpirti i botës së kësaj shtrese, po njëkohësisht ajo që llohet mu në palcë dhe zhveshet deri në paturpësi. Poeti, pasi njësohet formalisht, rrëfen nga “taborri” i atyre njerëzve.

*Per mue Shqypnija
Kufij më s’kà,*

*Nuk kam kund atme
As fis as vllà,
Fis kam mà t’fortin
E vllà bujarin,
Per atme barkun,
Per erz kam arin.*

Çfarë mund të ishte kjo qenie, ky njeri që mohon ose që s’ka as atme (atdhe) e as fe, as fis e as vëlla; që fis ka të fortin e vlla bujarin, që atdhe ka barkun dhe erz e nder arin? Të jetë shqiptar? Po si mund ta mbante veten për shqiptar ai që s’ka as fis e as vëlla, që barkun e ka në vend të atdheut, Shqipërisë, dhe paranë (lekun) e ka në vend të nderit dhe të erzit? Shqiptar i tillë Fishta as nuk donte të ishte e as nuk mund të ishte.

Nëpërmjet një strategjie të këtillë të shqiptimit, mesazhi i Fishtës fiton kështu peshë e të drejtë më të madhe morale dhe etnike, edhe efekti i ndikimit të vargut të tij bëhet shumëfish më i madh dhe më shkallëzues. Pra, nëpërmjet identifikimit si pohim, poeti rrëfen dhe shqipton botën nga brendësia e saj, gjë që e bën rrëfimin më të bindshëm, më të natyreshëm dhe më të drejtpërdrejtë. Me fjalë të tjera, nga pozicioni i tillë Fishta flet me shumësinë e zërave të shtresës me të cilën njësohet formalisht; luftohet e keqja jo me të keqen personale, por nga pozita e së keqes së përgjithshme. Me gjuhën që “ther e pret” ai përqesh, ironizon; shpreh protestën e vet të pamëdyshtë. Gjithë këtë e bën për hir të ndryshimit, të zgjimit e të krijimit të vetëdijes kombëtare, edhe pse mesazhi i tij shqiptohet nga pozita e kundërt, e përmbysur, që në artin letrar përdoret shpesh.

Fishta i jepte rëndësi të jashtëzakonshme kritikës për arsye se nëpërmjet saj prekte sedrën e këtyre njerëzve, të cilët duhej e mund të bënin shumë për popullin dhe atdheun. Kjo strate-

gjë nuk është e rastit dhe atë e kanë vënë në dukje edhe studiues të ndryshëm, njohës të mëdhenj të veprës së Fishtës. Kështu, Lasgush Poradeci theksonte se “Nuk duhet harruar trumbat me gjëmba e satirave, *Anzat e Parnasit*, të mbushura me një shfryerje mendimtare të tharbët, të tmerrshme, dhe të cilave Fishta - më rrëfen At Pali - iu jepte për veten e tij më shumë rëndësi sesa Lahutës”, ndërsa Ernest Koliqi shkruante më 1956: “Vishkullen e sarkazmit Fishta e përdori me qortue shqiptarin dhe me nxitë të rrahi udhen e drejtë të qytetnis dhe fisnikoi në vepër të vet prirjen e talljes që nganjherë ndër ne shtihet në punë me vra zemra dhe me përtri ngatrra e dasina. Gjuha shqipe sikur asht e pasun në skaje e fraza ku idhnimi e mënija shfrejnë me ma të madhen gjallni, ashtu ka mundsí të lakohet e të përkulet në shprehje dykuptimshe ku xhixhillon ironia e ku fjala në mbrendinë e vet që duket e mitun përmban thumbin ma shporruet.” Pra, në këtë satirë fishtiane del ajo që thotë Poradeci, duke folur për Fishtë, “*Krijuesi kombëtar i vetdijshëm prej kombësi shqiptare të pavetdishme*”, i cili nuk kursei asgjë për ta bërë edhe atë të vetëdijshme, që është synimi kryesor i gjithë veprës së tij poetike.

Për të qenë edhe më i bindshëm në shqiptimin e tipareve të kësaj shtrese shoqërore shqiptare, Fishta shkon dhe e plotëson imazhin e saj edhe me disa elemente të tjerë: njerëzit e kësaj shtrese si të tillë në mbrëmje binin si grekë, ndërsa në mëngjes zgjoheshin “Shkjá ose Zebjek”, ashtu siç e kërkonte navoja dhe interesi vetjak; flitnin në gjuhë të huaja (herë gjermanisht, herë italisht, herë sllavisht, herë greqisht e herë turqisht) pa çarë kokën për gjuhën e nënës - shqipen; prandaj historinë, ngjarjet e mëdha dhe heronjtë kombëtarë i merrnin për dokrra; lavdëronin qyqarët, mashtruesit, pakurrizorët, puthadorët, të gjithë ata që nuk e kishin as unin e as mendimin e vet; edhe kryetrimin kombëtar, që në vetëdijen shqiptare kishte marrë përmasën mitike, e kishin harruar dhe e merrnin për hiçgjë. Pra, mohonin krejt atë që dikur e kishte dalluar e cilësuar botën shqiptare dhe shpirtin shqiptar. Pas shndërrimit edhe atij do t’i ndodhë e njëjta gjë.

*Luftët e Kastriotit
E t’Dukagjinit
Un kam me i mbajtur
Per dokrra t’hinit.
Sot per mue Leka
E Skanderbegu
Janë Palok Cuca
e Jaho Begu.*

Përmes rrëfimit cilësor satirik, sarkazmës dhe groteskut, Fishta vë në dukje edhe çështjen e emërtimit dhe të gjinisë së këtyre njerëzve. Atyre u pëlqenin emrat nga të cilët nuk mund të dallohej përkatësia nacionale e as ajo gjinore: mashkull ose femër. Për ta ishte me rëndësi të bëjnë jetë të mirë, të hareshme e të qejfit dhe të jenë hyj midis njerëzve, të sundojnë mbi të tjerët pa i kursyer ata për asgjë. Ndodhte kështu për arsye se

*Kemi për t’kënnun
Si hyj në tokë,
Kem’ per t’zotnue
Pa dhimbë mbi shokë*

qoftë edhe duke shkelur mbi eshtrat e të vdekurve bashkëkombas: *Kemi me shkelun / Mbi rrashtë t’Shqyptarve...* gjë që shenjëzon shkallëzimin sa të tragjikës e të pësimit, po aq të shqetësimit e të protestës.

Pikërisht këta njerëz që vepronin brenda kësaj logjike të përmbysur (obstruktive) çmoheshin e shpalleshin (natyrisht të nxitur e të kushtëzuar kurdoherë nga ata vetë) edhe personalitete me rëndësi kombëtare. Për të ndodhur edhe më e keqja, të tillët viheshin në këngë dhe u ngriteshin murana e mbishkrime të ndryshme, ashtu si në kushte normale të gjallimit kishte ndodhur me njerëz të shquar të historisë sonë kombëtare, flijuar për atdhe, për fis, për nder të familjes e për fë. Pra, koha, në të cilën mbretëron logjika e tillë e përmbysur, kushtëzon edhe paradoske të tilla: këndimin e personit të tillë, as shqiptar, as turk, as femër e as mashkull:

*E ka me u gjetun
Ndo’i far Orfeut
Qi lavdet t’ua
T’i a kndojë dheut.*

Ose në pllakën e rrasës së varrit të personit të tillë do t’i shënohen edhe këto fjalë

*“Ktù njaj fatbardhi
Ësht tue pushue
Per Fé e per Atme
Qi pat jetue.”*

Është ky perceptim e shqiptim sa i veçantë, aq edhe dramatik e tragjik, i jetës dhe i gjallimit shqiptar në fillim të shekullit XX dhe një nga demaskimet më të plota dhe më thellësore që i ka bërë një gjendjeje të tillë ndonjë krijues shqiptar deri në ditët tona.

Vijimësia e aktualitetit

Poezia *Metamorphosis*, ndër krijimet më të fuqishme që ka dalë prej penës së Fishtës dhe të satirës shqiptare të të gjitha kohëve, në qenësinë e vet ka ruajtur edhe sot e gjithë ditën aktualitetin e saj. Rrjedha dhe ndodhitë e viteve të fundit në botën shqiptare dëshmuar se elemente të asaj gjendje e të asaj mendësie, që Fishta me aq mjeshtëri e ashpërsi i kishte vënë në thumb të kritikës në poezinë e tij dhe i kishte demaskuar e ironizuar pa kursim, u përsëritën e po përsëriten në forma të ndryshme. Fishta intelektual e poet i madh kishte kryer për gjeneratën e vet (e jo vetëm për atë gjeneratë) detyrën e shenjtë që e theksonte Sartre: “Intelektuali është i shtyrë të bëjë vetëdijësimin për vetveten dhe, rrjedhimisht, për të gjithë”. Nevoja e këtij vetëdijësimi është e mbetet një detyrë qenësore edhe në kontekstin e gjallimit të sotëm.

SHKON ESEJA TE LETËRSIA APO LETËRSIA VJEN TEK ESEJA?

Nga Floresha Dado



Si ndodh ky kalim dhe ku qëndron thelbi i kësaj interference në eseistikën e Kadaresë?

Sigurisht fshirja, shpesh here e theksuar, e kufirit midis krijimit artistik dhe krijimit eseistik është një dukuri interesante, në mjaft raste, edhe provokuese. Në teorinë e mendimit eseistik mjaft teoricienë (midis tyre kryesisht shkrimtarë), e kanë konceptuar **esenë** si lloj të veçantë letrar, larg shkrimit shkencor dhe publicistik. Kjo pikëpamje është mbështetur aq më tepër për atë lloj eseje ku mbizotëron figura artistike, trillimi i natyrës letrare, ku fantazia e krijimit dhe imagjinata e përjetimit janë dukshëm sipas stilit të letërsisë. Diskutimi i kësaj pikëpamjeje provokohet drejtpërdrejtë në disa prej eseve të Kadaresë. Intuita letrare në *Autobiografia e popullit në vargje*, *Uragani i ndërprerë - Ardha e Migjenit në letërsinë shqipe*, *Dantja i pashmangshëm*, *Eskili, ky humbës i madh*, *Kushëriri i engjëjve* etj., i kapërcen kufijtë e një interpretimi logjik, shkon drejt përfytyrimesh që vetëm fjala artistike mund t'i formësojë. Ligjërimi letrar bëhet, shpesh herë, aq mbizotërues në stilin e këtyre eseve, çka bën që pasazhe të veçanta të shijohen si letërsi e mirëfilltë.

Ese poetike, e llojit impresionist?

Struktura emocionale poetike, impresioniste, ndjehet pothuajse në tërësinë e konceptimit të esesë *Autobiografia e popullit në vargje*. Autori përjeton një poezi të madhe, që e mahnit në të gjithë elementet e brendshëm dhe të jashtëm të saj, e përfytyron atë si “një “plotëri” të përgatitur për një jetë autonome, me ndjeshmëri që duket sikur rrok gjithë planetin, një kështjellë që është e përgatitur për një rrethim mijëvjeçar ... Në atë zhveshje të frikshme të planetit, e vetmja ajo, ishte e aftë të dyzonte jetën, pyjet, ujërat dhe fjalët që mungonin. Ishte më shumë se art dhe më e nevojshme se një brez shpëtimi (f. 11).

Në imagjinatën e tij të jashtëzakonshme shkëndijon një lidhje, gati magjike, midis universit krijues popullor dhe përmasave të ndjenjës dhe përfytyrimit të tij poetik. Nëse pjesë të këtij korpusi gjigand i fanepsin atij pamje të jashtëzakonshme, ku “sheh” se *Syt e njeriut janë dy, pra “një palë”, rrjedhimisht, edhe lotët quhen ashtu, sikur të ishin vathë, sikur t’ishin bizhu, një palë lot, dyzet palë lot. Ç’dritë dhe ç’rrezëllim argjendi ka kjo e qarë dhe ç’trish-tim të pafund. S’janë pesë, dhjetë, dymbëdhjetë palë lot, por dyzet f. 45.*, apo kur poezinë ar-bëreshe e ndjen të përkorë dhe fine, e përndritur nga lotët, e pandryshkështme, si një grumbull brilantesh e stolish, ajo u shkund midis atyre shpirttrave të vranë, duke marrë përsipër të bënte të pamundshmen, të kthente atë që dukej e pakthyeshme; të ngjallte Shqipërinë së vdekuri. Ishte ky një pretendim titanik që asnjë shkollë letrare, asnjë manifest kulturor s’do të guxonte ta merrte përsipër; por që ajo, e druajtura në pamje, e bukurra, e përkora, arriti ta bënte. ... f. 166-167.

Për një moment mund të hutohesh: është aty autori popullor apo interpretuesi i korpusit poetik? Është magjia e krijimit të jashtëzakonshëm popullor që zbulon eseistin, apo përmasat e imagjinatës së shkrimtarit janë ato që ringjallin, në një vizion dhe përjetim të ri, këtë botë figurash mahnitëse, duke i dhënë një rrezatim tjetër zbulues? Duket qartazi se shpesh autori “harron” që është në sferën e interpretimit dhe, pa dashur, i nënshtrohet pushtetit të intuitës

artistike. Përshkrimi i lëvizjeve të personazhit historik, Skënderbeut, apo Migjenit etj., rendjet nga e shkuara në kohën e tashme, rindërtime të mjedisit dramatik, kombinimi i përshkrimit (në trajtë rrëfimi) me vargje të poezisë popullore etj., rrëfimi i ngjarjeve sikur eseisti është vetë i pranishëm, kombinimi me trajtën e kronikës së zhvillimit të ngjarjeve etj., jo vetëm krijojnë emocionet e një veprë letrare, por, nga ana tjetër, në shumë raste, japin imazhe të “drejtpërdrejtë” kinematografikë.

Disa pjesë të eseve të Kadaresë shfaqen edhe me ngjyrën e realizmit magjik, ku përzierja e detajit përshkrues me imazhet e trashëguara nga baladat e vjetra krijon atmosfera me ngjyrim të jashtëzakonshëm. Eseisti thyen kufijtë midis reales dhe imagjinare, midis të mundshmes dhe të pamundshmes. Skenat rrënoqethëse u shkojnë baladave, ku përfytyrimet që krijon lexuesi mund të jenë nga më tronditëset, për të ardhur tek një nga alegoritë më të fuqishme që lëviz në esetë e tij. Tregim artistik ndërtohet brenda kufijve të esesë dhe në pasazhe të tilla ne shijojmë letërsinë! Eseisti na çon tek magjia përfytyruese që ka fjala në letërsi dhe, për një moment, gati harrojmë se jemi në ese. Pikërisht kjo mënyrë përjetimi ka bërë që shumë teoricienë ta konsiderojnë esenë letërsi.

Cilat janë ato tipare të poetikës së brendshme që na çojnë, ndoshta pavetëdijshëm, në sferën e trillimit figurativ?

Ndërtimi i portretit me parime artistike

Në botën narrative të prozës artistike të Kadaresë kemi parë se forma e modelimit të figurave-personazh, lëviz midis kufijve të së zakonshmes, të pranueshmes dhe të panatyrshmes. Këto tre mënyra formësimi bëjnë që imazhi dhe lëvizjet e tij të duken herë të pranueshme, herë jashtë normales, dhe herë si alternim i këtyre dy mundësive.

Si lexues kemi pranuar se trillimi artistik, që formëson personazhet, është kombinim i së vërtetës dhe i dhunimit të saj. Madje letërsia na ka shpër më tej: në perceptimin e figurave të krijuara projektohet edhe trillimi ynë, ne ndjekim lëvizjet e personazheve, duke hyrë në iluzionin e një bote reale. Pa e kuptuar bëhemi “viktima” të iluzionit që na imponon autori. Lind pyetja: a ndodh ky proces përfytyrimi edhe në rastin e disa eseve, që i kushtohen ose figurave të letërsisë botërore, ose autorëve të huaj, ose shqiptarë? Eseisti ndërton marrëdhënie “të drejtpërdrejtë” me Eskilin, Danten, Migjenin, Konicën, Lasgushin etj. Duket sikur rindërton portretet përballë pozimit imagjinar të tyre.

Është kjo lidhje një thirrje e brendshme, dëshirë për rindërtim të modelit, që synon ta ripërhapte te lexuesi modern i kohës së sotme? Është një vizatim i jashtëm, i ndërtuar me imagjinatën e vështrimit të tij, apo është një portret i çuditshëm : i dukshëm/i padukshëm, i brendshëm/i jashtëm, por që, gjithësesi, një mënyrë perceptimi me dritë të re?

Si përfytyrohet Eskili, i paparë në asnjë dokument e dëshmi historike? Portreti, që “sheh” Kadare, s’ka lidhje me pamjen e jashtme, por, si në një pikturë moderniste, i rikthehet imagjinatës sonë, për të provokuar përfytyrim të jashtëzakonshëm mbi përmasat e kësaj figure, e cila ka zotëruar shpirtin njerëzor prej shumë e shumë shekujsh. S’ka portret fizik, por portret të një shpirti të pazakontë, një ringjallje në përfytyrimin dhe veshin e lexuesit të sotëm të gjëmimit të botës së krijuar prej tragjedianit. Kadare zhytet në **të padukshmen e së padukurës!**

Portretizim i llojit të veçantë, sipas parimit të mbizotërimit të elementit të padukshëm, sa imagjinues aq edhe misterioz, i ofrohet lexuesit të sotëm mbi një nga figurat më të shquara, por dhe më enigmatike të letërsisë shqiptare, Lasgush Poradeci: *Ai ishte i paparashikueshëm, gërryes si acid, i rrezikshëm, i befë. E qeshura e tij ishte si e tejjetshme, pa gëzim, mërztija e tij e papikëllueshme. Kështu e kishte edhe zemërimin, luksoz, të flohtë, kurse përbuzjen, rrezatuese që larg, si të stolitur me argjend*. f. 97.

Në pendën e eseistit portretizimi edhe i Migjenit “zbel” pamjen e njohur të jashtme, duke rindërtuar një portret tjetër, të brendshëm, në trajtën e trillimit letrar:

Portretit si imazh poetik

provokon një marrëdhënie të re me personin për të cilin shkruhet. Është parë foto e Ramize Gjebresë, partizanes së pushkatuar ... por **ç’lloj** fotoje do të ishte ajo që do të mund të ngjallte në përfytyrimin e lexuesit figurën e magjishme, në bukurinë dhe komunikimet e saj, siç e përcjell eseja e Kadaresë? E vizatuar si *legjendë e yllit të bukurisë, e zanës së maleve, princeshë flokëverdhë që kthehet në një farë elegjie kombëtare, ajo shfaqet në një përmasë tjetër; hidhen trakte për të - shkruan autori - nga kundërshtarët politikë, nga mbretërorët, nga nacionalistët, s’do të ishte çudi nga vetë gjermanët. Të gjithë e duan për vete. S’ishte komunizmi i përshatshëm për genie të tilla të epërme. Princesha ka gabuar kur është bashkuar me të Ismail Kadare, (Mosmarrëveshja mbi raportet e Shqipërisë me velveten - sprovë letrare, f. 92) Në këtë proces figurimi eseisti nuk përfytyron një personazh historik, real, por rindërton kuptimin , filozofinë që mbart fati i saj.*


Parimi i kundërthënies

bëhet tepër i rëndësishëm në karakterizimet e autorëve të preferuar. Nëse Eskilin e karakterizon një *enciklopedi e vërtetë e madhësisë dhe e marrëzisë, ai është sa i logjikshëm, aq dhe i palogjikshëm, sa tragjik, aq dhe grotesk*; rindërtimi i portretit të brendshëm të Faik Konicës është përsëri mbi karakterin kontradiktor që shfaqë në jetën e vetë ky personalitet i letrave shqipe: ... *optika e tij është kundërthënëse. Ai është vetë rilindas e po vetë kthehet kundër rilindasve. Punon e digjet për Shqipërinë e, aty për aty, i pëlqen të tallet me të tjerët që bëjnë të njejtën gjë. ..* Përgjohet për atdheun që ka larg, e mbron ku mundet, *i del për zot kundër shpifësve e racistëve, pastaj kthehet e shan, e quan Zululand ai vetë, më keq se racistët. Mund të thuhet kështu se është ai, vetë Konica që ngrihet kundër Konicës* “Kombi shqiptar në prag të mijëvjeçarit të tretë, f. 16)

Plani krahasimtar, ku përqsja me figura mitike dhe të epikës popullore i jep një kuptim sa enigmatik, dramatik, por aq edhe madhështor figurave që bëhen objekt i esesë. Vështrimi tejkalon qasjen e zakonshme të një analisti letrar, duke i dhënë një madhështi të veçantë herojeve të eseve. Duket sikur eseisti i ndjek heronjtë, për t’i ndalur një moment dhe për t’i bërë të vetëdijshëm se në thelbin e tyre ata mbartin diçka të jashtëzakonshme.

Portreti kolektiv, në të vërtetë gjallëron një imagjinatë tjetër origjinale. Analiza dhe sin-teza e të menduarit logjik, krijojnë një raport interesant me lirinë e të menduarit, me personifikimin si perceptim letrar, gërshetuar me

(Vijon në faqen 6)



(Vijon nga faqja 5)

parimin e ndërtimit të kontrastit, këtë radhë në rrokje jo individësh, por një kombi të tërë. Është një karakterizim që vjen nga një përvojë shekullore, nga njohje të historisë kulturore, politike, morale, psikologjike, që nuk mbështetet në trillimin individual, por në sintezën individuale të njohjeve shumplanëshe. Intuita e interferencës së njohjes historike me kuptimin e asaj që është e bukur dhe e shëmtuar, kanë sjellë një nga përcaktimet brilante të popullit të vjetër të historisë dhe kulturës së Ballkanit: ... *grekët e vjetër nuk ishin vetëm të ndritshëm, të mençur e të mermertë, siç i shfaqen përfytyrimit shkollaresk e klasikëgjant. Ata ishin sa të mençur, aq dhe të aftë për veprime të marrëzishme, sa të logjikshëm, aq dhe groteskë, sa të përmbajtur, aq dhe të ngutur dhe të padurueshëm. Vetanake e kryekërcyer, sedërtarë, idhnakë e kokëfortë, kokëshkretë, grrarëmbyes, të besës për punë të mbara, por edhe të pabesë për prapësira, ata ngjajnë çuditërisht me njeriun ballkanas, sidomos ashtu siç ai mbërriti në shekullin XIX, kur ende gadishulli ruante një farë njëjtësie kulturore brenda kufijve të Perandorisë Osmane (Eskili ... f. 145-146)*

Portreti i fenomenit

Jashtë karakterizimit të bezdisshëm, përmes stilit politik apo gazetaresk, eseja e Kadaresë ndërton portretin e fenomenit, i jep “pamje”, “trajtë”, “ngjyrë”, e personifikon gati si një qenie e dukshme, me të cilën lexuesi duhet të ndërtojë patjetër një marrëdhënie. Ndonëse tema nuk i përket sferës së letërsisë, imagjinata e tij krijuese sfidon ligjërimin publicistik, duke preferuar stilin e ligjëritimit letrar. Në esenë *Nga një dhjetor në tjetrin* duket sikur ka vizatuar portretin dramatik të një dukurie shoqërore, nuk është thjesht vëzhgim i vemendshëm i figurës, por një paralelizëm i hollë, midis thelbi dhe shfaqjes së dukurisë, një mënyrë e ndërtimit të figurës dhe e fenomenit.... *Në rregjimet diktatoriale, fytyra dhe trupi japin shpeshherë më saktë se në çdo kohë atë që ndodh në ndërgjegje. Një bardhësi e panatyrshme, një lloj dhjami i veçantë, si të thuash optimist në fytyrën e zyrtarit (sidomos kjo vihet re në takimin e parë pas një farë kohe, pasi është ngritur në post), e jep më saktë se çdo gjë kalimin përfundimisht të njeriut në anën e rregjimit. Një ritëm tjetër në ecje, një mënyrë e re e uljes në tryezë, e ngritjes, e shqiptimit të fjalëve; e po ç’kemi gjë shokë etj., dëshmon të njëjtën gjë*²⁵. (f. 140)

Në esetë, ku në themel është një portret, detaji individual i figurës-personazh, është mjeti themelor i portretizimit. Kurse në portretin kolektiv parimi i detajit individual është i pamjaftueshëm, ai kërkon sfera të tjera: nga hapësira, koha, realja, metafizika etj. Kjo bën që edhe ky lloj portreti të jetë më shumë **ide** se sa materie, të jetë më shumë **përfytyrim** se sa prekje. Kur eseisti shkruan: *Ngritja e njeriut mbi dy këmbë, kjo shkëputje e tij madhështore nga bota e kafshëve dhe lëvizja e tij ndryshe, quhet, me të drejtë, si shkalla e parë e ngjitjes së këtij princi të planetit drejt fronit* (*Kushëriri i engjëjve*, f. 10) lexuesi nuk përfytyron thjesht balerinin e famshëm, por “sheh” konturet e një arti të jashtëzakonshëm, sheh një imazh pa emër, një moment magjik, që i referohet jo vetëm individit, por potencialit artistik të njerëzimit. Është e jashtëzakonshme imagjinata e zbrërthimit të këtij arti, **e padukshmja ndërton të dukshmen**. Duket paradoks ky pohim, por mënyra se si e ka ndërtuar Kadare i jep kaq dritë procesit të formimit të portretit, ve në lëvizje imagjinatën krahasuese midis mjeteve artistike që përdorin dy arte të ndryshme: letërsia dhe vallja.

Portreti-tablo mbi një realitet të imagjinuar është “i gatshëm” për konceptim kinematografik. Duket se mbi bazën e tragjedive të lexuara, si dhe përfytyrimit që ka ngjallur tragjediani i madh, eseisti ndërton atë çka nuk është parë dhe nuk ka ekzistuar kurrë. Skena të gatshme për skenar filmi artistik, ku spektatori do të shohë mjedisin, një personazh, sa real aq edhe mitik në përmasat e imagjinatës së tij dramaturgjike. Karakteri analitik dhe shtrirja e ngjarjeve, tek eseja, kthehet papritur në një mënyrë sintetike të përgjithësimit, ku imagjinata detyrohet të rrokë njëkohësisht pamje, veprime, marrëdhënie, të dukshme dhe të padukshme, të rrokë thelbin e një korpusi

të tërë krijues. Regjisori do ta kishte pothuajse të gatshme skenën e konceptimit të një filmi (*Eskili ... f. 10-11*)

Marrëdhënia me objektin e esesë

Dihet se në letërsi kalimi nga hapësira e trillimit të shkrimtarit tek ajo e receptimit të lexuesit bëhet përmes gjallërimit të iluzionit. Por, edhe tek esetë e Kadaresë objektet, ndonëse janë personazhe të letërsisë, ose persona realë, shfaqen më shumë si imazhe artistike, me trillime tiparesh dhe veprimesh në mjedis të ndërtuara sipas imagjinatës së eseistit, i cili **rikonfiguron** persona realë dhe gjallëron imazhin e tyre tek ne.

Nëse “shohim” personazhe që eseisti i merr nga letërsia, si Hamletin, Don Kishotin, apo persona realë si Angjelin Perlocaj, Omer Kaleshin etj., kjo ndodh sepse marrëdhënia që ndërton me objektin e vet nuk është thjesht përshkruese, por një raport që kalon përtej individuale. Prandaj për eseistin nuk ka rëndësi të përcjellë në vizionin tonë përshkrim dhe sintetizim tiparesh, siç ndodh në formësimin e figurës-personazh në letërsi, por të jape **filozofinë** e momentit, të situatës së veçantë, të një lëvizjeje apo detaji të vetëm. Thelbi i marrëdhënies së eseistit me objektin e vet, në dallim nga letërsia, është zhbirim në atë që ka ndërtuar dikush tjetër, për të përcjellë *një kuptim të ri, të pathënë më parë*. Ndërsa në letërsi, secili prej nesh realizon lirinë e përfytyrimit, sipas aktit të vet iluzor, në rastin e esesë zbulohet një specifikë tjetër e marrëdhënies së autorit, sepse personi, objekti për të cilin ai shkruan, nuk është trillim i tij. Personazhet e veprave, që interpretohen nuk janë krijime të Kadaresë por në esetë krijohet një *marrëdhënie e re*. Ata rishfaqen në një qasje origjinale me përmbajtje të reja, thellohet thelbi i padukshëm i tyre, sipas mënyrës së shikimit vetiak. Në një kuptim, *esetë i ribëjnë personazhet*.

Letërsi përmes letërsisë

Tek esetë, që e kanë objektin nga fusha e letërsisë, shpesh herë Kadare ndërton një strukturë të re krijuese, për të realizuar një strukturë të re kuptimore: **thuret letërsi mbi letërsinë!** Huazimi nga proza i formave rrëfimtare e kthen rrëfimin dramatik në ligjërim prozaik tek eseja *Eskili, ky humbës i madh*: apo merr rolin e bashkautorit të tragjedisë, duke propozuar në strukturën e esesë një skemë të re: *Ky është shënimi që duhej të hapte “Orestian”... Nëpër njerëz portë do të hyjë duke shkelur mbi qilimin e purpurit mbreti Agamemnon*. Interpretimi i tragjedisë *Orestia* i ofron lexuesit të sotëm skena të rindërtuara, “të dukshme”, por përsëri me ligjërimin dhe stilin e një veprë letrare. Duket sikur kemi të bëjmë me një vepër të re. Sigurisht kjo teknikë artistike nuk është qëllim në vetvete, por i tërheq emocionet e lexuesit për t’i çuar në një botë tjetër përjetimesh, më të

drejtpërdrejta, rreth problematikave aktuale të realiteteve njerëzore të shekullit të fundit, deri në ditët e sotme: Kështu, mbi tragjeditë e antikitetit kompozohet një shtresim kuptimor i ri, mbi një vepër sikur krijohet një vepër tjetër. Transformimi i një gjinie letrare (e stilit dramatik në stilin rrëfimtari të prozës), apo e analizës interpretuese me një pamje të re të skenës së tragjedisë, ndonëse në vështrim të parë mund të dukej si “cënim” i natyrës ligjërimore të tragjedisë, vjen plotësisht i justifikueshëm në kontekstin e thelbit dhe llojit të esesë. Parimi i përqasjes, i kapërcimeve kohore dhe hapsinore, i llojeve të ndryshme që lëvrojnë dy autorët: njeri tragjedi, tjetri ese mbi këtë tragjedi, krijon, përsëri një shenjim tjetër në botën e krijuesit shqiptar. Lexuesi i vemendshëm i eseve te *Mëngjeset në kafe Rostand* futet në strukturën e re kuptimore të kësaj përqasjeje, të këtij “dhunimi” të tragjedisë së Shekspirit, për të kuptuar situatën emocionale, por tashmë të shkrimtarit Kadare.

Identifikim me autorin e trajtuar

Ndodh në mënyrë të padukshme, në nëntekstin e brendshëm. Ndodh, sepse eseja në korpusin krijues te Kadaresë nuk është dëfrim stilor, nuk është kuriozitet intrigues, por është një dhimbje, një dramë e përgjithshme, kombëtare apo edhe universale, është një dashuri apo një ngazëllim, është reflektim i brendshëm, është një thirrje ... Kur objekt i reflektimit eseistik është një autor, shqiptar apo i huaj, apo edhe një personazh letrar, ata nuk janë zgjedhur rastësisht; diçka e brendshme i ka sjellë tek eseisti, se fije të fatit apo brengeve të tij duket sikur kanë gjetur një qoshe brenda filozofisë që mbartin ata krijues të shpirtit njerëzor. Pa e kuptuar, eseisti identifikohet me ta, dhe, në mënyrën më të dukshme, përsëri ndërton skena, momente të jetës së autorëve të preferuar, për t’u bërë bashkë... Është imagjinatë e përfytyrimit të botës shpirtërore të tragjedianit të madh, Eskilit, apo është gjetja e vetvetes, apo maskimi i vetvetes, apo pohim i vetvetes, nga ana e eseistit? Apo është një shqetësim i madh, të cilin, disa vite pasi kishte botuar esenë kushtuar Eskilit, do ta shprehte më ashpër në ese të tjera me problematikë sociale, politike etj.?

Fjala dhe imagjinata përfytyruese

Në esetë kushtuar objekteve nga sfera e letërsisë, autori ndërton skena, situata të imagjinuara, që më shumë se sa pamjen reale i japin jetë jehonës, zhurmës së asaj për të cilën shkruhet, duke e bërë aspektin auditiv, në një kuptim, “të dukshëm”. Vizualiteti i krijuar nuk ka të bëjë me bollëkun e detajeve të përshkrimit të jashtëm e të brendshëm, por me peshën që merr fjala në realizimin e abstragimit, në gjallërimin e fantazisë, në gjetjen e formës konkrete emocionale të figurës. Fjala realizon njëkohësisht *pam-*


jen dhe *tingullin*. Të vetëdijshëm se personazhet e eseve të Kadaresë, në një kuptim, janë *pasqyrë e një pasqyre tjetër*, pra reflektim logjik mbi një trillim letrar, ne ndjejmë që edhe imazhi që Kadare-eseist krijon për to është i një lloji të veçantë. Ai mbështetet në një *proces të dyfishtë*: nga intuita krijuese e një artisti tjetër te intuita e interpretimit thellësisht subjektiv të eseistit. Ndryshe nga vepra letrare, ku fjala bart një aftësi të veçantë për krijimin e imazhit, në esenë e tipit kadarean lind pyetja: çfarë shohim te imazhi i figurave (autorë, personazhe, dukuri), që janë objekt i eseve? Mendoj se në thelb ne ndjekim **zhvillimin e ndërlikuar të logjikës dhe shpirtit të autorit**, mbi disa trillime të tjera ... Është autori që e kërkon fjalën, frazën, ligjërimin e plotë, apo ato vinë nga thellësitë e pavetëdijes për ta ndihmuar atë? Eseisti shkon në këtë plan drejt fjalëformimit jo si një dukuri artistike, por si rizbulim kuptimesh... Teoricienë të letërsisë kanë përcaktuar se letërsia i jep shtytje të mëtejshme gjuhës, dukuri që Kadare e ka shfaqur në mënyrë të jashtëzakonshme në letërsisë e tij. Por ky tipar fjalëformues, ose aftësia e fjalës për vetëformim, shfaqet edhe tek esetë. Të tilla si *të rrokakrejtshëm, larginë, demonobetonim, diktatura mund të quhet fare mirë fajnajë* Krijime të tilla, si *trillan, mosshqipëri, çlëndëzim, të hymnorë, Shqipëri mendonjëse, zenitizëm, nënëterezistat*, etj. janë pa fund. Ato vinë si struktura të reja, fjalore e tingullore, që mbartin struktura të reja emocionale-kuptimore, me ngarkesë të jashtëzakonshme në ligjërimin eseistik.

Dialog i narrativizuar.

Një ligjërim i papërcaktuar; pyetje pavetore, imagjinuese, dikush që pyet ose mund të pyesë; dialog midis zërash të paidentifikuar, jo realë, por që duken sikur vinë nga brendësia e autorit; pyetje pa përgjigje, që kanë brenda vetes një ankth, tmerr, dyshim; një kombinim paksa i turbullt midis pyetjeve, që ndërton rrëfimtari, dhe përgjigjeve që ai imagjino se duhet të jenë aty, të pranishme; kalime të papritura nga një moment tek një vepër tjetër, në kohë dhe hapësira të ndryshme, nga personazhi i letërsisë tek eseja. Gjithashtu, brenda kufijve të llojit krijues të esesë, kombinimet e ligjërimëve midis rrëfimit dhe dialogut, rrëfimi i zhveshur nga konkretësia, apo “ngatërrime” rrëfimesh, paralelizmat ligjërimore, etj. nuk janë maniere artistike; është intuita artistike që realizon një komunikim “të shqetësuar”, ku duket sikur autori, i shqetësuar, rend nga një epokë në tjetrën, trajtat ligjërimore ngatërrojnë kohët, hapësirat, kapërcime shekullore... etj. A mos janë këto teknika mënyrë e huazuar intuitivisht nga poetika postmoderniste? Mjegullimi i kufijve me letërsinë shfaqet në trajtat formale moderne e postmoderne të ndërfutjeve të pjesëve nga forma të tjera të krijimtarisë. Kjo “hallakatje ligjërimore” duket sikur do t’i marrë frymën lexuesit të esesë, i cili, papritur ndodhet para një universi ndjenjash, mëkatesh, krimesh, që duket sikur i ka pranë vetes.

Kundërthënia paradoksale

Është një konceptimi i veçantë ligjërimor që vjen në eseistikën e Kadaresë për të ndëshkuar edhe “të mëdhenjtë” e historisë, në marrëdhënien që ndërtuan ata me Shqipërinë. Imagjinata e jashtëzakonshme lidh një nyje të paimagjinueshme deri sot, midis dy filozofish: pranimit të Dantes dhe pushtimit prej shtetit të tij. Paradoksi nuk qëndron thjesht në këtë marrëdhënie kulturore dhe historike, por ironizon fenomenin absurd të marrëdhënies së pushtimit kulturor me pushtimin politik, fenomen gjithnjë i pranishëm në jetën e kombeve. *I gjen-dur befas midis rrebeshit, në një vend të vogël që ndoshta nuk ia kishte dëgjuar as emrin, ai, poeti i ndërgjegjes, ndëshkuesi i mëkatarëve, i cezarëve pushtues, i dhunuesve, i mashtruesve, duhej të ndihmonte popullin e vet italian të mbyste një tjetër popull. Edhe jo vetëm kaq, ta mbyste duke e përkëdhelur, duke i pëshpëritur në vesh: ti je në zemrën time (Albania e in mio cuore - Musolinit), ne jemi një familje tani, kemi një mbret dhe një ... poet të pare. (Dantja ... f. 250.)* Eseisti luan me kundërthëniet, në mënyrë iluzioniste, duke krijuar skenën ku diçka largohet, duke afruar njëkohësisht diçka tjetër tek lexuesi. Kjo është në ndër veçoritë e figuracionit të ligjëritimit eseistik të tij.



Personifikimi, metafora dhe ironia, tre shtyllat figurative të eseve.

Disa nga vëzhgimet tona vlejné për të njohur faktin se, në strukturën e brendshme kuptimore të figuracionit që ndërton, eseisti zgjeron kufijtë e figurës. Në distancën midis iluzionit dhe reales figura të tilla, si personifikimi, metafora, ironia, paradoksi etj. realizojnë ngarkesa emocionale mbi imazhe jo të zakonshme për përfytyrimin njerëzor. *Krimi u harbua*, shkruan eseisti, dhe përmasën e frikshme që mbart kuptimi i brendshëm i kësaj strukture ligjëri-more nuk e konkuron asnjë interpretim tjetër, politiko-shoqëror. Personifikohet, metaforizohet, ironizohet jo personazhi, i cili ose është real (historikisht), ose i formësuar më parë në trajta të tjera të krijimtarisë (në vepra letrare), por thelbi i brendisë që ai përfaqëson; personifikohet thelbi i një shteti, jo në specifikat normale të tij, por në devijimet, sëmundjet apo pushtetet e tij; personifikohet një kontinent për të ironizuar (*e kishte sjellë Europën, më në fund, këtu, siç sillej mushka xanxare*); personifikohet një dashuri, apo dhimbje, jo për ta njohur atë, por për të imagjinuar një marrëdhënie të re, një raport që kalon përtej figuracionit të drejtëpërdrejtë. Ironia / sarkazma, dëshmon se në eseistikën e Kadaresë ka vetëm një kahje: zemërim! Ka vetëm një ndjenjë: dhimbje të brendshme! Çifti figurativ ironi / sarkazëm vjen natyrshëm, i kërkuar nga të menduarit e autorit, por edhe intuitivisht, nga thellësitë e ndjenjës, të emocioneve të brendshme. Gjithashtu, duke patur parasysh thelbin e kuptimit, që mbart në grupin stilistikor kjo dyshe figurash, kuptohet se është problematika politike, sociale, morale ajo që 'dhunshëm' e kërkon këtë lloj ligjërimi. Dhunshëm, sepse eseisti, duke përjetuar zemërim, revoltë, dhimbje, ndaj disa dukurive të shoqërisë sonë, nuk ngurron të ironizojë (dhe ironia e tij është e hidhur!), të satirizojë (satira e tij është dërmuese!), të përfshijë nivele të ndryshme të dukurive që e dëshpërojnë dhimbshëm, që nga persona të diktaturës, të realitetit të sotëm (të paidentifikuar me emra), figura historike përtej Shqipërisë, studiues apo analistë delirantë (pa emra), të huaj apo shqiptarë, evropianë apo edhe fqinjë afër nesh... Por, satira që therr më fort është ajo që rrok vetë popullin e tij.

Lojëra me lexues të paidentifikuar

Ligjërimi me "Ti" është trajta më intime, por dhe universale e komunikimit njerëzor. Eseisti ndërton 'bisedë' me një lexues të përgjithshëm, të papërcaktuar, i ndodhshëm kudo: *ti e mendon ... ti heq dorë nga ... ti i përfytyron ... ti ndjen një farë nervozizmi* etj. Kjo trajtë ligjëri-more eseistike fsheh më shumë një zemërim të brendshëm, të përmabajtur, tingëllon si ftesë për zgjim, si provokim për lexuesin, një thirrje me finesë, për t'u afruar me shqetësimet e autorit. Duket si një synim për të rikujtuar shqetësimin njerëzor nga antikiteti deri në realitetet e sotme.

Loja me titujt shihet kryesisht tek esetë që objektin e reflektimit e kanë nga fusha e arteve, ku ligjërimi ka ngjyrimet e theksuara figurative, si p. sh: *Kushëriri i engjëjve*, *Arti i marrëzisë* ... Por kjo lojë titujsh haset, ndonëse më pak, edhe në esetë ku reflektimet e eseistit janë rreth problematikave të karakterit politik, social, historik etj, si *Dialog me djallin dhe Zotin* etj., ku kemi përsëri shmanje nga ligjërimi publicistik dhe prirje intuitive drejt ligjërimin artistik.

* * *

Do të ishte e pamundur të zbërthehej gjithë sistemi figurativ i ligjërimin eseistik të Kadaresë. Vemendja jonë është përqendruar në një aspekt: në faktin se ky sistem **zbulon përtëritje kuptimi**, ndryshe prej funksioneve që ka në një tekst letrar. Në ese autori i jep ligjërimin shtrirje tjetër, duket sikur **brenda një figure ka rikrijuar po atë**, por në një variant të ri. Të gjithë këto tipare, që janë dukuri të poetikës letrare, hyjnë vrullshëm në **ese**, ky lloj krijimi kaq i "çuditshëm", kaq "i paparashikueshëm" në strukturën kuptimore dhe formale të tij, duke na befazuar dhe duke i dhënë specifikë interesante eseistike të Kadaresë, tek e cila interpretimi **rikrijues figurativ-emocional dhe logjika e arsyetimit shkencor** shkrihen në mënyrë magjike.

PIKASO POSTMODERN I ROLAND GJOZËS

Nga Behar Gjoka

Romani *Pikaso prej ajri* i autorit Roland Gjoza, në tërësinë e elementëve thadruës, në narrativë dhe figurimin estetik, në ligjërim dhe plazmimin e personazheve, vjen në shekullin e ri, si befasi shkrimore e prozëshkrimit në gjuhën shqipe. Në frymën e vet është një tekst, që në mënyrë të veçantë, rrok dhe pikturon shpirtin dhe po kaq, hapësirat e pamatshme të tij, kurse si teksturë shkrimesie letrare, gërsheton dhe shpalon ngjyresat klasike dhe postmoderne, në strukturë dhe poetikën e rrëfimit.

Autori, vënë në gjurmim të shpirtërores, që përfaqëson arti dhe artisti (të cilët në këtë kohë duket se jetojnë në zgripin e vet ekzistencial), tashmë duke thirrur në kujtesë Pikason (veçse të shpërndruruar në mjeshtër të ajrit), piktorin që çuditë shekullin e kaluar, sendërtonte botën romanore, që ka për univers shpirtin e njeriut dhe të artistit.

Kjo rrethanë e pazakontë e vlerës së përthyer në hapësirat e tekstit romanor, si shenjëzim i poetikës postmoderne, të sjellë në mend idenë e Umberto Eco-s, ku nënvizon se në letërsi kemi: një estetikë, bosht i së cilës do të ishte ironia intertekstuale, në librin Si të shkruaj. Shpirti i atyre që kapërcyen detin, kohën dhe muret, njerëz të zakonshëm dhe artistë, sërish mbetet pezull dhe i ngurtësuar në dy përmallime, në dy ekstaza shpirtërore siprane, shpirti i qenies që mbetet shtegtimesh, e prejnga burojnë vizëllima disafishe të një proze ndryshe.

Gjendur, në cakun e fundëm të ekzistencës, ku të ikur nga dheu i parë, ata morën çka mundën, dhe pamëdyshje mallin njerëzor. Shpresandezur, në dherin tjetër, pranuan aq sa u dhanë, në fakt aq sa deshën pritësit, duke zgjuar megjithatë në të gjitha poret, shpresën e një jetë ndryshe. Për të kuptuar thelbin e situatës se kumteve të romanit, të diagramës së protagonistëve, ka vlerë nënvizimi i Borhes, kur shkruan: ... ku parandjenja fiton dhe hedh dritën e saj mbi një gjithësi që qëndron midis normës dhe absurdes, midis rregullit dhe rrëmujës, shpëtimi i të cilit, qoftë edhe pjesërisht, nga e pakuptueshmja i besohet vetëm njeriut. , pra shpirtit që udhëton nëpër pakohësi, në librin Aleph.

Kumti që shqipton tekstin, hapur dhe pa asnjë mbulim të realitetit, joshës dhe të përçudënuar, se shpirti gjendet në rrezik, gjithkund kësaj rrokullie, në atdheun që lanë pasë, por edhe në atdheun e ri, na zbulohet qartazi në frazën e rrëfimitarit: Amerika të jep

paranë, po të marrka zemrën. (2014: 34), e cila përçon me lakonizëm të thekur thelbin e qenies njerëzore, pa mëtuar të fsheh asgjë. Në këtë zgrip, etik dhe estetik, ekzistencial në thelbin e vet, as pesimist e as optimist, po një realizëm i ashpër, ndonëse zbulohet përmes magjikes, rreket që të lartoj ngrehinën e shpirtit, që duket sikur këtyre kohëve po lëshon grahamat e mbrame të mbijetesës.

Kërkimi i shpirtit dhe skalitja e shpirtërores, është shumëçka, është klithmë siprane, është akuzë ndaj zotave dhe kryezotave të tokës dhe qiellit, e mbi të gjitha është parafytyra e autorit, e një shpirti të trazuar, që ka mbet pezull dhe sërish zbrit në tokë, që mund të jetë i bardhë, i zi apo gri. Përthyerja e shpirtërores, me kaq shumë ngjyra, nëpër rrathët e artit, e pikturës abstrakte të Piksasos, e që tashmë nuk bie në sy, mbase vetëm kur shkarravit figurat në qiellin e kaltër.

Vetëm qielli ka mbetur i lirë, natyrisht në atë pjesën e paktë, që ka shpëtuar nga ndotja, e cila formulohet në stilemen rrëfimore: Se shpirtit i ka mbaruar vaji... (2014: 59). Magma e tekstit romanor, është shpirti, që shpalohet në disa forma. Shpirti si mungesë e plotë, në bëmat e Grejt dhe mjekëve, që ndërpresin shansin e jetës së Pikasos prej ajri. Po kaq sunduese, vjen shkëlqimi mediokër i blerësve të shpirttrave, i vlerave të artit, si Gilbi. Shpirti, në situatë siprane, zbulohet në katrahurën e kthjelltë të rrëfimitarit të gjithdihshëm, që endet rrafshëve të Ferrit dhe Purgatorit jetësor, velur tashmë nga Parajsa që nuk vlen më as në ëndërr...

Struktura moderne e romanit

Proza Pikaso prej ajri, shënon prurje estetike, në krijimtarinë e autorit, po kaq në lavrimin e zhanrit të romanit, në cakun modern të letrave shqipe, krahas shenjave të tjera, edhe për shkak të strukturës moderne të veprës. Tipologjia e shkrimit modern të prozëshkrimit, si dhe e shoqëruar me kahje postmoderne të ngjyresave letrare, materializohet në shumë aspekte strukturore të kompozimit të romanit:

A – Kapitulli i parë, nga autori emërtohet antiroman, me gjasë një vizion tjetër i shkrimit të romanit në letrat shqipe, por e hedhur ashtu, edhe si lojë apo shaka e kriposur, për të nisur udhën e kryerjes se disa ndryshimeve të nevojshme në tipologjinë romanore, që në letërsinë shqipe të shekullit të kaluar dhe në vijim, vijon të mbetet zhanri



letrar, më i parapëlqyer nga autorët, e po ashtu edhe lloji letrar më i lexuar nga lexuesit. Mbase, në këtë tekst të prozës së gjatë, si një gjetje rastësore, përcaktimi si antiroman, në krye të veprës, lidhet me tepër me sugjerimin e teorive letrare, se romani vijon të jetë një zhanër, i hapur dhe në formësim të vatrave ligjëri-more.

B – Paraqitja e ndodhive të romanit, konkrete dhe imagjinare, veçmas e asaj pezullie ku gjallon qenia njerëzore, sidomos mbijetesë e qenies shqiptare, e ndarë dhe hapërdarë si zogjtë e korbit, në të gjitha pikat e horizontit të planetit tonë, ndërkaq është realizuar në tridhjetë e tre kapituj. Secili prej këtyre pasazheve, të veprës romanore, shoqërohet me nga një nëntitull, që e zgjeron hapësirën e komunikimit modern të prozës, por njëherit sendërtonte njësi strukturore dhe rrëfimore, thelbësisht autonome, madje që jetojnë më vete, duke qenë njëherit pjesë integrale e tërësisë së veprës.

C – Prania e një stileme strukturore dhe narrative, të emërtuar interlud (i huaj) prej shkrimtarit, që shkojnë në dhjetë episode të tilla dhe shoqërohen me numra, ku nënta përsëritet, me nëntë plus, e diku edhe me tituj. Funkcioni estetik, i mozaikut rrëfimor të interludit, është pjesa më e beftë e romanit, sepse:

- Krijon mjaft pauza të pashmangshme të daljes nga tuneli i makabritetit të rrekjes së mbijetesës shpirtërore të qenies, ku autori e përthekson: ... për recesionin e shpirtit, që ishte më i tmerrshëm se ai i parasë, nuk shqetësohej njeri, (2014: 176).

- Shenjëzon gjurmët e ngjyresave postmoderne, jetësore dhe shkrimore, që si stileme estetike, mishërohet përmes risemantizimit të historisë, artit dhe letërsisë, e sidomos të figurave të shumta të historisë njerëzore, që dëshmuar vlerat e humanitetit, që megjithatë udhton bashkarisht me rrezbitjen e plotë të vlerave shpirtërore.

Shëmbëllimet e pranishme figurative Në kohët moderne, gjithnjë simbas teorive letrare, marrëdhëniet me artin dhe letërsinë, sidomos me arealin modern, bëhen më të hapura dhe më të ndërthurura, ndërmjet fushave dhe lamive të ndryshëm, që shpesh shkojnë gjer në sinkretikë të unifikuar. Letërsia, vetvetiu bëhet më e hapur ndaj arteve të tjera dhe po kaq ndaj lamive të mendimit. Prej hapjes së pashmangshme të lëvrimin letrar, pra përfshirjes në materien artistike të lëndëve të tjera, artistike

(Vijon në faqen 9)

Topika lart, sipër, mbi

Zanafilla e rrëfimit poetik tek grekët, por jo vetëm tek ta, domosdoshmërisht reflekton masën e njeriut në raport me hyjnitë, varësinë prej të cilave deri në një moment maturimi ai (njeriu) e pa si zgjidhjen më të mirë. Poeti Homer është i zhveshur nga ndjenja e autorësisë: në zanafillën e poetikës së rrëfimit babai i letërsisë është niveli bazik, thënë ndryshe, niveli i parë, që përkon me poetin parak. Këtij poeti, domosdoshmërisht, i duhet t'i drejtohet Muzës, pa ndihmën e së cilës nuk ka rrëfim poetik... *Me futjen e hyjneshës në skenë Homeri i tregon bashkësisë së dëgjuesve jo vetëm faktin se hyjnesha e dëgjoi dhe e pranoi lutjen e tij, por edhe faktin se tashmë nga kjo pikë, ai vetë është dëgjues dhe rrëfyes njëkohësisht: është veshi i zgjatur përballë hyjneshës dhe "goja" që rrëfen përballë bashkësisë...*¹

Po si e motivon Homeri këtë raport varësie prej Muzave dhe ç'kuptim ka ky motivim? Do të na dukej i shpërdoruar dhe, për më tepër, i pamjaftueshëm argumenti i hyjnorësisë së Muzave. Përtej këtij argumenti autorët më pas Homerit dhe Hesiodit, (për të mos përmendur fetarët monoteistë) nuk japin shpjegim apo motivim, duke u mjaftuar me hyjnorësinë dhe pas tyre, po me këtë argument, mjaftohen edhe dëgjuesit, apo më vonë lexuesit.

Por Homeri është i pari, qoftë edhe konvencionalisht, prandaj, në mënyrë pagane, i duhet të motivojë epërsinë e Muzave përkundër njerëzve, siç duket në vargjet:

*Rrëfemëni tani Muza që në Olimp
strehën keni*

*Ju jeni hyjnesha, jeni kudo, shihni
gjithçka*

*Ne dëgjojmë thjesht zhurmë, s'dimë
kurgjë*

*Cilët ishin udhërrëfyesit e Danajve
dhe cilët prijësit?*²

Që në vargun e parë, *Rrëfëni Muza që mbi Olimp strehën keni*, Muzat vendosen mbi Olimp dhe pas kësaj vendosjeje olimpike, të qenit kudo nuk mund të lidhet me zhvendosjen e tyre tokësore-hapsinore. Kështu falë topikës olimpike (**lart, sipër, mbi** Olimp), Muzat legjitimohen në të drejtën e rrëfimit, ndërkohë që hyjnorësia e tyre i legjitimon në të drejtën e banimit (mbi Olimp).

Akohësia dhe Ahapësia

Këndvështrimi formalist i kohës absolute, si kohë e papërfunduar, që e karakterizon veçanërisht eposin, parë në logjikën e poetikës së Muzave, domosdoshmërisht të çon në perceptimin e një *një tashmërie të përgjeshme, e cila është edhe horizonti i vetëm brenda të cilit lëvizin dhe në dritën e të cilit ato* (Muzat, shënimi im, SK) *njohin*.³ Përndryshe do të kishim kundërthënie, sepse, siç do të përpiqemi të argumentojmë më poshtë, nuk mund të legjitimohej e drejta për rrëfim.

Koha ahistorike në këtë rast, vjen si mungesë e kordinatave kohore, të cilat normalisht në aspektin historik, do të paraqiteshin si tabela kohore me referenca të qarta ngjarjesh, datash, heronjsh,

1 A.Haxhiymeri, Sh.Doda. *Estetika 1. (Një histori e Ndërgjegjes dhe e mendimit Estetik)* Ideart, 2013, fq 141

2 A.Haxhiymeri, Sh.Doda. *Estetika 1. (Një histori e Ndërgjegjes dhe Mendimit Estetik)*. Ideart, 2013, fq 170.

3 Mihail Bahtin. *Epi dhe Romani*. (Në përmbledhjen Çështje të romanit, Rilindja, Prishtinë, 1980)

POETIKA E MUZAVE

Nga Skënder KARRIQI

periudhash, epokash etj. Në kuptimin e një sistemi koordinativ, koha, si kohë ngjarjesh, hyn në relacion me hapësirën, si vendi ku ndodhin ngjarjet. Por, në qoftë se bëhet fjalë për mungesë të kordinatave kohore, (dhe me këtë ka lidhje akohësia apo koha ahistorike), dosdoshmërisht do të bëhet fjalë edhe për mungesë të koordinatave hapësinore, (dhe me këtë ka lidhje ahapësia apo hapësira avendore). Në logjikën e poetikës së Muzave, akohësia apo koha ahistorike, e po kështu ahapësia apo hapësira avendore, nuk të thonë mungesë e kohës dhe e hapësirës, por relativizim të funksionit të tyre deri në të dhëna formale (kohë formale, hapësirë formale), për shkak të sistemit të referimit.

Në imagologjinë mitologjike ky sistem referimi (relativizues) vjen në dy rrafshë. I pari është rrafshi hyjnor-qiellor, ku në *majë (lart, sipër, mbi)*, shënimi im, SK), *jepet Zeusi i rrethuar dhe përhitur nga Mnemosini, nëna e tërë Muzave, Terpsihora, Muza e vallzimit, Euterpi, Muza e muzikës, Melpomeni, Muza e tragjedisë, Thalia, muza e komedisë, Apolloni, hyu i arteve, etj.*⁴Rrafshi i dytë është ai njerëzor-tokësor, ku *Homeri na jepet i fronësuar, i rrethuar e i përhitur ndër*

4 A.Haxhiymeri, Sh.Doda. *Estetika 1 (Një histori e Ndërgjegjes dhe e Mendimit Estetik)*. Ideart, 2013, fq 102.

*të tjera, nga Historia, Poezia, Tragjedia, Komedia, Natyra, Vyrtyti, Kujtesa, Besimi dhe Urtësia, ndërsa pas krahëve të tij qëndron Mbarëkohësia dhe Mbarëbotësia.*⁵Po të kujtojmë këtu se Homeri s'është veçse veshi i zgjatur përballë Muzës dhe goja që flet për dëgjuesit, atij i mbetet të jetë pika e kontaktit të vizionit hyjnor, pra mbarëkohësisë dhe mbarëbotësisë, që do të thotë akohësisë apo kohës ahistorike dhe ahapësisë apo hapësirës avendore. Të dy rrafshet dallohen nga topika **lart, sipër, mbi** ku është Zeusi, dhe **poshtë**, ku i fronësuar është Homeri.

Për Bahtin-in, *bota epike është e ndarë nga bashkëkohësia, përkatësisht nga bota e këngëtarit (autorit dhe dëgjuesit të tij) me distancën absolute epike*⁶. Ndërkohë që kemi sqaruar se këngëtari (Homeri, aedi apo rapsodi) nuk është autori i këngës, por vetëm veshi që e dëgjon dhe goja që e e transmeton ngjarjen në shenjën e këngës, më tej na duhet të sqarojmë se Bahtin, kur aedin e quan autor⁷, nuk e sheh çështjen në logjikën e poetikës së Muzave. Por një konceptim i tillë sjell boshllëk në legjitimimin e së drejtës së rrëfimit. (Për çarsye duhet t'i besohet autorit Homer jashtë lidhjeve të tij me Muzën eprore (**lart, sipër, mbi**)

5 A. Haxhiymeri, Sh.Doda. Vepër e cituar, fq 101.

6 Mihail Bahtin, përmbledhje e cituar.

7 Mihail Bahtin. Përmbledhje e cituar.

? A nuk është ai jashtë këtyre lidhjeve, i barabartë, në të njëjtin rang hierarkik, me dëgjuesit e tjerë?). Nga ana tjetër distanca epike është pikërisht largësia e të parit të ngjarjes, dhe ajo (distancë epike), kur qenka e largët, e ndarë nga bashkëkohësia e autorit, në kohë dhe në hapësirë, si mund të jetë e perceptueshme dhe e rrëfyeshme prej tij? (Me këtë shpjegim motivohet edhe paralajmërimi i mësipërm për kundërthënie)

Arsyeja e legjitimitimit të së drejtës së rrëfimit, ka kushtëzuar strukturimin e formulave hyrëse të tipit: *Rribën rrëfe, hyjneshë, të Pelidhit pinjoll Ahilit ...*⁸, përndryshe, *Këndo hyjni mënin e Akil Pelidit...*⁹Janë pikërisht këto formula hyrëse që bëjnë kontaktin e aedit Homer me *mbarëbotësinë* dhe *mbarëkohësinë* si një akt që ka lidhje me fuqitë eprore (Hyjnitë, Muzat, **lart, sipër, mbi**). Në këtë moment kontakti dhe në vazhdim, përgjatë rrëfimit epik, ato (koha dhe hapësira) nuk përkojnë me kohë ngjarjesh dhe hapësirë (vend) ngjarjesh: ato janë vendkohe, sintetizim ky që përmbahet në semantikën e distancës epike si hapësirë informative. Me këtë rol të këtyre formulave hyrëse lidhet edhe përjetimi i karakterit disi magjik të tyre nga ana e lexuesit të sotëm dhe, aq më tepër, e dëgjuesit të periudhës antike arkaike.

Në këtë këndvështrim, thelbi i poetikës së Muzave është një çështje topologjike, që do të lëjë gjurmët në periudhën e romanit. Bëhet fjalë për kohën e romanizimit të klasikes, e cila, përveçse si materie kulturore monumentale, do të mbijetojë brenda llojit të ri letrar, romanit, si materie stilizuese, deri në imazhin e rrëfimitarit të gjithëdijshëm, por kjo kohë paraprihet që në krye të herës nga autorësia.

Zanafilla mitologjike e autorësisë

Përballja krahasuese e dy të vjetërve, Homerit dhe Hesiodit, ndër të tjera, na bën të kuptojmë se dallimi i tyre është thelbësor dhe se pikërisht ky dallim ka qenë ruajtësi më i mirë i tyre nga ligji i harresës seleksionuese nëpër kohëra. Është thënë se Homeri nuk e kishte idenë e autorësisë. Koncepti i autorit *i cili bosh-tohet tek "egoja" autoriale ...shfaqet krejt i huaj për Homerin ...i cili nuk resht së kujtuari audiencën për natyrën joveitake të poezisë së tij, se autori i rrëfimit nuk është ai, por Muzat...*¹⁰ Edhe mitologjikisht, si koncept i aedit parak, Homeri nuk e nënkupton të qenit autor. Në antikitetin e hershëm autorësia lidhet me shqisën e të parit (*Ju jeni hyjnesha, Ju jeni kudo, shihni gjithçka*¹¹).

I pazoti objektivisht për të prodhuar materie poetike epike, (për shkak të sistemit të referimit dhe masës së tij njerëzore), aedit Homer i duhej të dëgjojë, madje ta kishte të mprehtë shqisën përkatëse, e cila bëhej e tillë, aq më tepër në kushtet e reduktimit absolut të shqisës së të parit. Me përparësinë e shqisës së të dëgjuarit dhe mangësinë e shqisës së të parit, mitologjikisht Homeri është projektuar si një transmetues i këngës apo rrëfimit të Muzave, të cilat janë, siç thotë vetë aedi Homer, autoret e rrëfimit të ngjarjes që ai rrëfen në kuptimin e transmetimit dhe shenjën e këngës. Për Homerin kategoria e dëgjimit është një akt marrës dhe kategoria e këndimit

8 A. Haxhiymeri, Sh.Doda. Vepër e cituar, fq 134.

9 Homeri. *Iliada*. Përkthyer nga Gjon Shllaku. Tiranë, 1979.

10 A. Haxhiymeri, Sh. Doda. Vepër e cituar, fq 110

11 A. Haxhiymeri, Sh. Doda. Vepër e cituar, fq 199.



është një akt dhënës. Në këtë funksion marrës dhe dhënës, ai, jo vetëm që sytë i kishte të panevojshëm, por do ta pengonin në perfeksionin e dëgjuesit mitik dhe autentik të Muzave.

Evokimi i Orhan Pamukut

Sipas rrëfimit të Orhan Pamuk tek *Unë jam e kuqja*, kundërshtia e shqisës së të parit me intuitën abstraguese të piktorëve oborrtarë, në kulmin e periudhës sulltanore përgjatë historisë së kulturës perandorake otomane, ishte shenjë e shkallës së talentit. Verbimi i plotë i piktorit (dekorator të oborrit sulltanor) ishte konfirmimi hyjnor i shkallës më të lartë të talentit. Vetëm atëhere atij i jepeshin në mënyrë të merituar postet më të larta në fushën e vet dhe i besoheshin porosi me rëndësi për oborrin sulltanor; vetëm atëhere ai fitonte nxënës të shumtë dhe kishte të drejtën e shkollës. Duke arritur në shkallën absolute të verbimit, piktori dekorator çlirohej prej vizioneve tokësore, virtualizohej dhe mund të ruante pastërtinë e vizioneve hyjnore. Verbëria në këtë rast ishte një arritje, ishte shkalla më e lartë e pjekjes së talentit, (i cili në këtë rast nuk ka kuptimin autorial të krijuesit: në të kundërt ai ka kuptimin e njeriut me aftësi të rralla interceptuese të vizioneve hyjnore). Si arritje, si shkallë pjekurie, verbimi nuk ishte dhunë dhe aq më pak bëhej me dhunë. Ai ishte një çlirim ngazëllyes dhe kishte filluar me defunksionalizimin e shqisës së të parit për shkak të lidhjes së vazhdueshme dhe intensive të subjektit me vizionet hyjnore, të cilat i shfaqeshin jo në rrugë optike, por përfytyruese ndiesore, përjetuese, meditative. Që nga ky moment piktori në këtë shkallë të pjekjes së talentit, nuk kishte më nevojë për penela, bojëra dhe telajo: ai kthehej në një përçues të vizionit hyjnor, gjë që e bënte nëpërmjet bisedave me nxënësit në atelienë (punishten) e vet.

Ky është imazhi më i fundit letrar që sjell Pamuk mbi transmetuesin e verbër (si pasojë e virtualizimit) të vizioneve me origjinë (autorësi) hyjnore dhe që u përket shekujve XIII-XIV të historisë së kulturës perandorake otomane, që do të thotë se lidhet patjetër dhe është shenjë e padiskutueshme e trashëgimisë së asaj hapësire kulturore, ku u mbruaft imazhi mitiko-legjendar i aedit të verbër Homer (parakut), prej Smirine, përndryshe Izmirit të sotëm.

Nga ana tjetër, për t’u kthyer tek përparësitë dhe mangësitë shqisore të Homerit, të cilat e funksionalizonin atë si transmetues të rrëfimit të Muzave, është e dukshme dhe e mirëtheksuar përparësia e shqisës së të dëgjuarit tek ai. Një perceptim të tillë dëgjuesi i erës aktive të eposit, por edhe lexuesi i erës monumentale të tij, që nga fillimi kur ai u shkrua e deri më sot, e arrijnë nëpërmjet foljeve në urdhërore, (lutëse) siç duket qartazi që në vargjet hyrëse: *Këndo hyjni mënin e Akil Pelidit*, apo *Rribën rrëfe, hyjneshë, të Pelidhit pinjoll Ahilit*.¹² Kështu çështja e autorësisë së Homerit kuptimësohet jo si një çështje e autorësisë së mirëfilltë krijuese, por e autotësisë së transmetimit. Me Homerin pra, ende nuk kemi takuar autorin. Atë do ta takojmë më pas, mund të themi shpejt, në kufi të periudhës arkaike të letërsisë antike greke, dhe pikërisht me Hesiodin.

(Vijon nga faqja 7)

dhe shoqërore, në zhanrin e romanit, buron dhe formësohet sinkretika, pra bashkëshkrirja e ligjërimeve të ndërsjella, letrare dhe artistike, si dhe më gjerë se kaq.

Varësisht kësaj optike, të artit dhe letërsisë moderne, romani Pikaso prej ajri i Gjozës, arrin që të ndërthur dhe të shkrijë në njësi të vetme, fjalën artistike, ngjyrën piktorike dhe imazhin e fotografisë. Fjala, pra letërsia me të gjithë hallkat e kumteve letrare, e në këtë tekst të zhanrit të romanit, është rrëfimi si mjet dhe konceptim estetik, që projektonte një botë imagjinare. Megjithatë, sidomos në letërsinë e mirë, fjala letrare është tingull, e po kaq është dinamike dhe ritëm. Në hapësirat e romanit, vihet se fjala si rrëfim, ndërkohë shoqërohet nga dy-tre shëmbëltime figurative:

- Shëmbëllimi pamor piktorik, jo dosido, po shëmbëllimi i Pikasos, mjeshtrit të pikturës, që dihet që e sundoi shekullin e kaluar për magjinë piktorike, kryesisht me ngjyresa të një abstrakcioni unik. Pikaso, megjithatë këtu është vetëmse shkasi apo shtysa fillestare, sepse Pikaso i autorit, pra Pikaso prej ajri, vjen i përmbysur, kinse i transformuar në gjithë mënyrën e ekzistimit të vet, madje shërben si gjetje ironike për të shenjuar marrëdhënien e ndërlikuar të qenies me shpirtëroren.

- Përballë shëmbëllimit të parë, shpesh herë në pranëvënie me të është edhe shëmbëllimi i dytë, pamor dhe fotografik, i Gjon Milit, që pavarësisht ndryshimeve tepër të rëndësishme me

pikturën, jetësimin dhe përmasën e përjetësisë së shumëçkaje të kësaj bote, megjithatë ia shtampon fotografia.

- Në mes tyre, si një shëmbëllim imagjinar, që lidhet me fjalën, me magjinë e letërsisë, është gdhendur figura e Ernest Heminugejt, njëri nga autorët më të zëshëm të shekullit të njëzet, që i dha ngjyra të paimagjinueshme hapësirave të realizmit, si dëshmi e brezit të humbur dhe e teknikës së ajsbergut.

Të strehuar në vatrën e fjalës, në një situatë të kërkuar dhe të shenjuar artistike, dy shëmbëllimet pamore, piktorike dhe fotografike, si dhe të shoqëruar në hapësirat e tekstit romanor nga dy figurat më përfaqësuese të këtyre shëmbëlltyrave, Pikaso dhe Gjon Mili, e në mes tyre Heminguej, të tre këto pamje dhe tre gjeni të artit dhe letërsisë, e zgjerojnë ndjeshëm përmasën e imagjinare në vepër, tashmë si ton i ngjyresave të realizmit magjik, si ritëm i kumteve postmoderne, që restauron dhe rishkruan historinë e qenies, e artit dhe letërsisë, gjithnjë simbas kodeve të autorit.

Vatrat e larmisë rrëfimore

Limfa më përbashkuese e veprës, e të gjitha hallkave strukturore të saj, e copëzave të titulluara nga autorit si interlud (i huaj), si dhe e shumë trajtave të ndryshme të shëmbëllimeve letrare dhe pamore, piktorike dhe fotografike, është ngjyresa totale e narrativës autoriale. Narrativa ose poetika e prozës, siç e ka përcaktuar pak kohë më parë, T. Todorov, është gjurma e rrokshme


e kumteve letrare në prozëshkrim, po ashtu edhe në lavrimin e zhanrit mbizotërues të saj, në tipologjinë e romanit bashkëkohor. Narrativa e tekstit të romanit Pikaso prej ajri, si për çdo prozë tjetër, përbëhet:

Së pari: Nga pozicioni i rrëfimtari, që në këtë roman formësohet në tipologjinë e narratorit të gjithëdijes, një tipar i shkrimit të prozës moderne. Pra, duke qenë rrëfimtari, me natyrë të gjithdijshme, si qendër e universit shkrimor, të kohës dhe hapësirë së romanit, narratori bart peshën kryesore të ecurisë dhe pauzave të përshkrimit dhe skicimit të personazheve, duke endur kështu një poetikë dinamike, që luan me ngjyrat, me dritat, me tingujt dhe fjalët, shpesh si magjistar.

Së dyti: Materializmi gjuhësor i pentagramit rrëfimor, që mundëson thurjen e realitetit letrar imagjinar të prozës. Fjalësia narrative e autorit, në hapësirat e romanit më të ri të Gjozës, shpërfaqet në shumë pamje; është ritmike, është e ngjeshur me figurshmëri dhe nëntekst, është portretizuese dhe karakterizuese e personazheve të shumtë, që plasohen në të gjitha vetitë përfaqësuese, të botës së brendshme dhe të skicimit të portretit fizik, e mbi gjithçka fjala e rrëfimtari, që end në këtë formë realitetin letrar, ku konkretja pushitet me imagjnaren, është shenjë estetike e prozës moderne.

Lidhur me mishërimin letrar dhe gjuhësor, është edhe situata e pranishme e fjalëve të reja, që sugjeron autori, duke materializuar kështu idenë e përkujdesjes së krijuesve për gjuhën në të cilën shkruajnë, në lamin e pasurimit të saj. Sa për të krijuar një ide, po sjellim pranë lexuesit disa nga rastet tipike të neologjizmave që përçon autori në hapësirat e romanit Pikaso prej ajri, si: çudnajë, kukullnajë, katrahurmshtëm, zymtnajë, kotni, krockamëroi, tërëmbushëse, brafulluan, ktrahurnajë, bubutishme, brofëritës, gjakndezëse etj. , krijuar me brumin e shqipes, që të përkujtojnë sugjerimin e Tomas Eliotit dhënë për gjuhën.

Gjoza me tregimet e dikurshme, po kaq a diç më tepër me lëvrimin e romanit, dëshmon se është mjeshtër i rrëfimit, që pavarësisht unit të krijuar në kaq tekste, shpesh të fanit vatrat rrëfimore kuteliane. Nga sa ofron teoria letrare, thelbi estetik i prozëshkrimit, pra edhe i romanit si zhanër i gjatë, mishërohet përmes rrëfimit, që e përthyen botën në një pamje tjetër, në mënyrë të veçantë kërkon shpirtëroren në të gjitha format ekzistenciale të saj, që në rastin e autorit të romanit Pikaso prej ajri, përcjell një mesazh të beftë: Arti është protestë, po s’pati arti protestë, mbetet kukull e bukur. (2014: 132), që të vë në mendime të thella mbi kredonë shkrimore të autorit, që tingëllon edhe si një thirrje ironike ndaj artit për art dhe vetë antiromanit. Pra, për pranuar sugjerimin e shkrimtarit, të derdhur në hapësirat e romanit, vështrojmë pohimin e Roland Barthes, teksa theksonte: shkrimi është rrënim i çdo zëri, i çdo prejardhje, në librin Aventura Semiologjike. Megjithatë, autori duke këmbëngulur dhe shqiptuar se letërsia është zëri i kohës, i njerëzve të një kohe të caktuar, madje kur ajo është gri dhe tepër e mjegulltë, duket se është besnik i letërsisë dhe artit që jeton me fatin e njeriut.



Në shumësinë e përbotshme të bukurive dhe mirësive, kryevlera më e çmuar është dashuria, kontrolluesja e ekuilibrit të botës dhe e drejtpeshimit të aspiratës zhvillimore të trashëgimisë materiale e shpirtërore të shoqërisë njerëzore, brez pas brezi. Dashuria është e përgjithshmja e infinitit të veçantive, njëra prej të cilave, - nga më të shkëlqyeshmet, - është dashuria ndërmjet gjyshërve dhe nipërve e mbesave. Përvoja gjithënjëzore e ka vërtetuar se kjo dashuri përbëhet nga mrekullia e mrekullive, sepse e ka aureolin e shenjtë që, me plotëkuptimin e fjalës, realizon ndërlidhjen e hyjnore me shpirtëroren.

Gjeniu popullor i ka quajtur nipërit dhe mbesat “mjalti i mjaltit të shpirtit”. Këtë vlerësim e kanë vërtetuar mendjet më të ndritura të artit, kulturës e shkencës, ata që, me shekuj, veprat e tyre më të mira ua kanë dedikuar nipërve dhe mbesave dhe anasjelltas, nipërit dhe mbesat ua kanë kushtuar gjyshërve. Kësaj rrjedhe i bashkohet dhe e pasuron edhe vëllimi me tregime për fëmijë “40 gjyshër rrëfejnë”, i Bajram Sefajt, gazetarit, publicistit dhe shkrimtarit të mirënjohur, i cili me krijimet e shumta e të shumëllojshme, me dekada e ka joshur qenien kombëtare shqiptare të Kosovës, duke ia forcuar qëndresën dhe ecjen racionale drejt dritës së lirisë.

Shkrimtari i madh shqiptar për fëmijë, Odhise Grillo, thoshte se “në suksesin e çdo krijuesi, talenti është një përqindëshi, ndërsa 99 për qind i përkasin punës”. Ai shtonte se “këtë raport e ndryshojnë vetëm krijuesit me talent të rrallë...”, pra, ata të cilët nuk i ndahen lapsit e letrës dhe dëshmojnë talentin e tyre duke shkruar vepra të veçanta artistike.

Pa anim ndjenjash miqësie, dua të them se Bajram Sefaj është një talent i tillë. Me lapsin e tij ai ka hedhur në letër qindra krijime, të cilat, jo vetëm që janë mirëpritur nga lexuesit dhe kritika, por ato janë quajtur shkrime model, si në gazetari e publicistikë, ashtu edhe në krijimtarinë letrare, duke bërë që librat e këtij autori të radhiten në fondin e veprave të zgjedhura të letërsisë shqipe. Ky vlerësim i përket krijimtarisë së tij për të rritur, por, me gjasë, ka nevojë për rivlerësime plotësuese, duke qenë të bindur se edhe krijimtaria letrare për fëmijë e Sefajt është njësoj e denjë për t’u radhitur ndër vlerat më të mira të letërsisë shqipe për fëmijë.

Dëshmia më e re vjen me librin “40 gjyshër rrëfejnë”, ku janë përfshirë dyzet rrëfime të gjyshërve, apo më saktë, janë përjetësuar artistikisht dyzet portrete të personaliteteve më elitare dhe më

Bajram Sefaj: “40 Gjyshër rrëfejnë”, tregime për fëmijë, ShB “Faik Konica”, Prishtinë – 2021

Rrëfime për mjaltin e mjaltit të shpirtit

Nga Skënder ZOGAJ



domethënëse për Kosovën dhe për shqiptarët e stërvuajtur të Ballkanit, të cilët pas civilizimit më të lartë në rruzullin tokësor, janë djegur e shkatërruar mizorisht, janë groposur në tokë dhe janë mbuluar me errësirën e zezë, me qëllim që të hidheshin përgjithmonë në harresë.

Kësaj gjëme të lashtësisë historike i rikthehet tërthorazi Bajram Sefaj, për të treguar se mizoritë serbe, sado të egra kanë qenë, nuk kanë arritur ta shuajnë kujtesën historike të shqiptarëve, sepse ata, pors i Feniksi, janë ringjallur nga hiri i vet dhe i janë rikthyer jetës dhe traditës së tyre të lashtë, rrënjët e së cilës i ka ruajtur nëntoka. Prandaj, shkrimtari e nis rrëfimin letrar me Arkeologun. Gjyshi Arkeolog i flet Nipit për zbulimet e arkeologëve tanë që dëshmojnë për një civilizim mijëvjeçar të shqiptarëve në këto troje, duke rrëzuar tezat e rrejshme dhe mitin mesjetar serb, se gjoja Kosova na paska qenë “djep i popullit serb”!

Gjerdani letrar i Sefajt vazhdon me tregimin “Akademiku”, ku Gjyshi Akademik ia shpjegon nipit prejardhjen, kuptimin dhe funksionin e fjalës akademik, njeriun

e pajisur me dituri të larta shkencore apo artistike, që u përket mendjendriturve, atyre që përbëjnë trurin e kombit.

Në këtë formë shtrirje të shkrimit letrar, autori e zgjeron bashkëbisedimin ndërmjet gjyshërve dhe nipërve e mbesave me dyzet figura elitare të eminencës së shoqërisë shqiptare. Ato radhiten sipas shkronjave të alfabetit, siç janë me shkronjën A: “Aktori”, “Ambasadori”, “Albanologu”, “Agronomi”, “Avokati”, “Arkitekti” e “Astronomi”; me shkronjën B: “Biologu” e “Botuesi”; me shkronjën D: “Dekani”, “Dentisti”, “Dirigjenti”, “Docenti”, “Doktori” e “Dramaturgu”; me shkronjën E: “Ekologu” dhe “Epidemiologu” e kështu me radhë, deri të shkronja V: me tregimin “Veterineri”, me të cilin përmbillet vargu i dyzet tregimeve të mrekullueshme. Ato rrjedhin si valë ujëvare, me lëndë të pasur përmbajtjesore dhe freski artistike, duke shpalosur me invencion kreativ galerinë e personazheve lirike dhe botën e tyre të pastër shpirtërore.

Dyzet nipër e mbesa kureshtare dëgjojnë me ëndje, pors i në përralla, ligjërimet e gjyshërve të tyre mendjendritur, të cilët ua

fisnikërojnë zemrat dhe mendjet me njohuri të reja nga jeta dhe fushat e ndryshme diturore. Ky është lajtmotivi i të gjitha tregimeve dhe është poenta kryesore e shkrimit letrar të Sefajt.

Gjyshi Ambasador, ia sqaron nipçes se “fjala ekselencë në gjuhën e bukur shqipe do të thotë shkëlqesi, se në gjuhën shqipe ajo tingëllon bukur dhe është, sa poetike, po aq edhe kuptimplotë”. Ndërsa Biologu - Gjysh, i tregon mbesës se shkenca është një “det i madh”, një “oqean i pafund” dhe se “Bota me të gjitha qeniet e gjalla mbi tokë, është përherë në lëvizje, në zhvillim”.

Autori mbledh dijen e Gjyshërve eruditë, pors i blea nektarin, për t’i gatuar tregimet në formë të përrallave, me porosi të shumta e të shumëllojshme edukativo mësimore, përmes të dhënash konkrete, nga realiteti i shoqërisë së sotme shqiptare.

Mesazhet e këtyre tregimeve kapen lehtë, në saje të diskursit funksional dhe të mirëfilltë artistik, i cili reflekton ndikim të vlefshëm etik dhe estetik te recipienti. Autori i tregimeve arrin që përmes të folurit të figurshëm midis personazheve ta dinamizojë pulsën dhe intensitetin e narracionit.

Ja, si realizohet ky synim artistik te tregimi “Filozofi”, ku zhvillohet ky dialog i bukur dhe shumë dashamirës:

‘ - Sot, i dashur Nipçe, do të ngjitemi në katin 471 të “Kullës” sonë, -tha Gjyshi,
- Ku është kjo kullë kaq e lartë, Gjysh?
- Në raftin e tretë të vitrinës, në studion time.

- Kulla në raft, Gjysh? Ç’është ky llaf?
- Të pastë Gjyshi, ty! Jemi dijetarë unë e ti, apo jo? Po flasim me figura. “Kulla” është Fjalori, kurse “kati 471” – faqja 471 e tij.


Aty, Nipçe, do t’i gjejmë shpjegimin që po na duhet sot. Së pari, çdo të thotë fjala filozof?...”

Kjo dhe shumë pjesë të tregimeve të tjera nxjerrin në pah fenomenin letrar të përafërimit të qëndrimit “militant” me atë “meditant” të autorit dhe i njëjtësimit të tij me veprën e vet, ku, “i kthehet njeriut e jo sistemit dhe krijon figurën e vet të veçantë, autentike dhe të vetëmjaftueshme, pa e llogaritur funksionin e saj si kompensim të krijimit”**.

Të dyzet tregimet e librit të Sefajt janë plotësisht të mëvetëshme. Mirëpo, ato njëkohësisht shkrihen brenda një diskursi të përbashkët letrar që është realizuar përmes imazhesh dhe tablove me ndjesi të kthjellëta emocionale, si dhe përmes dialogësh dhe monologësh të ngjeshura metaforike. Duke i veshur tregimet e tij me ngjarje, gjendje, veprime dhe situata të veçanta, autori ka arritur të pasurojë me sukses nëntekstin e tyre, por edhe të shpëtojë nga “rreziku” i rrëfimit stereotip. Këto tregime, pors i dyzet qirin që ndezur, lëshojnë rreze të ngrohta drite dhe motiveve për lexuesit. Si rrallë në ndonjë vepër letrare, lexuesit e këtij libri do të ballafaqohen këndshëm me kolosë të fuqishëm dhe të dobishëm, me më mendjendriturit dhe më zemërtarët e shoqërisë njerëzore - Gjyshërit.

Libri “40 Gjyshër rrëfejnë”, ndonëse është shkruar për fëmijë, me lëndën letrare dhe mënyrën e strukturimit të saj përmbajtjesor e artistik, prek me ndjeshmëri problemet jetike të realitetit jetësor, preokupimet e përgjithshme dhe të përjetshme të njeriut. Kjo e bën këtë libër të rëndësishëm dhe të dobishëm për të gjitha moshat e lexuesve, sepse, të gjithë kanë rastin të njihen e të mësojnë gjëra interesante e shumë të dobishme, nga historia, kultura, shkenca, artet, profesionet e ndryshme, doket e zakonet, që nga lashtësia deri te pandemia e Coronavirusit Covid-19, që po e kërcënon gjithë njerëzimin, ngjashëm me Kolerën e vitit 1918, që ua kishte marrë jetën 50 milionë njerëzve.

Nga të dhënat e shumta në këtë libër me tregime të Bajram Sefajt, lexuesi bindet sa shumë ka pasur të drejtë gjeniu popullor, që ka thënë se njeriu mplaket duke nxënë!



TASH TI ECËN

poezi nga

Antoine Simon

përktheu: Anton Pappleka

QIELLI KTHJELLET

Qielli kthjellet
tërë qielli që ti mban brenda vetes

ti ecën
ata që ti i takon
të quajnë shteg kodrinë
lumë pyll heshtje
dhe në këtë heshtje të thellë
ata kanë po atë emër që ke ti

ndoshta do të vijë një ditë
kur fjalët do të të braktisin
si një fantazmë që nuk e përmendin më
ndoshta edhe trupi yt
nuk do të ketë më nevojë të vijë pas teje

nga lartësia e gjithë asaj që je
ti sodit një jetë të dikurshme
ku shpresa të vockla
i jepnin gjallëri botës sate mendore

gjithçka varej nga kaq e kaq gjëra
nga kaq e kaq veprime të rastit
saqë ajo nuk qe jetë për të qenë

megjithatë ajo qe jeta jote
me të gjitha kokëçarjet
që t'i terratisnin pasqyrat

tashti që gjithçka është në rregull
ditën ti mund të prehesh
kalo ashtu siç kalon dita
dhe ditën qëndro ashtu siç je

TI ECËN EDHE NË UNIN TËND TJETËR

Ti ecën edhe në unin tënd tjetër
në atë të përditësisë që i ndryshon vazhdimisht
pamjet
përkatesitë

ti ecën nëpër lajmet e fundit
të kësaj jashtësie të botës
ku gjithkush më kot
përpiqet të kacavaret

te kjo jashtësi pa ashpërsi
te ky shkëmb i thepisur i ndryshimit
pandemia që vret botën
ngrohja klimatike
dhe të gjitha çështjet për të cilat je pro
dhe të gjitha çështjet për të cilat je kundra
kur njëri i je gozhdës e tjetri potkoit

ndoshta zgjidhja do të ishte
ta mbanim në frigorifer planetin
për një periudhë të pacaktuar

ti ecën përmes lajmeve
dhe përmes lajmeve më të fundit
që ndjekin e përndjekin njëri-tjetrin
por asgjësohen ngaqë janë pak si tepër

asnjë lajm nuk është diçka e re
sapo të ketë kaluar kepin e të njohurës
që bëhet element i të kaluarës
ti e nxiton hapin përherë

për të shkuar më larg sesa ky uni yt
që e humbet kohën me kotësira
të grumbulluara nën hapat e tu
hapa kaq të vendosur
saqë ata nuk lënë gjurmë
një gjueti që nuk ka të mbaruar

KUR VËSHTROJ TJETRIN

Kur vështroj tjetrin
dhe shoh se ai është ndryshe nga vetja ime
kjo do të thotë se vështrimi nuk ka mundur të vërë re
të vërtetën e gjërave
ka çaste kur gjërat bëhen të errëta apo përzgjedhjet
duket sikur hapen
kur në realitetin e parë nuk ka asnjë përzgjedhje

relative? absolute? Nuk ka të vërtetë
ka veç një mori vështrimesh
ka një udhë nëpër të cilën dielli shkon drejt perëndimit
dielli e mohon identitetin e tij
nuk kam asgjë për të thënë për diellin
në mos qofsha unë dielli

të jesh diell nuk është një privilegj
të jesh gjithnjë aty
pavarësisht nga shtrëngatat që shpërthejnë
pavarësisht nga retë e nga shiu që të mohojnë

NGANJËHERË VIJNË CA FJALË

Nganjëherë vijnë ca fjalë
ca mendime
ato nuk kanë ndonjë vlerë
poetike
të vetmet fjalë që ti dëshiron t'i ruash
janë ato që vijnë pa menduar
fjalët që vijnë nga thellësia e qenies
që nuk janë automatizmi
syrealist
që nuk janë një shtyrje për më vonë
e torturës së psikizmit
e psikanalizimit
por e diçkaje më të thellë sesa këta
e diçkaje edhe më universale
e asaj që vjen nga ajo thellësi e qenies
ku qenia nuk është e veçantë
e identifikuar
e veçuar

TË ECËSH PËR TË MOS HARRUAR

Të ecësh për të mos harruar
sesi ta vësh një fjalë para tjetrës
sesi ta mësosh çdo fjalë
deri te pika ku ajo ka kuptim
të ecësh për të mësuar hapin
që nuk është një mohim
por fillimi i ligjërimit

të ecësh me ritmin e krahëve të tu
të ngarkuar me ar e me mirrë
si një blatim që i bën vetvetes secili

të ecësh deri atje ku të shpie ylli
që bredhërit para teje
larg çdo qielli larg çdo toke

të ecësh më 25 dhjetor
kur xixëllojnë ngjyrat
deri te skuta më e thellë që ke në dhomë

të ecësh në heshtjen e thellë
që të shoqëron kur vdes ti
në çdo çast që rilind

TASH TI ECËN

Tash ti ecën
për herë të parë ti ecën
për herë të parë kur vjen dita ti ecën
për herë të parë kur vjen çasti
një çast pas tjetrit
një çast i vetëm
i shkëputur nga pjesa tjetër e kohës
aty nuk ka kohë
ti nuk ke kohë të ecësh
ecja nuk është një kohë
ajo nuk është një hap
nuk ka asgjë negative në një hap
të kapërcesh botën në çdo hap
të kërcesh mbi pengesat që ndërpresin peizazhin
të kuturisësh
të kapërcesh caqet
të çlirohesh nga caqet
të dalësh nga korniza
hap pas hapi
nuk ka dy hapa
mund të hedhësh vetëm një hap
në të njëjtën kohë
i çliruar nga pjesa tjetër e botës
dhe në çdo hap
bota lëviz më tej

POEZIA VJEN TEK TI

Poezia vjen tek ti
përmes këmbëve
çdo hapi i takon fjala e tij
poezia vjen nga toka pas çdo hapi
poezia të rrit pulsin
të përfshin në vorbullën e saj
ritëm magjik vodù viç i artë
asnjë vend nuk është i veçantë
gjithçka të flet për ty
gjithçka hedh valle
çdo degë të ngjan e afërt
jeta e saj është jeta jote
zhurmat e botës janë një këngë
e sajuar nga hapa të qetë
vështrimi yt sheh vetveten
sepse pikërisht ai është përreth teje
njerëzit që takon janë ti por ata nuk e dinë
ata ecin me krenari në gjakun tënd
e nganjëherë të pengojnë me zhurma parazite
midis kaq e kaq mendimesh të errëta
midis kaq e kaq gjestesh të mëdyshura
në drejtim të kundërt me hapin tënd
me hapin tënd që e bën botën të vijë tek ti
si një duaj flakësh
që vallëzon në erë

ti lëviz i shqetësuar në mes të rrëmujës
që është veç rendi i keqkuptuar
të cilit njerëzit nuk i binden si duhet
kur gjithçka është në vendin e vet
në vendin tënd

shqisat e tua nuk e përgjojnë botën
ato janë bota
fjalët e tua nuk janë paraqitja e botës
ato janë bota
gjethet e rëna nën hapat e tu
janë një libër i hapur
pemët që rriten buzë rrugës
janë një libër i hapur
bota është një libër i hapur
që nuk ta japin për ta lexuar
sepse ai libër je ti

ç'siguri e pabesueshme
të jesh i vetëdijshëm se ti je bota
dhe ç'vërshim dashurie

Pyetësoni "Librat e jetës sime"

YLLJET ALIÇKA

Libri me të cilin dua të mbahem mend?
"Metamorfoza e një kryeqyteti"

1. Libri që po lexoj ndërkohë:

"Serotonina" e Michel Houellebecq

2. Libri që më ka ndryshuar jetën:

Efektshmëria e fenomenit "të ndryshuarit të jetës" ka qenë kushtëzuar, a diktuar nga faza të ndryshme të moshës, të kohës e sidomos të emocionit që buronte nga statusi libër i ndaluar ose jo, pasi pranohet se shija e leximit apo aftësia thithëse e një libri shtohet ndjeshëm kur në një regjim të rreptë censure të bie në dorë një libër i ndaluar.

Natyrisht kjo varej dhe nga rrethanat, pra se cili libër i ndaluar të binte rastësisht në duar. Bie fjala, një herë kur rastësisht më ra në dorë një libër në anglisht "Imoralisti" i Andre Zhidit, mbaj mend që efekti ishte tronditës, gati trulllosës.

Përtej rastësive të librave të ndaluar ose jo, në kohëra të ndryshme përgjithësisht them se më kanë lenë mbresa të thella libra të tillë si "Portret grupi me një zonjë" e Hajnrih Bël, "Vdekje në Venecia" të Tomas Mann, "Përçmimi"



i Alberto Moravias, "Koncert në fund të dimrit" e Kadaresë, "Ferri i çarë", i Visar Zhitit...

3. Libri që do të doja të kisha lexuar

Ka shumë, dhe sot ndjej peng të madh që pjesë të madhe të jetës sime e kam humbur, a rralluar ndjeshëm ritmin e leximit, ndërkohë që ka aq shumë libra të mirë që nuk i kam lexuar dhe që druaj se nuk do t'ia dal dot t'i lexoj...

Por siç thoshte një këngë e viteve 70' "Bisogna saper perdere..."

4. Libri që pati ndikimin më të madh në shkrimet e mia

Janë disa: "Viti i vdekjes i Rikardo Rais" i Saramagos, "Novela e tregime" të Çehovit, tregimet e Heminguejit...

5. Libri që më ndryshoi mendjen

"Armëpushimi" i Primo Levit

6. Libri i fundit që më bëri të qaj

S'e mbaj mend, mbase kur kam qenë i ri duke lexuar "Tre shokët" e Remarkut.

7. Libri i fundit që më bëri të qesh

Dikur në rini kam lexuar një libër të një autori thuajse të panjohur, përkthyer e botuar në Shqipërinë e asaj kohe, përzgjedhur kushedi se për çfarë arsyeje: "Zjarr në kadastër" i një autori që nuk ka lënë ndonjë gjurmë në mozaikun e letërsisë italiane, a më gjerë, Carlo Montela.

Atëkohë, u befasova se si mund të bëhej letërsi kaq argëtuese me jetën rutinë të nëpunësve të një qyteti provincial në Italinë e Jugut, në limontinë e jetës monotone, pa ndonjë ngjarje të bujshme, shoqëruar kjo me një stil ironik, thuajse neutral në dukje...një humor tipik i neorealizmit italian (realizuar më pas në një film të ngjashëm të një regjizori të dashur për mua, Ermanno Olmi, te filmi "Il posto")

Këto kohë jam argëtuar shumë duke lexuar "Dita e mbetur" e Ishiguro Kazuo.

8. Libri që më vjen turp që s'e kam lexuar ende

Janë shumë: "Komedia hyjnore", "Bibla", "Kurani", veprën e plotë të Borhesit, Dostojevskit...

9. Librat që kam dhuruar

Kryesisht librat e mi, por shpesh më ndodh që kur dhuroj ndonjë libër timin, përfutuesi i dhuratës më ndrron rrugën sa herë që rastis të kryqëzohem me të. Natyrisht, e kuptoj që nuk e ka lexuar librin dhe i vjen zor të ma thotë.

Madje në një rast, dikush që më kishte blerë në panair një libër timin, kur e pyeta pas ca kohësh mbi përshtypjet, mu kthye i habitur :interesant me ju shkrimtarët e sotëm, pak se po jua blejmë apo pranojmë librat si dhuratë,po doni që dhe tjua lexojmë...Kush ka kohë sot, o burrë!!!

10. Libri me të cilin dua të mbahem mend

"Metamorfoza e një kryeqyteti"

11. Libri që me bën të ndihem mire

"Një rrëfenjë me ndërkombëtarë", "Parrullat me gurë"...

12. Libri që mendoj se është më i nënvlerësuar

Nuk kam ndonjë keqardhje në këtë drejtim, përgjithësisht ato pak libra që kam shkruar më janë vlerësuar nga lexuesi apo kritika Brenda dhe jashtë vendit...

KËNGA E DASHURISË E J. ALFRED PRUFROKUT

poezi nga
T. S. Eliot
përktheu: Arb Elo

*S'io credesse che mia risposta fosse
A persona che mai tornasse al mondo,
Questa fiamma staria senza piu scosse.
Ma perciocche giammai di questo fondo
Non torno vivo alcun, s'i'odo il vero,
Senza tema d'infamia ti rispondo.**

LERNA të shkojmë atëherë, ti dhe unë,
Kur mbrëmja t'i jetë shtrirë qiellit përkundër
Si paciente nën efektin e eterit përmbi tryezë;
Lerna të shkojmë, ndoca rrugëve gjysmë të shkreta,
Drejt strehës që na e pëshpërit vetja.
Netësh pa prehë të hoteleve të lira njënetëshe të
përvidhesh
E restaurantesh ku s'shihesh prej tymit, me guaska
midhjesh:
Rrugësh që të vijnë nga pas si një argument që të bezdis
Ndaj mëtimt të një shtrati thuajse pis
Për të çuar ty drejt një pyetjeje përmbaruese...
Oh, mos më pyet pra, "Ç'kemi?"
Lerna të shkojmë, ta bëjmë, të vemi.
Nëpër odë gratë venë e vijnë e shkojnë
Për Mikelanxhelon bisedojnë.
E verdha mjegull që kruan të pasmet mbi xhamat e
dritares
E verdha mjegull që kruan jashtëdaljet përmbi xhamat
e dritares
Lëpiu gjuhën e saj nëpër skajet e mbrëmjes së vonë,
E spërkati mbi pellgjet që shtrohen e rrijnë kanaleve,
E lëshoi të pasmen e saj mbi zgjyrën që bie prej
oxhaqeve, zdralëve,
Nëpër terracë e ngjeu, shkiti, u hodh, kërceu papritur,
E pasi u vu dhe vuri re që qenkësh një natë e butë tetori
U fshi sërish përqark shtëpisë dhe gjumi e mori të
kapitur.
Dhe vërtet do t'i vijë përsëri koha
Tymit të verdhë që endet rrugëve, që shkon ndër to, u
vjen pas,
Tek kruan të pasmet mbi xhamat e dritares;
Do të vijë përsëri koha, do të vijë përsëri
Për të gatitur një fytyrë që të hasë fytyrat që paske
hasur;
Do të vijë koha që të vrasësh e të krijosh,
E kohë për të tëra veprat dhe ditët e duarve të tua,
Që ngrenë dhe mbajnë pezull ashtu një pyetje osh;
Koha jote do të vijë dhe një kohë edhe për mua,
Dhe një kohë poashtu për njëqind shtratmëtime,
E për njëqind përmbarime, të tjera mëtime, rishikime,
Pa të mbajmë përkundruall çaj dhe toast ndër duar.
Nëpër odë gratë venë e vijnë e shkojnë
Për Mikelanxhelon bisedojnë.
Dhe do të vijë gjithashtu vërtet një kohë tjetër
Për t'u çuditur, "A më lejon?" dhe "A më lejon vallë?"
Një kohë për t'u ndarë e për të zbritur nëpër shkallë,
Me një shogë të hershme për moshën e re në kokë a në
ballë-
(Të tjerët do të thonë: "Sa shpejt nisën t'i bien flokët!)
Me pallton e paradites unë, fytin dhe kravatën të bërë
njësh, tok,
Qafore e shtrenjtë e përmbajtur, e mbajtur veç nga
gjilpëra me kokë-
(Të tjerët: "Ka rënë, është holluar krahë e këmbë, është
përtokë!)
A më lejohet
Të të bezdis pak o univers?
Në një minutë është një kohë e tërë
Për vendime e rishikime që po atë minutë kanë për ters.
Si i kam marrë vesh ndërkaq ato, më pas i di të tëra:

Di mbrëmjet e vona, di mëngjeset, i di pasditet,
Kam matur me lugë kafeje tërë jetën time, ditëpërditë;
Di përmendësh se si meken kur zënë e shuhen zërat
Ndanë muzikës që vjen prej një ode tjetër pritjeje.
Pra, çka tjetër më duhet të mëtoj për vete?
Dhe sytë i di përmendësh tani, përmendësh i di të tërë
sytë-
Sytë që të fiksojnë në një frazë të formuluar siç duhet,
Dhe kur i formuluar jam, fjongo mbi gjilpërë asisoj,
Kur jam shpuar e i jam bërë njëj murit si kravata në fyt,
Si më duhet t'ia nis, nga duhet t'ia filloj
Për të nxjerrë jashtë pas-fundet e mbrëmjeve, të
ëndjeve?
Dhe ç'tjetër më duhet të mëtoj me vete?
Dhe llërët i di përmendësh tani, përmendësh i di të tëra
llërët-
Llërët e fshehura nën byzylykë, të bardha e të zhveshura
aq
(Që nën dritën e çelur të llambadarëve flokët kaf" të
çelët i veshin paq!)
Mos qenkësh vallë parfum që vjen përkëtej nga ndonjë
fustan
Që më bën t'i përdal kaq keqas vetes, që po më bën
nopran?
Llërët që shtrihen mbi tryezë, krahët e mbështjellë nga
ndonjë shall.
Dhe çka tjetër atëherë më duhet të mëtoj?
Dhe nga e si më duhet t'ia nis e ku t'ia filloj?
.
Mos duhet vallë të them që kam shkuar në muzg do
rrugicave të ngushta
Dhe u paskam kundruar tymin që u ngrihet prej llullave
apo prej pipave
Ca burrave të vetmuar mëngëpërveshur, t'përdalë ca më
jashtë dritareve?...
Do të duhej të kisha qenë një nga palat e kapura me
mbërthecka të tjera atypari
E ca gaforreve që enden ujërave të heshtura, t'ëmblla
apo pa kripë fare, përfund.
.
Dhe pasdreka, kahmbrëmja, mbrëmja ca më pas, fle aq
paqësisht!
E topitur nga gishta të zgjuar hajnë, të gjatë,
E përgjumur ... e lodhur ... a simulante që bën sikur aq e
pat,



U jepet përdhe e tëra, ndanë nesh, këtu unë dhe ti.
A mos më duhet, pas çajit, ëmbëlsirave dhe akulloreve,
Të mbledh fuqi për të dhunuar çastin drejt krizës së vet
kulmore?
Se ndonëse i jam përgjëruar, e kam agjëruar, i jam qarë
e i jam lutur,
Ndonëse paskam paraparë kryet tim (të shogët,
flokërenë pra) të servirur mbi pjatancë sak,
Profet unë s'jam - dhe kjo s'ka rëndësi fare, kjo s'ngre
peshë aspak;
I paskam paraparë vetes çastin e përndritjes, atë më
madhështorin,
Portierin e përjetshëm tek më merr pallton e ikën,
kërcëllitjen e dhëmbëve, vrikun, fundorin,
Dhe për t'i rënë shkurt, paskam patur frikë.
Dhe a do të kishte patur ndopak vlerë, tekefundit,
Pas atyre kupave, pas marmelatës, pas çajit,
Mes porcelanit, mes ca bisedash tuaja, të mia paskëtaj,
A do të kishte patur ndopak vlerë ndërkaq,
Të hapej ajo temë, ajo faqe, me një buzëqeshje e aq,
Të bëhej universi top, të ngjeshej gjekund veç për kaq
pra,
Të rrokullisej drejt ndonjë çështjeje apo dëshirimi të
pangeshëm,
Të thuhej: "Llazari qenkam unë, sapo u ktheva nga bota
tjetër,
U ktheva që të t'i rrëfej të tëra, në mundem tekefundit"-
Nëse tjetra, tek i vë një nënkresë përfund kryes së vetes,
Do të thoshte: "S'ish kjo ajo që doja të thoja tekefundit,
S'është kjo çka doja të thoja, tekefundit."
Dhe a do të kishte patur ndopak vlerë, në fund të fundit,
Do të kishte patur ndopak vlerë ndërkaq,
Pas perëndimeve, barit të në hyrje të shtëpisë, rrugës
me pluhur, të spërkatur,
Pas romaneve, pas kupave me çaj, pas fustaneve dhe
fshikjes së tyre në korridor-
Pas tërë këtyre dhe shumë të tjerash si këto?-
Është e pamundur pra të shprehet ajo çka unë
nënkuptoj!
Por nëse një llambë magjike do t'i shfaqte nervat si
thurima mbi një shtrojë:
Do të kishte patur vlerë ndërkohë
Nëse dikush, tek vë një nënkresë a mbështillet me shall
atypari,
Duke u kthyer drejt dritares, do të thoshte megjithatë:
"Kjo s'është ashtu fare,
Kjo s'është ajo që doja të thoja unë, asfare."
.

Jo! Princi Hamlet s'jam unë, as nuk po doja të isha si ai;
Jam zotëri në pritje, në hyrje, dikush që po do në prag
T'i hapë udhë progresit, t'i hapë një skenë a dy, pra pak,
Këshillë për princin: dyshime s'kam, mungesë e vyer
kjo,
Diferenciale, gëzohem që e përdor sak,
Politike, e kujdesshme, që më ruan për merak,
Plot me urtësi të lartë, ndonëse mendjemangët pak;
Hera-herës, vërtet, pothuajse qesharake,
Ngjanjëherë pothuajse torollake.
Po plakem unë ... Po plakem unë ...
Këmbët do t'i shtrij përnatë sa jorgani, në mos: atë do ta
rrudh.
T'i kreh flokët pas që të fsheh të rënët? Të guxoj të ha
një pjeshkë?
Do të vesh pantallona të bardha prej liri, do të endem
në breg, do të mbaj vesh
Sirenat kur i këndojnë shoshoqes. I kam dëgjuar, ende
s'i kam marrë vesh.
Nuk besoj se do të më këndojnë mua.
I kam parë tek ia kalëronin valët detit andej-këtej
Të shtronin flokët e bardhë të valëve të gufuara nga pas
Kur era e gufon në të zi e në të bardhë ujët që le pas.
Kemi shpalosur të linjtat, shtrojat, odave të detit
Ndanë çupave të tij me alga të kuqe e kafe për brerore
Sa të na zgjojnë zëra njerëzorë nga fundosja prore.

*Ky pasazh është shkëputur nga "Ferri" i Dantes dhe i përkthyer nga italishtja do të thotë:
*Në do të besoja që përgjigjia ime do t'ishite për dikë,
do t'i jepej dikujt që s'do të kthehej kurrë më në botë,
kjo flakë do të ngrinte, s'do të dridhej, s'do të epej më.
Mirëpo, ngase askush s'kthehet më gjallë, as motmot,
dhe askurrë q'andej, në paça dëgjuar vërtet të vërtetën,
gjegj atë çka di, pa iu drojtur turpërimit kësisoj të kotë.*

DJALI NGA QYTETI

tregim nga

Artur Spanjolli



Ai rrinte me mëdyshje ngjitur pas murit. Nuk dinte akoma Aq të bënte. Do të ishte më mirë të futej në dhomë apo jo? Nga pas murit vinin zërat e burrave të cilët bisedonin me një ton të lehtë dhe dashamirës. Vinte gjithashtu aroma e fortë e dyllit të bletës. Ajo aromë mbytëse, dehëse e hojeve të sapo vjelura. Kur fuste kokën tek kazani ku mblidhej mjalti i trashë, aroma ishte aq e fortë dhe dehëse sa i pushtonte flegelat e hundës, i futej me alarm nëpër mushkëri duke arritur deri në ndërgjegje. Një aromë që arrinte ta veliste tërësisht, dhe pastaj gjëja e parë që bënte ishte ta refuzonte ngrënjen e mjaltit.

Demiri ishte mjeshtër në artin e bletëve. Dinte gjithçka mbi to. Zërat e burrave vinin akoma përtej murit, nga dhoma e miqve. Ai tetë vjeçar nguronte të futej brenda. C do të bënte atje? Në përgjithësi, nëpër shtëpiat e xhaxhallarëve, kur ato ishin në punë ai bridhte gjithkund i lirë, sidomos gjatë orëve të nxehta të gushtit, kur dielli i mbasditës gati sa nuk plaste tjegullat nga tmerri i vapës dhe heshtja e dhomave thyhej vetëm nga zhurma e mizave në ajër. Gjithmonë në atë orë, nuk kishte asnjëri nëpër tre shtëpitë e tyre.

Ato, jo vetëm ishin puntorë të palodhur, por kush jetonte në fshat, kishte gjithmonë diçka për të bërë. Ai rrinte nën heshtjen mbytëse të sallorit duke pritur që Betimi apo Naimi të ktheheshin nga punët e bujqësisë. Por shpesh, i kapur befas nga malli, dëshironte të ishte në qytet. Donte të ishte atje, duke lozur me shokët poshtë pallatit.

Atë mbasditë ishte krijuar një gjendje pak si e sikletshme. Në përgjithësi rrinte mirë në tre shtëpiat e kusherinjve, shperndare mbi koder nga ku veshtrimi perqafonte pafundesite.

Tani rrinte i vetem prapa murit, me zemrën që i rrihte fort. Donte të hynte mes burrave, por aty e pengonte prania e diçkaje, e dikujt. E diçkaje dhe e dikujt. Ishte një histori që kish ndodhur vite më parë. Një histori të cilën e kishte dëgjuar kushedi sa herë netëve të dimrit në familje, por të cilën nuk e kishte kuptuar kurrë si duhet. Mbi të gjitha, nuk i kishte dhënë asnjëherë përgjigje. Përkundrazi, kish prodhuar tek ai një largim instiktiv nga të tjerët. Doemos, që do dëgjonte prindërit. Si e mendonin ato, ashtu duhej ta mendonte edhe ai. Duhej t'i dëgjonte, ai ishte pjesë e atij mendimi, ajo ishte e verteta e familjes. Në atë moshë, kur akoma njeriu nuk din si të sillet, nuk e ka akoma mënyrën e vet të të menduarit, ai duhej ta mendonte si ato. Të rriturit. Prindërit e tij.

Tani, tek rrinte mbeshetur prapa murit, dëgjonte bisedën dhe nuk kuptonte diçka. Ato të dy, ardhur nga qyteti ishin aty, nuk flisnin mes tyre por megjithatë ato nuk shmangeshin. E dinte mirë, por ama, tani ishin të gjithë bashkë. Me kusherinjtë e tjerë, ashtu siç qëndrohej mes burrave. Si ishte e mundur? Mund të rrinin bashkë dy persona të cilët nuk i kishin lënë pa thënë asgjë njeri tjetrit? Ishte e mundur diçka e tillë? Ishte e mundur pra të kryqezoheshin vështrimet e tyre? Ç pyetje mund t'i drejtonin njëri tjetrit? Ishte e mundur pagja mes dy krijesash të të njëjtit gjak të cilët, prej vitesh tashmë, kur ecnin rrugës, bënin sikur nuk e njihnin më njëri tjetrin?

Shumë pyetje që i vinin nëpër mend donin përgjigje. Ai, djaloshi tetë vjeçar, nuk ishte i aftë t'i gjente ato. Ku qëlluan xhanëm, të dy familjet, ishin gjendur aty, në të njëjtën kohë.

Ishte kohë rrushi, fiqsh dhe bletësh. Ndodheshin në fshat. Aty ku babai tij kish lindur dhe akoma gjashtë vjeçarë, bashkë me familjen, ishte spostuar në qytet.

Ishte fund gushti. Ndërsa ullinjtë vilesnin në vjeshtë. Në vjeshtë nuk kish qenë asnjëherë. E njihte atë vend vetëm në gusht. Nën piskun e vapës kur pluhuri i thatë dhe i nxehtë i xhades ngjitej nëpër këmbët e zbathura. Tregonin se në vjeshtë, me shirat dhe baltën që ishin të pa durueshme, të jetoje aty ishte një ferr i vërtetë.

“Pra e paskan shtyrë natën gardhin komshinjtë!”
“Po, more burrë. Ato nuk kanë të drejtë! Ne i njohim kufijtë! Jemi këtu prej vitesh!”

“Pastaj ç’ndodhi? U kapët burra e gra me vegla pune!”
“Ato na ranë në qafë vetë, na provokuan!”

“Ketu duhet forca e rendit. Vetëm ato mund të vendosin rregullin!”

“Të lutem Bio. Më ndihmo. Unë jam i vetmi burrë që mbroj këto tre shtëpia. Hekurani vdiq. Beqo si Beqo, gjithmonë në punë. Nuk jetohej me frikën se mund të bëjnë si t'i dojë qejfi! Ky vend ka zot! Ti njeh në qytet shumë njerez. T'ia mbyllim gojën një herë e mirë!”

“Unë të ndihmoj, por ti mos bëj si ta thotë koka. Deri sa të zgjidhet kjo punë, ti rri urtë! Përndryshe rrezikon burgun!”

Ai, nga prapa murit, vazhdonte të dëgjonte gjithçka. Nga aty ku ishte, shihte kokën plot kaçurrela mishtore dhe trupin e bëshëm dhe të shkurtër te axhës, i cili kur qeshte tregonte dhëmbin e argjendit. Nga aty dallonte optimizmin prej babaxhani të atij burri, të cilin e njihte fare pak.

Figura e tij kishte qenë gjithmonë si një hije misterioze. Një prezencë në distancë, aq shumë shamata kishte dëgjuar për të. Në ndërgjegjen e tij prej fëmije, axhës nuk duhej ti afrohej.

Nuk kuptonte. Si mund të mbahej larg një njeri i cili nuk i kishte bërë asgjë të keqe?

Ishte ngazëlluese tek i shihte tani bashkë të dy “armiqtë” e një gjaku. Ndoshta një tabu fëmijrije po binte? S po kuptonte. Ato urreheshin por tani, qeshnin, diskutonin dëgjonin.

Përtej murit vinte zëri i babait. Zëri i tij i mprehtë, i lartë, dominues.

Me siguri të rriturit gjykonin ndryshe. Nuk flisnin, por kur duhej ato flisnin duke u shtirur sikur të mos kishte ndodhur asgjë. “Sa për sy e për faqe!” kishte dëgjuar nga plakati e lagjes. Ndryshe nga fëmijët të cilët kur mbanin mëri, mbanin mëri me gjithë shpirt, të rriturit paskan kodet e tyre.

Një ngazëllim fëmijror gati i pashprehshëm me fjalë, një emocjon i paimaginueshëm e pushtoi gjithkund. Ishte sikur dikush ti fliste me shumë dashuri.

Me siguri, mendoi, silleshin ashtu për rrespekt të mikut të shtëpisë. Me siguri shkëmbenin fjalë sa për sy e faqe. Ishte një situatë e çuditshme. Diçka nuk shkonte.

Me zemrën që po i shkallmonte gjoks, dy tre herë ishte bërë gati të hynte. Në heshtje të ulej mbi minder dhe të dëgjonte më të medhenjtë, i dehur nga ai ngazëllimi fëmijror. Donte që gjithçka të ishte perfekte, por tepër i emocionuar, ndërroi mendje.

Duhej. “Sot nuk është momenti!” mendoi. Shpesh ulej dhe dëgjonte bisedat e më të mëdhenjve. Kishte mësuar shumë histori nga të mëdhenjtë. Filloi t'i rrihte zemra fort nga emocjoni dhe filloi të dridhej. Një dallgë e shpirtëzuar e rrëmbeu në çast si një erë e marrë emocjonesh të panjohura, kurjoze. Vrapoi jasht sapo pa siluetin e Bardhit që rrinte poshtë ullinjve. “E din që tek

Kisha, ka një thesar?” i pëshpëriti ai. Djali nga qyteti e pa me kujdes. “Ç thesar thua?!”

“Atje tek rrenojat e Kishës se vjetër të spanjollëve, fshihet një thesar!”

“Kush ta ka thenë?!” pyeti ai, më zë të ulët.

“Arkeologë nga Tirana. Ato na e kanë thënë!”

“Kanë gërmuar?!”

“Po. Kanë gjetur vetëm vazo të vjetra, dhe monedha deri tani!”

“Shkojmë atëherë. Marrim kazma dhe lopata dhe ikim!” shtoi tjetri. U betuan ta mbanin sekret atë çfarë kishin ndër mend të bënin. Rrëmbyen veglat e punës dhe iu futen rrugës për të shkuar tek kodra ku gjendej: “Qisha”.

Dielli përcëllonte dhe shtigjet e rrëmujshme ishin plot ferra dhe driza. Ecnin mes fierave dhe shkurreve duke shmangur kaçubet pa fund, dhe rruga bëhej gjithnjë e më gjarpërues dhe e lodhshme. Ecnin zbathur, duke shkelur dheun e fortë plot pluhur te thatë me frikën se gjembat do t'i nguleshin nëpër mishrat e shputave. Shtrëngonin veglat e punës dhe vazhdonin të ecnin në heshtje mes shtigjesh torturuese. Hijet e tyre zgjateshin përpara. Me diellin nga shpina ishte më e lehtë ecja dhe pse djersa shkishte nëpër shpatulla, trup duke e bërë lëkurën ngjitëse.

Në atë orë vape, kishte veç këngë gjinkallash dhe turtulleshash dhe nuk lëvizte askush. Një puhizë e lehte frynte anekënd. Një puhizë vere, e nxehtë, plot aromë fshati, e cila me pëshpërimat e erës, e shtonte ndjesinë e emocjoneve fëmijrore.

Djali nga qyteti kishte veshur pantallona të shkurtëra doku, bërë pis. Ishte e pamundur mos katranosesh në fshat, ku gjithçka, çdo lojë përzihej me njolla frutash, lëndë ngjitëse druresh, rrëshirë plepash, pluhur dhe grricje nga ferrat.

Nuk kish mësuar kurrë të ecte zbathur. Shputat e këmbëve të buta prej qytetari, nuk ia lejonin. Ndryshe nga shputat e djemve të fshatit, të rregjura, si shollë gomari, të tijat ishin delikate, të buta, të adhurueshme. Kishte veshur një bluzë të bardhë, por edhe ajo ishte bërë pis. Kur arritën atje, lanë shtamën me ujë në hije dhe vështruan rrënojat e gurëve të Qishës.

“Ku do të gërmojmë?!”

Bardhi, i gjatë, dhe i qeshur, i kishte sytë kaf. Shikonte nga kushëriri dhe po i tregonte me gisht rrënojat. Ishin gërmadhat e nje ndërtese te lashtë ku tashmë kishin mbetur veç disa gurë të shpërndarë anekënd. Dukeshin themelet prej guri të një muri. Gjithçka ishte rrënuar nga indiferenca e kohës.

Gurët ishin të veshur me myshk dhe ishin krejt të pluhrosur. Gjithkund, mes ferrash dhe drizash, një erë e nxehtë fund gushti, nga ku dielli përvëlues digjte si saç, i përkëdhelte lëkurën. Ishte një fllad plot erë të mirë toke e lënë djerrë. “Fillojmë të gërmojmë këtu!” tha tjetri. “Ndoshta gjejmë ndonjë gjë!”

Gërmuan deri në perëndim. Të larë në djersë, duke marrë frymë me zor, poshtë hijes së mureve të rrënuar, shuanin etjen me shtëmbën e ujit të ngrohur nga vapa. Vazhduan të gërmonin me zell. As vetë nuk e dinin ç’kërkonin. Uji i kroit kishte një shije prej fijesh bari, dhe përhapte në qiellzë ndjesinë e dheut. Por ata ishin aq të etur, sa nuk mendonin për cilësinë e ujit.

Dielli perëndoi dhe ato akoma po kërkonin. Sa më shumë gërmonin, aq më shumë i rritej shpresa, i shtoej besimi se do të gjenin diçka.

Arkeologët kishin folur për një thesar. Një pasuri që galioni spanjoll e kishte pasur në bord. Thesar që spanjollët pasi galioni ishte dëmtuar, e kishin zbritur dhe fshehurazi e kishin groposur diku.

“Këtë histori e kam dëgjuar shumë here!” shtonte Bardhi duke zgurdulluar sytë.

Nga lodhja e punës merrnin frymë me zor. Kishin gërmuar dhe larguar dheun për orë të tëra, duke hapur gropa në disa pika të ndryshme ku dikur ngrihej kisha. Filloi të errej. Një hënë e plotë, si një dhuratë ëndërre doli nga përtej kodrës dhe ndriçoi vëndin. “Do të bëhen merak në shtëpi!” tha djali nga qyteti.

“Mos e vrit mëndjen. Ti je me mua!” e qetësoi Bardhi. Gërmuan akoma për një orë. E ndjenin se do te gjenin diçka, në atë djerrinë shekullore, ku jeta kishte heshtur shekuj më parë. Kohë më vonë, siç tregonin më të moshuarit, spanjollët e zbritur nga galioni i dëmtuar, ishte shkrirë me vendasit, martuar me vajzat e zonës, derisa e kishin humbur sojin e tyre. Flitej për qindra vite më parë.

Hëna i jepte vendit një shembëllim ëndërre. Një shushurimë gjetshesh, si një frymë e mistershme natyre,

ndjehej nëpër ajrin zhurmues. Gjithçka shëmbëllente e shpirtëzuar. Deri edhe kukuvajkat poshtë degëve, vështronin të habitura me sytë e mëdhenj, fosforeshentë.

Më në fund kazma e Bardhit hasi me një objekt metalik. “Eshtë gur!” tha djali, kur shkëndijat bënë xixa gjithkund. “Jo. Nuk është gur!”

U afruan të mahnitur. E terhoqën jashtë. Ishte një medaljon rrethor plot llanga balte. U munduan ta pastronin duke hequr dheun, por akoma nuk po e shihnin si duhej. “Vrapojmë tek përroi!” tha Bardhi. Atje, falë ujrave, nën dritën e hënës, filluan ta pastronin. Gaforre me membrana fosforeshente ngjyrë murrëti, ndrinin nën rrjedhën e ujit argjend. Të përgjumura, rrinin si të trulllosura.

Argjili blu e shtonte shijen e ëndërrës përreth. Sa më shumë e pastronin aq më shumë medaljoni merrte formën e vet origjinale. Ishte relievi i një vajze-hyjni e cila buzëqeshte. Kishte balluke të skalitura këndshëm, rënë bukur mbi ballë, sy tejshkuar nga një vështrim i ëmbël, vetulla të prera, faqe buçkane, dhe format e përkryera të buzëve, të holla.

Dukej si një hyjneshë romake, me format e ëmbla dhe të punuara me një kujdes prej artisti të sprovuar. Buzeqeshja, kishte diçka prej dielli. Medaljoni nuk e kalonte rrethoren e dy pëllëmbëve të bashkuara, të hapura. Sa më shumë e lanin, aq më shumë dilte në pah ngjyra e arit, i cili nisi të ndrij si i shpirtëzuar. Mbetën pa frymë. Lexohej diçka. “*Ars Amatoria!*” ç donte të thonte? Kush ishte kuptimi? Në fund, i praruar nga uji i kulluar, medaljoni filloi të ndriste fort, sikur një zjarr i brëndëshëm të ishte zgjuar në zemër të vetë metalit.

Kur e kthyen nga krahu tjetër lexuan me nxitim gërmat: “*Gloriae Genii*” ç'donte te thonte? Të mrekulluar, djemtë të cilët po ndriçoheshin nga shkëlqimi prej thëngjijsh të ndezur në errësirë, u habitën krejt. Figura vajzërore, buzëqeshte me një hijeshi të pavërtetë. “Uau!” u dëgjuan zërat e tyre. Ndaj gjithkund, në ajrin e magjepsur, gjethet, degët, era e natës, zhurma e mistershme e ajrit u duk sikur pëshpëriti gërma, fjalë, shprehje. Zërat vinin nga gjithkund përreth. Tinguj magjeps, sikur të ishin zëra sirenash. “*Amoor!*” u dëgjua dhe ajri e pëshpëriste nga të gjitha skajet. Ai rrinte akoma me medaljonin në dorë krejt i shushatur, ngrirë si në një magjepsje ëndërre. Ndërkohë që ajri, me miljona pëshpërima vajzërore, thonte atë fjalën e huaj. Fjalë e cila ishte akoma e pakuptimtë. Djali nga qyteti, lëvizi me fytyrën e përflakur nga rrezatimi i medaljonit dhe ndjeu se dikush po i prekte supin. Ktheu kokën si në ëndërr, por nuk kishte njeri edhe pse supi i tij po prekej gjithnjë e më me insistim.

Ishte forca e një dore njeriu. I habitur shikonte me dyshim, ndërkoh që mbante akoma medaljonin në duar dhe gjithçka, ajri, gjethet, yjet, era, vazhdonin të pëshpërisnin atë fjalë aq të mrekullueshme. Zëra hyjnishë të padukshëm, tinguj vajzash me zëra aq të ëmbël. Helm dhe mjaltn djellëse. “Kush po më prek? Kush po ma tund supin?” mendonte, dhe tani, gjethet e panumërta ngjanin me flatra shumëngjyrëshe fluturash gjithmonë në lëvizje. Flatra te cilat ndrinin gjithnjë e më shumë. Botë përrallash?!

Kur u zgjua pikasi babain që po e prekte nga shpatulla. Ishte përgjumur në minderin e shtëpisë ne fshat. Burrat kishin dalë nga dhoma. Ai hapi sytë dhe pa babain e tij si në ëndërr. “Eja, jepi dorën se do të ikin!” Djali nga qyteti ishte përgjumësh, me thëngjijtë e ndezur të ëndërrës akoma ndër sy. Pa me habi fytyrën e dashur të babait të tij, nga ku rrezatonte ajo dashuria e pafund.

“Unë ika me Bardhin...!” Desh thoshte, por heshti. Ishte akoma si mes dy botëve, ku realja shembellen akoma dhe me onirike.

“Jepi doren. Ai ka dëshire të të përshendesi”. E pa me dyshim. Nga doli gjithë kjo dashuri?!Nuk kish qenë po ai që, pa dashur por edhe pa e evituar, i kishte futur frymën e largimit?

“Pse po ma kërkon!?”

“Eshtë turp. Bëje!”

“Ç neh? Harrove ç ke thenë?!” desh i tha.

Nuk kishte fytyrë më të ëmbël se ajo e babait të tij. Me atë zërin e ngrohtë, plot njerzillëk, me atë dashurinë pa fund që dinte ta trasmetonte deri dhe me mollëzat e gishtërinjve. Pa sytë e tij të blertë, vrrjagat e rrudhave vertikale, hundën me samar, dhe lëkurën e tij si lapër breshke me rrudhat që i vareshin mbi kafkë. Nuk kishte njohur kurrë një njeri tjetër që të shprehte aq shumë dashuri nga poret e lëkurës me prezencën e tij. Kur e prekte, mollëzat e gishtërinjve çlironin një energji të paparë njerezore, sikur të ishin duar hyjnore.

“Eja t’i japësh dorën!”

“Çfarë dore ti jap? E kam të vështirë!”.

“Ti bë si të them unë!” Pastaj shtoi me zë të ulët.

“Ti s ke fare lidhje!”

“Gjërat kanë ndryshuar pra?!”

“Gjërat janë si janë. Kur të rritesh do t’i kuptosh! Tani bëj si të them!”

„Jo nuk dua. E kam të rëndë!”

„Hajde. Jemi të gjithë tanët këtu! Një gjak. Ti nuk ke lidhje fare me ç ka ndodhur!”

„Nuk dua!”

„Mos ngurro. Ju fëmijët s keni lidhje fare me problemet e të mëdhenjve!”

„E kam të vështirë!” shtoi.

Bëj si të them!” tha ai disi nervoz.

Akoma i përgjumur mundohej ta largonte prushin e florinj të ëndërrës. Një ëndërr, ku i vetmi thesar kish qenë ajo pëshpërimë e pakuptimtë.

Ai e pa prap me përkëdheli. Një dallgë dhemshurie e përshkoi gjithkund dhe e ledhatoi prap tek faqet. “Je ende i vogël të merresh me gjerat e më të mëdhenjve!”

“Atëherë mbaroi mëria?!” Tha ai dhe u hodh vrik në këmbë, i lumturuar nga lajmi. Një gëzim fëmijror e pushtoj krejt, siç mund të pushtojë veç zemrën e një fëmije kurjoz. I ati, nuk dinte ç’përgjigje ti jepte. Shihte përtej dritares dhe shtrëngonte buzët me mosbesim dhe me një hidhërim të përmbytur. “Po mbaroi!” gënjeu në çast, dhe u bë serjoz duke parë përtej dritares.



Ne jetonim në një fshat të thellë, ku dimri mbante i gjatë dhe vera e freskët.

Deri në moshën shtatë vjeç të rriturit nuk na urdhëronin për ndonjë punë të rëndësishme. Mungesa e lodrave na detyronte që gjithë ditën të shpiknim lojëra të ndyshme. Për disa kohë mbaj mend që gëzimi më i madh për mua qe, një qen i vogël, bardhosh. Përlotesha kur dëgjoja të mëdhenjtë, që sa të rritej dhe pak do i bënin një kolibe të vogël dhe do e mbyllnin për disa kohë që të bëhej i egër. Disa herë vëllai më qortonte që të mos luaja me të – *do e bësh batall*, më thoshte.

As sot e kësaj ditë nuk e kam mësuar si duhet kuptimin e fjalës *batall*. Duhet të jetë ndonjë turqizëm. Gjithsesi kurrë nuk do ta harroj ditën kur ai doli në krye të shkallëve dhe kur pa që qeni i qe zgjidhur hekurave dhe frymonte turinjtë në duart e mia, i gjuajti me nallane aq fort, sa qeni kuisi për një copë herë. Bashkë me të qava dhe unë.

Kisha dy rrugë: ose të shkoja fshehurazi, ta zgjidhja, ta nxirrja nga dera e pasme krejt të lirë, ose ta lija në terrin e kasolles, duke kuisur gjithë ditën. Të paktën do t’u shpëtonte të rrahurave dhe nuk do ndahesha prej tij. Vendosa ta lë aty në kasolle. Nuk mund ta jetoja pa të .

Gjithë ditën ulesha pranë kasolles dhe flisja me të , pa u rënë në sy të mëdhenjëve. Sa më dëgjonte zërin hungërinte me një timbër tjetër, sikur kërkonte ndihmë. Disa herë mora guximin dhe i thashë tim eti që duhej ta nxirrnim jashtë – *Ska gjë, aty bëhet më i egër* , ishte përgjigjia e tij indiferente.

Pas disa muajsh kur kuisja e tij u rrallua disi dhe kur vajtjes time pranë kasolles nuk i përgjigjej më, të mëdhenjtë vendosën ta nxirrnin prej saj. Ishte rritur.

I vunë një qafore prej disa dhëmbëzash prej hekuri dhe e lidhën në mes të oborrit. Kjo më ngazëlleu. Të paktën do e shihja, por pas pak xhahxhi im, një burrë me llërë të forta, pa pikën e dhimbjes ia preu veshët. Kuisjet e tij çanë qiellin dhe unë tkurra kokën duke qarë mes pëllëmbëve. Pasi ulërimet e tij pushuan gjeta rastin kur të rriturit i ishin përveshur një qengji të pjekur dhe iu ula pranë. Ai turfulloi në zinxhirë, duke nxjerrë një zë të trashë dhe duke lehur si të isha për të një e huaj. Për pak desh më kafshoi dorën e majtë.

Të nesërmën kur të rriturit morën drejtimet e tyre, iu afrova me vendosmëri kasolles së tij. Ai flinte në anën tjetër të saj, vetëm kunji i hekurit ishte nga ana e përparme. E zgjidha, por ishte e çuditshme, ai nuk lëvizi fare, edhe pse bëri disa hapa deri tek pjergulla në anën e majtë të kasolles dhe që padysim e kishte kuptuar që nuk ishte më i lidhur. Bëri edhe një shëtitje deri në cepin e majtë të avllisë, urinoi dhe u kthye duke u ulur, mu pranë kunjit të hekurit. Unë e veshtroja nga trangu i manit, disa metra larg. E kisha frikë.

Në darkë kur shihja të rriturit që i qeshnin një filmi, që mua nuk më bënte aspak për te qeshur dhe kur im atë kërkoi nëse kishte tepruar pak tru nga koka e qengjit, unë i krijova përceptimin e parë, mbase naiv idesë , se pse të rriturit i kanë frikë burgjet.

Pas disa ditësh i vetmi polic i fshatit u shfaq në derën e oborrit. –*Eshtë këtu babai juaj* më tha.

Nuk pata fuqi t’i përgjigjesha nga frika. Në atë kohë policët na pështjellonin makth më shumë se lugetrit e përrallave të gjysheve. Di që motra e madhe iu përgjigj që im atë akoma nuk ishte kthyer. Pa i treguar askujt duke qarë bëra rrugën deri tek xhadeja ku shfaqej silueta e tim eti që zakonisht kthehej në ora 4 nga uzina. Duke ngashëryer me të qara iu hodha në qafë dhe i thashë që ka ardhur një polic, do të të kthejë në qen.

Ai qeshi, nxori si gjithmonë dy gurabiet dhe me tha që të mos kisha frikë. Polici ishte ishte katundari ynë, kërkonte disa ditë kalin. Ishte koha që misri duhej të grumbullohe përpara së të nisinin shirat. Gjithsesi atë natë , në cepin e verandës, pas një të lehure të gjatë dhe të egër të qenit, kur ra një qetësi që ndillte gjumë, ktheva sytë nga hëna dhe u luta: “Zoti ynë që je në Qiell shembi burgjet”

Të gjitha këto i kujtova ditën me shi kur por ktheshim nga aksioni i zhveshjes së misrit dhe kur një veturë police kidhte parkuar pranë një kanali. Nga një kalimtar, më saktë nga rojtari i derrava ishte gjetur një grua e vrarë. Shtangëm për disa minuta.

Ulërimat e qenit të fëmijërisë më oshëtinë në tru dhe vetëm atëherë kuptova fatkeqësinë të qenurit qen dhe fataletitin e të qenurit njeri.

Më rrahën tre milicë serbë. Më rrahën në një paradite maji në qytetin L. Më rrahën si anjëherë më parë (natyrisht se nuk ishte hera e parë. Ç'menduat ju!?) mu në lagjen që ndodhej mbrapa tregut.

Më ndaluan të tretë. Më pyetën të tretë. Më goditën të tretë.

Më ndaluan në bisht të rrugës që ndante dhe bashkonte lagjen tonë me tjetrën, me lagjen që shquhej për ndërtesat ngjyrë të verdhë. Asnjëherë më parë nuk më kishin ndaluar në atë pjesë të qytetit. Më shikuan ashpër. Më shikuan vëngër sikur të isha dushmani i tyre më i madh. Ashtu m'u duk mua. Ndoshta ashtu i shikonin të gjithë shqiptarët e qytetit.

Më goditën ashtu siç dinin të godisnin vetëm ata. Më goditën të tretë, edhe pse vetëm njëri do të kishte kryer punë. Zatën, donin ta “nderonin” një profesor universiteti dhe nuk mund të rrinin duarkryq në një ngjarje të tillë. Më goditën të tretë, njëri me duar për ta provuar fortësinë e grushteve të tij, ndërsa dy të tjerët denjuan t'i përdornin edhe këmbët, për të treguar ashpërsinë e shkelmave të tyre.

Ata e përfunduan suksesshëm detyrën e tyre. Më rrahën dhe më lanë vetëm. Vazhduan rrugën e tyre. Ndoshta për ta rrahur edhe ndonjë aktivist a veprimtar tjetër, apo thjesht ndonjë qytetar, që nuk harronte të përgjigjej “korrektësisht” në pyetjet e tyre. Më lanë vetëm në trotuarin e ftohtë, që pos këmbëve të mia nuk do ta shkelte kush në ato çaste. Më gjakosën dhe ikën. Nuk doja gjë tjetër në ata minuta turpërisht të pafatshëm, pos të gjeja diçka që ta fshija gjakun që ma mbulonte fytyrën si një pelerinë e kuqe. E kuqja që për shumëkë është dhe ishte ngjyrë trimërie, për mua ishte ngjyrë dorëzimi, duke mos pasur fatin ta ngrisja flamurin e bardhë të dorëzimit. Ata nuk të linin as të dorëzoheshe. Nuk mund të vendosje kur duhej të ngrihej flamuri i bardhë e kur jo.

Doja ta fshija gjakun. Kisha turp të më shihnin fëmijët ashtu. Zatën, vetëm ata nuk doja të më shihnin ashtu. Kërkoja me zë pak ujë, ndonjë mindil, ndonjë peshqir apo ndonjë faculetë të thjeshtë. Diçka që do të m'i largonte njollat e gjakut. Pika të vogla gjaku e braktisnin trupin tim. Në rrugën e boshatisur të lagjes nuk kërkoja gjë tjetër, larg qoftë të më mbronin. Afrohesha te shtëpitë e njerëzve që i njihja. E thërrisja emrin e tyre. E kërkoja një pikë ujë, sikur ai i kryqëzuari i kahmotshëm, i cili, për dallim prej meje, ai nuk frikësohej dhe në asnjë rast nuk kishte bërë përpjekje të aktronte “korrektin” përballë atyre që e godisnin.

O Agim! O Agimo! A më dëgjon kush? Pak ujë dhe diçka ta fshij fytyrën! Nuk u dëgjua zë njeriu në shtëpinë e kolegut tim të punës. I kishin mbyllur dyer e dritare. Ndoshta nuk ishin aty. Dritaret qenë mbuluar me perde të kafenjta.

O Elez! O Elezo! Më jepni diçka ta fshij gjakun, ju lutem! Nuk u bë i gjallë asnjë njeri edhe në shtëpinë e mikut tim të kamur, që kishte një shitore pikërisht në këtë rrugë, e mbyllur gjithsesi edhe ajo. Njëjtë edhe në dy shtëpi të tjera. Nuk u dëgjua kush. Sikur t'i kishte përpirë toka të gjithë frymorët e lagjes. Pos ndonjë lehje qeni e mjaullime maceje, qeniet e tjera nuk bëzanin.

Tre milicët më pyesnin për gjëra që s'do të më besonit, sado që të jem i singertë me ju. Ndoshta juve ju duket e pabesueshme, por nuk ishte hera e parë që më qortonin pse shëtisja shpengueshëm në këtë kohë krizash e luftrash. E ndiej se nuk mund ta

MË JEPNI DIÇKA TA FSHIJ GJAKUN!

tregim nga

Adil Olluri

merreni me mend. Nuk ju vë faj!

Jugosllavia po merr flakë në të katër anët, e ju profesorët shqiptarë vetëm bëni *sehir* dhe i fryni zjarrit. Turp ju qoftë! Jugosllavia ju shkolloi e ju gjeti punë, kurse ju nuk bëni asgjë për të! - më qortonte dhe më fyente më i gjati prej tyre, që ishte epror i dy të tjerëve. Isha i sigurt se ishte prijësi i tyre, sepse as nuk flisnin e as godisnin të parët. Ata vetëm i pohonin me kokë fjalët e tij dhe i mbanin duart në gjendje gatishmërie për t'i përdorur kur eprori të jepte shenjë. E shikonin në sy dhe ia përcillnin secilën lëvizje të tij. E kisha bindjen se sytë i kishin vetëm për ta shikuar atë dhe të tjerët që u thoshte ai. Gojët i kishin vetëm për t'i përsëritur fjalët e tij. Duart i kishin për ta goditur këdo që ai u thoshte. Ndërsa, këmbët i kishin vetëm për të ecur krah tij dhe për ta ndjekur secilin që ai urdhëronte.

Ndiej keqardhje për atë që është duke ndodhur, por unë nuk mund të bëj asgjë. Unë jam shkencëtar, profesor biologjie. Nuk kam se si ta ndihmoj Jugosllavinë - arsyetohesha duke u shtirur deri në ato caqe, përtej të cilave nuk mund të shkohej.

Përse nuk thua Jugosllavinë tonë? *Jazëk* të qoftë! Mbeta i përhumur e pa përgjigje. Nuk dija se çka të thosha. Thellësisht e ndieja të nevojshme t'ua përplasja për fytyrë. Më vinte t'u thosha: “Jua shkërdhefsa Jugosllavinë me krejt çka keni e nuk keni”, por nuk kisha guxim. Do t'ju gënjeja, po të shkruaja ndryshe.

A është edhe jotja Jugosllavia? Mos të është shndërruar në armike tash së voni?

Mos ju ka bindur të gjithëve ai udhëheqësi juaj me shall, dreqi ta marrtë! - insistonte në përgjigje eprori shtatëlartë.

Po të guxoja, tre ndaluesit e llahtarshëm do t'i pështyja, në vend se t'ua thosha: “Jugosllavia është e të gjithëve! Meqë është e të gjithëve, natyrisht se është edhe imja”. Por, ku ta merrja të shkretin guxim?! Të tjera kohë ishin atëherë. Lehtë është të flasësh sot, të dashur lexues të këtij tregimi. Do t'ju gënjeja po të shkruaja ndryshe. Duhej ta përpiloja dhe ta stisja përgjigjen që atyre do t'u pëlqente. Dhe kjo nuk ishte hera e parë. Dhe kjo ma shkaktonte neverinë më të madhe. Neverinë me veten. Neverinë me frikën time. Ende e ndiej atë neveri ndaj frikës sime të atëhershme. Sot e shaj veten se si isha shndërruar në një qenie të squllët, e cila mendonte vetëm se si ta gjente një fjali të dobishme, që do të më nxirrte nga kthetrat e ndaluesve të përhershëm. Nuk kalonte muaji pa më ndaluar së paku njëherë. Unë i kisha mësuar përmendsh formulat e magjishme për të shpëtuar sa më lehtë, ndërsa reagimet e tyre, apo më mirë të themi sasia e goditjeve ndryshonte nga muaji në muaj, nga ndalesa në ndalesë. Ndryshonte varësisht nga humori i tyre dhe mënyra se si i ndërlihdja fjalët me një sintaksë që kishte synim tërheqjen sa më të shpejtë nga një bisedë rasti, që sot mund t'ju duket e pazakontë.

Ku e ke kostumin, profesor? Na qenke edhe sportist, ë?

Isha i veshur në trenerka dhe patika, vetëm sa për t'i kryer disa blerje në treg

dhe të kthehesha përsëri në banesën time, pa më shkuar mendja se do të mund t'iu asocioja në sportist. Po ta dija se do të më pyesnin kështu, besomëni se nuk do t'i vishja ato të dreqosura.

U veshja kështu thjesht, vetëm sa për të blerë diç në treg - qe arsyetimi im i radhës.

Meqë na qenke edhe sportist, ti duhet ta kesh parë derbin e madh? A je për Zvezdën a për Partizanin? - e dyta pyetje u bë nga polici që rrinte në të majtë të eprorit të tij. Ishin fjalët e vetme të tij. E mbaj mend ta ketë pasur një lyth afër hundës dhe sa herë më shikonte, më dukej se i zmadhohej duke ia kapluar tërë fytyrën, vetëm e vetëm që të më llahtariste edhe më shumë.

Nuk e përcjell fare futbollin dhe nuk di ç'të them - nuk e dija se cilën prej dy skuadrave ta zgjidhja. Për fjalë të nderit, po ta dija se cila është zgjedhja adekuatë, pa një pa dy do t'u thosha se për këtë klub bëja tifozllëk, pa as më të voglën mëdyshje. Ishte e vërtetë se nuk e përcillja fare futbollin. Dhe kjo më bënte fatkeq.

Gënjen! Gënjen pa fije turpi! Edhe i veshur si sportist edhe thua se nuk e përcjell futbollin. Turp të kesh! - ngulte këmbë eprori.

Cili lojtar i kombëtares të pëlqen? - e fundit pyetje u bë nga shkurtaku që rrinte në anën e majtë të udhëheqësit të tij.

Nuk mund t'ju them se më pëlqen ndonjëri, kur nuk e njoh asnjërin.

Si, si?! Nuk të pëlqen asnjëri?!- bënte si i habitur eprori. Duket se këtu rashë në grackën e tyre. Nuk u tregova i kujdesshëm aq sa duhej. Ndoshta edhe u lodha nga pyetjet e njëpasnjëshme. Rrëshqita në kurthin e stisur që më parë. U binda se, megjithatë, nuk e kisha edhe aq të lartë sensin e gjeturisë, siç paramendoja.

Nuk e mendova ashtu. Doja të... - ma ndërpreu fjalën eprori.

Nuk të pëlqen asnjëri se nuk e njeh si kombëtare tënden. Kot u fshehe! Tash të doli gjarpri, shqiptar muti! Edhe ti e urren Serbinë, bre t'i shkërdhefsa të gjallë e të vdekur, bir kurve!- e nxorën që të tretë të gjithë arsenalin e të sharave që posedonin.

Jo, jo... - kotësisht bëja përpjekjen e sërishme që të mbrohesha, dhe papritmas më goditën në fytyrë e fundbark dy milicët vartës, duke mos vonuar as goditja në kokë e shefit të tyre.

Me t'i dëgjuar rënkimet e mia u mbyllën të gjitha shitoret e dyqanet në lagje dhe këmbë njeriu nuk shkelte rrugëve të saj në atë çast. U strukën në banesat e tyre, në hyrje ndërtesash e kthinash të pavërejtshme të sokakëve të lagjes. Kush nuk e nxori kokën të më shihte në sy. Së paku të më thoshte si nuk e mësove së paku një emër futbollisti, o i gJORë.

Më ishte gjakosur gati e tërë fytyra. Goditja e shefit shtatlartë e kishte dhënë efektin. Grushti që iu bë dhuratë hundëve dhe faqes së majtë e kishte bërë të veten. Gjakun që rridhte ngadalë m'i ngjyroste rrobat e pjesës së epërme të trupit.

E kërkoja një mindil, një peshqir apo vetëm edhe një faculetë për ta fshirë gjakun që, nga çasti në çast, po ma pushtonte tërësisht fytyrën, me synim marshimin triumfal në drejtim të qafës dhe gjoksit. Nuk doja as të dilja në treg e as të kthehesha në shtëpi ashtu i gjakosur. Nuk kërkoja shumë. Një mindil apo një faculetë të thjeshtë. Heshtje varri. Askush nuk u bë i gjallë. Askush nuk më dha gjë. Megjithëse, nuk u vë faj. Pothuajse të gjithë frikësoheshin. Të gjithë, në mënyra të ndryshme.



I
E hëna është një këpucë teke;
me tjetrën, ndoshta, po argëtohet qeni i
lidhur te porta.
Dielli del gjithmonë nga një deriçkë
dhe derdhet si krundet nëpër rrugë –
gjithsesi i panevojshëm.
Burrat që zbresin zallit
me trupin drejt e duart të lidhura pas shpine
janë nisur për askund.
Ata ngajnë me thepin e pushkës në vijën e
shënjestrës;
duhet të mbash frymën për t’i fiksuar.
Pështyma e tyre akoma e hidhur nga kafeja
dhe mbi jakat e xhaketave – barriera zbokthi
apo flamuj të bardhë dorëzimi.
Javë të tëra pa rënë një pikë shi. Përroi i
vetëm digjet nga sifilizi.
Një fëmijë i përvidhet së ëmës; nuk do të
shkojë në shkollë.
Është nëntë vjeç dhe mbledh e zbret me
gishtat e nxirë me arra të njoma
vitet që i kanë mbetur deri në rekrutim.
Përtej dhjetës, ai është i hutuar.
Vizaton rreth vetes një rreth të madh në
pluhur,
si një copë lëkurë e shënuar
atje ku do të kryhet një heqje tumori...

II

Si salmonët lënë detin dhe i ngjiten
grykëderdhjes së lumit
kur vjen koha e dyzimit,
– dasmorët bëjnë një hap prapa në histori
ndërsa kthehen të nesërmen, me sytë
përdhe, duke i kërkuar lëkurët
të zonjës së shtëpisë:
“Imja është krejt e bardhë, me manikyr në
thonj!”
“Imja është e butë dhe ka një damkë
djegieje hekuri në parakrah!”
“Imja mban erë sherbel’; pa kanavacë e pa
astar!”
“Imja është e magjepsur; mund ta veshësh
nga të dyja anët!”
“Më jep një çfarë të mundesh, pak rëndësi ka!”

Ja dhe Mustafai, pijaneci...
me kokën e ngjitur në të djathtë të trupit.
Ai është shenjt i së hënës – fajtor për
gjithçka,
ndërsa përthith mallkimet e të tjerëve
si një copë pambuk e lagur me alkool,
përmbi plagë.

III

Para gjumit bota kthehet nën qepallë
si ushtria nën një hark triumfi, e ngopur në
kotësinë e vet.
Në fund të kolonës – plaçka e luftës,
riti i përnatshëm i bashkimit trup me trup,
ajo muzikë rrecka-rrecka
që mjafton sa për të fshehur
motivin për të cilin u zgjuam sot në mëngjes,
aq më tepër atë për të cilin duhet të
zgjohemi nesër.

Llamba shuhet për herë të fundit
dhe gjaku iu rikthye qarkullimit të vogël.

IV

Kur ime gjyshe erdhi nuse këtu,
shtëpia ishte bosh: vetëm armët varur e
një emër të mirë.
Me kaq pak gjëra asaj iu desh të ndërtojë
një qytet,
të gjejë një palë shpatulla për një kokë.
E filloi duke mbjellë një kajsia para shtëpisë.
Më tej një të dytë. Si një *deadline*
apo si dora e vënë para fytyrës
që fryma të kthehej e ngrohtë mbrapsht.
Pastaj prej trupit të saj pikuan fëmijët,
shiu nga tenda prej llamarine.
Ata që ranë në tokë të butë, u harruan;
të tjerët mbi çimento ia dolën mbanë.
E ata që mbijetuan,
sot e kësaj dite janë ngurosur në një
fotografi bardhë e zi,
me kostumet prej stofi dhe shtegun e qartë
të flokëve me brilantinë,
të parehatshëm,
si brenda një jete të marrë hua.



E HËNA NË SHTATË DITË

poezi nga

Luljeta Lleshanaku

V

Lodrat e prishura ishin argëtimi im.
Zebra, karroca kineze e akullores me
kurdisje,
që im atë m’i solli dhuratë për Vit të Ri,
asgjë nuk vlenin,
ishin si torta me kremin e lëpirë fshehtas
në kuzhinë,
derisa diçka metalike u thyhej përbrenda
dhe hidheshin tej të panevojshme...
Atëherë ua hapja barqet, ingranazhet
mikroskopike, bateritë,
pa e ditur se kisha bërë hapin tim të parë
drejt të kuptuarit,
si liri nga funksioni.

Kur për herë të parë pashë një pikturë të
vërtetë,
bëra disa hapa mbrapa, instinktivisht, me
thembra,
po zgjidhja pikën e vdekjes,
nga ku mund të hyja në brendinë e gjërave.

Ndërsa me njerëzit ishte tjetër gjë,
ata i ndërtova vetë. Njerëzit i desha,
qëllimisht jo deri në fund. Asnjëri prej tyre
nuk preku tavanin e kaltër me kokë,
si shtëpitë e lëna në mes, me një plastmasë
në vend të çatisë
kur sapo ka filluar vjeshta e lagësht e të
kuptuarit.

VI

Ja ku është ai burri i ndershëm, burri i
drejtë,
me fytyrën e shkundur mirë nga thërrimet
si një shtrojë pikniku.
Soji i tij nuk mbetet kurrë pa punë:
“Kam një vrimë të gatshme në gjoks,
a ka kush ndonjë gozhdë për të ngulur?”

Të njëjtën gjë ka bërë edhe stërgjyshi,
edhe gjyshi, babai...
Ndoshta të njëjtin zanat do të ketë edhe i
biri, për analogji.
Ai që pikërisht tani i ka ngulur sytë si
diçkaje të pavlerë
(hapu dhe futu!)
herët e vonë...

“Sa larg do të shkoj?” - e kishte pyetur një
herë i biri.
“Aq sa të mos e humbasësh veten nga

sytë!”
Mund të kishte qenë një ëndërr, sepse
pema e tij gjenealogjike
u dogj nga rrufeja
dhe një erë e mirë prej *uluweah* u përhap
nëpër katund.

VII

Kundërmim rrënjësh. Shirat kthehen në
zgjoin e vet
si bletët, të gjitha njëherësh, pa hierarki.
Është traditë.
E për të dalluar shirat e freskëta nga ato
melankolike,
të mbarsura mbi kodrina gjatë verës,
unë mbyll njërin vesh, njëlloj siç
perceptohet identiteti.

Im ungj më kërkon një *fazzoletto* për të
fshirë syzet;
e quan kështu që prej kohës kur ishte për
kurim nga
bronkopneumonia në Firenze,
kohë për të cilën flet
si për muajin e mjaltit.
Ai tashmë ka dëftesën e notave të mia
semestrale në dorë;
gjaku i pulson në tëmtha – çështje për jetë
e vdekje.
Varet prej tij
të përcaktojë
në jam një tullë për shtëpi
apo një gur për një kullë bari.
Dhe ajo dorë që pritet të më godasë
është manual përdorimi që lexohet vetëm
një herë,
por ulluqet në pëllëmbë, vijat e tij të fatit,
janë të vetmet që nuk do të më lënë
shenjë.

Djali e marrtë! Më sill një *fazzoletto*!

VIII

Nëse ke një lëkurë të zezë,
buzëqeshja jote duhet të jetë e përkryer.
Ajo s’mund të jetë gjysmake dhe as me
dhëmbët copë-copë.
F. e di këtë. Ajo mban zi për të birin,
hap dritaren herët,
ndez sobën me vajguri dhe me një copë
telegram të spërdredhur,
pastron oborrin, ushqen pulat, gatuan sa

për dhjetë veta,
fikson karrigen e saj me krahë sfinksi
përballë derës
dhe si çdo ditë kapet si një skifter, fort, me
kthetra
pas rregullit,
formës,
duke joshur si kuadratet në fushat me
grurë
atë pjesë të saj që fluturon pamëshirshëm
në vijë të drejtë
dhe që nuk e prek tokën.

Ajo i merr përshëndetjet me sy.
Rruga i hapet nga të dy krahët,
si e diela midis ditëve të javës, e caktuar
për mirënjohje
dhe meditim.

IX

Në mes je i shpëtuar - thoshin latinët.
Mbulesa e qëndisur në mesin e tryezës.
Tryeza në mesin e qilimit.
Qilimi në mesin e dhomës.
Dhoma në mesin e shtëpisë.
Shtëpia në mesin e bllokut.
Blloku në mesin e qytetit.
Qyteti në mesin e hartës.
Harta në mesin e dërrasës së zezë.
Dhe dërrasa e zezë
në mesin e hiçit.

Lola është një engjëll. Balli i saj nuk është
rritur që kur ishte tetë vjeçe,
për të ruajtur të njëjtën qendër graviteti.
Dhe ajo pëlqen skajet, qoshet,
pavarësisht se veten e gjen gjithmonë në
mes të një autobusi
kur njerëzit turren drejt hyrjes dhe daljes.

Fqinjët e mi janë njerëz të pashkollë,
nuk kanë dëgjuar asgjë për estetikën
dhe zor se kanë lexuar gjë mbi boshtin,
simetrinë dhe të vërtetën absolute.
Por ata lëshohen instinktivisht drejt mesit,
ashtu si koka e burrit lëshohet krejtësisht
në prehrin e gruas,
që me një palë gërshërë, pabesisht, deri
nesër
do ta bëjë atë më të prekshëm se kurrë.

X

Përgatitjet për dimër nuk janë një zakon,
por shqisë. Flakim nga vetja makthet tona
të tepërta,
si objektet nga një anije e ngecur në
cekëtinë.

*Taedium vitae*¹ është ora lokale që nuk bën
më punë,
përderisa vetëm një erë fasulesh të ziera
na ndan nga fqinjët.
Nga paraardhësit – një ëndërr sipër stufës.

Mes meje dhe fuqive të mia nuk ka asnjë
ndërmjetës.
Era predikon rreth e rrotull me zë hundor
prej profeti të remë.

Vitet përbrenda rrokullisen me
kollotumba pjerrësirës së ngrirë,
duke fshehur instinktivisht kokën midis
gjunjëve.

Kufijtë rrudhen. Edhe pse më abstrakt se
kurrë,
trupi është atdheu im pa himn,
me të cilin prekem në kllapi, në kufijtë e
ekzistencës
si buzët e nënës mbi ballin e fëmijës me
temperaturë...

kur është fjala
për mbijetesë.

¹ *taedum vitae* – lat. *mbingopje nga jeta*.



KËRXXHALIU

tregim nga Aleksandër Pushkin

Përktheu nga rusishtja dhe pajisi me shënime: Stela Koçi

Kërkhaliu ishte një komit me origjinë bullgare. Kërkhali në gjuhën turke do të thotë trim dhe i guximshëm. Emrin e tij i vërtet nuk e di sesi e kishte. Kërkhaliu me grabitjet dhe plaçkitjet e tij kish ngjallur frikë e tmerr në gjithë Moldavinë. Që t’ju krijoj një farë ideje për të, do t’ju tregoj një nga trimëritë të tij. Një natë, ai dhe arnauti Mihallaq sulmuan të dy sëbashku një fshat bullgar. I vunë zjarrin nga të dyja anët, dhe filluan të hidhen sa nga njëra shtëpi tek tjetra. Kërkhaliu vriste e priste mbi fshatarët, kurse Mihallaqi mblidhte prenë dhe plaçkat . Të dy ulërisnin për të tromaksur njerëzinë: Kërkhali! Kërkhali! Të gjithë banorët e fshatit morën arratinë nga tmerri.

Kur Aleksander Ipsilanti shpalli luftën dhe filloi të mblidhte ushtrinë, Kërkhaliu solli disa nga shokët e tij të vjetër për t’iu bashkuar ushtrisë së Ipsilantit. Ata s’para e kuptonin qëllimin e vërtet të revoltës, por lufta ishte një mundësi pasurimi në kurriz të turqve, ose ndoshta dhe moldavëve, dhe kjo ishte një arsye e mjaftueshme për ta.

Aleksandër Ipsilanti për vete ishte trim, por ai nuk zotëronte aftësitë të nevojshme për rolin që e kish marr me kaq vrull dhe kaq mendjelehtësi përsipër. Ai nuk dinte si ta mbante në fre njerëzit që duhej t’i drejtonte. Ata nuk kishin as respekt as besim tek personaliteti i tij. Pas betejës fatkeqe, ku vdiq lulja e rinisë greke, Jordaqlimbiloti e këshilloi të largohej, dhe ai vetë mori komandën. Ipsilanti u largua drejt kufinjëve të Austrisë, dhe nga andej dërgonte mallkime njerëzve, që i quante tradhtarë, frikakakë dhe horra të poshtër. Mirëpo ata djem që ai i konsideronte si horra dhe frikakakë, në fakt, në shumicën e tyre, kishin vdekur brënda mureve të manastirit Seku ose në brigjet e Prutit¹, duke u mbrojtur nga armiku që ishte dhjetë herë më i fuqishëm se ta.

Kërkhaliu merrte pjesë në ushtrinë e

Gjergj Kantakuzinos², për të cilin mund të thuhej se kishte një prerje si Ipsilanti. Në prag të luftës afër Skulenit, Kantakuzinot i kërkoi autoriteteve ruse lejen që të futej në territoret tona. Regjimenti luftarak mbeti pa udhëheqës; por Kërkhaliu, Safianos, Koçandoni dhe të tjerët nuk kishin nevojë për udhëheqës.

Beteja afër Skulenit, siç duket, nuk u përshkrua nga asnjë me gjithë të vërtetën e saj ngjethëse. Imagjinoni 700 burra-arnautë, shqiptarë, grekë, bullgarë dhe fundërrina të çdo lloji, që s’kishin idenë më të vogël për artin ushtarak, duke u prapsur nën vështirimin e pesëmbëdhjetë mijë kalorësve turq.

Ky repart u mbështet pas bregut të Prutit dhe nxorri përballë tij dy topa të vegjël, të gjetur në Jashi në oborrin e Governororit me të cilat, ndodhte që qëllonin gjatë drekave kur kishte festa. Turqit do të ishin të lumtur të përdornin shrapnelat e tyre, por nuk guxonin pa lejen e autoriteteve ruse: sepse fishekët, me domosdo do të fluturonin deri tek bregu ynë. Komandanti i repartit tonë (tashmë i vdekur), kish dyzet vjet që kish shërbyer në ushtri dhe kurrën e kurrës s’kish dëgjuar vërshtëllimat e plumbave nëpër veshë, por ja që Perëndia i dha mundësinë t’i dëgjonte. Disa nga ta, vërshtëlluan pranë veshëve të tij. Komandanti plak u zemërua shumë, dhe i foli ashpër majorit të regjimentit të këmbësorisë të Okhotskut, që ndodhej në rreshtat tanë. Majori, duke mos ditur së çfarë të bënte, vrapoi tek lumi, përtej të cilit dukeshin kokat e kryengritësve, dhë i kërcenoi me gisht. Kryengritësit, duke parë këtë gjest, u kthyen dhe u lëshuan galop përpara dhe mbas tyre u lëshua i gjithë tabori turk. Majori, që kërcënoi me gisht, quhej Khorchevski. Nuk e di çfarë u bë më vonë me të.

Ditën tjetër, megjithatë, turqit i sulmuan Etiristët. Duke mos guxuar të përdornin as plumba, as gjyle topi, ata vendosën, në kundërshtim me zakonet e tyre, të sulmojnë me armë të ftohta. Beteja qe e ashpër. Po

priteshin e therreshin me jataganë. Turqit kishin mbërthyer heshtat dhe ushtat, të cilat nuk ishin përdorur nga ta deri më tani; këto ushta ishin ruse: Nekrasovistët³ po mbaheshin në radhët e tyre. Heteristët, me lejen e Perandorit tonë, mundën të kalonin Prutin, dhe të fshiheshin në garnizonin tonë. Ata filluan të hidheshin përtej bregut. Koçandoni dhe Sofjanosi qëndruan të fundit në bregun e lumit që u përkiste turqve. Kërkhaliu, i cili qe plagosur një mbrëmje më parë, qëndronte i shtrirë në kazermën tonë. Sofjanosi u vra. Koçandoni, një burrë shumë i fortë, ishte plagosur me heshtë në bark. Me një dorë ai kish ngritur shpatën, me tjetrën kish kapur heshtën, e kish ngulur më thellë brenda vetes, në mënyrë që të mundej të godiste me shpatë armikun e tij, dhe sëbashku me të, kish rrënë për tokë.

Çdo gjë mbaroi përnjëherësh. Turqit mbetën fitimtarë në fushë të betejës. Moldavia u spastrua nga bandat kryengritëse. Rreth gjashtëqind arnautë u shpërndanë nëpër gjithë Basarabinë; pavarësisht se nuk dinin sesi të mbijetonin, ata i ishin mirënjohës Rusisë për mbrojtjen e dhënë duke i lejuar të kalojnë në bregun tonë. Ata bënë një jetë të plogët, por jo të shthurur. Mund t’i shikojë gjithmonë nëper kafenetë alla turke të Basarabisë, duke tymosur me nargjile të gjata e rufitur gllënkë pas gllënke llumin e kafes në filxhane të vegjël. Mëngoret e tyre plot qëndisma dhe opingat majëmprehta me xhufkat e kuqe sipër kishin filluar të griseshin, por festet e tyre me xhufkë vazhdonin ti mbanin ende në kokë, ndërsa pistoletat dhe jataganët u dilnin sipër silaheve të gjera. Asnjëri nuk ankohej për ta dhe as që nuk mund t’u vinte mendja, që këta burra të urtë e paqësorë ishin të famshmit kryengritës të Moldavisë, miqtë e Kërkhaliut të frikshëm dhe akoma më tepër që ai vetë ndodhej mes tyre.

Pashai osman që qeveriste në Jash, e mori vesh që Kërkhaliu fshihej mes kryengritësve, dhe në bazë të dispozitave të traktateve të nënshkruara, iu kërkoi autoriteteve ruse që t’ua dorëzonin.

Policia filloi kërkimin. Ata e zbuluan që Kërkhaliu, në të vërtetë ndodhej në Kishinev. E gjetën në shtëpinë e një murgu të arratisur, në mbrëmje, kur po hante darkën, duke qëndruar në errësi me shtatë shokët e vet.

Kërkhaliun e vunë nën arrest. Ai nuk u përpoq ta fshinte të se kush ishte, dhe e pohoi, që ai ishte dora vet, Kërkhaliu.

«Por, – shtoi ai, – qëkur, kam kaluar Prutin, nuk kam prekur asnjë qime floku të pronës të asnjë njeriu dhe nuk kam rënë në qafë as evgjinit më të përhumur këtu. Turqit, Moldavët, dhe Vllahët, më njohin për hajdut, por për rusët në jam mysafir në tokën e tyre. Kur Safianos, pasi i kish harxhuar të gjithë gjylet e topit, erdhi në gazermën tonë, dhe mblodhi nga të plagosurit për të shtënë e fundit të gjithë pullat, gozhdët, zinxhirët e orëve dhe dorezat e jataganëve, unë i dhashë njëzet beshlik⁴, dhe ngela pa asnjë të hollë në xhep. Zoti, lart në qiell e di që unë, Kërkhaliu deri më tani, kam jetuar me lëmoshë! Kur jam katandisur në këtë pikë të hallit, pse duhet të më dorëzoni tek armiqët e mi?» Pas këtyre fjalëve, Kërkhaliu heshti dhe në qetësi po priste vendimin që do të caktonte fatin e tij.

Nuk është se priti shumë, pasi autoritetet gjyqësore, të bindur për korrektesinë e kërkesës osmane e që sigurisht nuk ishin të detyruar t’i shikonin hajdutët

³ Forcat kozake, që quheshin kështu sipas të parit të tyre Ignant Nekrasov të lokalizuar rreth Kubanit në Rusi. Pas konflikteve me autoritetet ruse një pjesë e madhe e tyre rreth 5000 u vendosën në deltën e Danubit të kontrolluar nga osmanët. Në konfliktin dhe revoltën e udhëhequr nga Ipsilanti, kazakët iu shërbyen osmanëve.

⁴ Monedhë otomane. Në fillim të shekullit bronxi që përdorej për të prodhuar gjylet për topa importoheshin nga Anglia. Për këtë arsye shumë herë feudalët vendas mblidhin bronz nga banorët, për t’i shkrirë e bërë gjyle topi.

me sy romantik, urdhëruan ta dërgonin Kërkhaliun te Pashai osman, në Jash.

Një burrë i përzemërt dhe i urtë, që në atë kohë ishte një zyrtar akoma ri e i panjohur, por tashmë ka në një pozicion shumë të rëndësishëm në administratën shtetërore, më rrëfeu më vonë gjithë gjallëri dorëzimin e Kërkhaliut te autoritetet osmane, matanë lumit.

Te dyert e burgut qëndronte një karruca... (Ndoshta ju nuk e dini se çfarë është karruca. Kjo është një karro e ulët dhe e thurrur, në të cilën deri pak kohë më parë mbreheshin zakonisht gjashtë ose tetë kuaj gërdalla. Një burrë moldav me mustaqe dhe me kapuç të endur me lesh dashi në kokë, qëndronte sipër njëres prej tyre dhe thërriste pa pushim duke i fshikëlluar me kamzhik kuajt gërdalla që nga frika e goditjet vraponin trokthi. Nëse njëri nga ta dilte nga rruga, karrocieri e zgjidhte nga karroca e gjithë të sharra e të shfryra e linte në rrugë, pa u shqetësuar fare për fatin e tij. Në të kthyer ai ishte i bindur ta gjente në të njëjtin vend, duke kullotur në stepën e gjelbër. Jo rrallë ndodhte që një udhëtar që nisej nga një stacion me tetë kuaj, arrinte në tjetrin vetëm me një palë kuaj të tjerë. Kështu ishte gjendja e udhëtimeve përafërsisht pesëmbëdhjetë vite më parë. Aktualisht, në Besarabinë e rusifikuar kanë adoptuar takëmet dhe telegat⁵ ruse).

Një karrucë e tillë po qëndronte te portat e burgut në vitin 1821, në një nga ditët e fundit të muajit shtator. Rreth saj mund të shihje hebrenjtë, me mëngët e lëshuara dhe me pantoflat e veshura në këmbë, arnautët me veshjet e tyre piktoreske të grisura, gratë moldave, elegante me sy të zeza dhe me fëmijet e tyre në duar. Burrat rrinin në heshtje, ndërsa gratë, me ankth po prisnin diçka.

Portat u hapën, dhe disa oficerë të policisë dolën jashtë; pas tyre vinin dy ushtarë që tërhiqnin Kërkhaliun të lidhur me pranga.

Kërkhaliu dukej të kishte nja tridhjetë vjet. Tiparet e fytyrës së zeshkët ishin të rregullta dhe të ashpra. Ishte i gjatë, me shpatulla të gjera, dhe në përgjegjësi shprehte një fuqi fizike të pazakontë. Një çallmë e larmë i mbulonte kokën, një rrip i gjerë i shtrëngonte mesin e hollë; një dollma prej copë blu të trashë, këmisha me rrudhat e gjera, që i binin lart gjunjëve, dhe këpucet e bukura përbënin pjesën e mbetur të kostumit të tij. Nga pamja dukej krenar dhe i qetë.

Një nga funksionarët, plak me fytyrë të kuqe, me uniformë të vjetëruar, në të cilën tre kopsa vareshin në erë, me syzet prej kallaji që i rrinin mbi një gungë të kuqe, që mesa duket duhet të ishte hunda, shpalosi letërën, dhe duke folur si me hundë, filloi të lexonte në gjuhën moldave. Herë pas here, i hidhte sytë në menyër arrogante tek Kërkhaliu që ishte i lidhur, dhe ndaj cilit, siç duket referohej letra. Kërkhaliu po e dëgjonte me vëmendje. Funksionari mbaroi leximin, palosi letërën, dhe bërtiti egërsisht, duke urdhëruar turmën që të prapset – dhe që karruca të afrohet. Atëherë Kërkhaliu iu drejtua, dhe i tha disa fjalë në gjuhën moldave; zëri i tij po dridhej, fytyra iu ndryshua; ai filloi të qante dhe ra tek këmbet e funksionarit të policisë, duke bërë zhurmë me zinxhoret e tij. Funksionari i policisë, u trëmb, dhe u hodh mënjandë; ushtarët donin ta ngrinin Kërkhaliun, por ai u ngrit vetë, mblodhi prangat e tij, u fut në karruca dhe bërtiti: Nisu! Xhandari u ul afër tij, karrocieri moldav fshikëlliu kamzhikun, dhe karroca u rrukullis tatëpjetë me potere.

– Çfarë ju tha Kërkhaliu? – pyeti zyrtari i ri oficerin e policisë.

– Ai më kërkoi, – tha, duke buzëqeshur, oficeri i policisë, – që unë të kujdesem për gruan dhe fëmijën e tij, që jetojnë afër Kilia-së⁶ në një fshat bullgar – ai ka frikë, se mos

⁵ Karrocet e postës

⁶ Një fshat bullgar i lokalizuar në deltën e Danubit.

¹ Lumë i madh që përshkon mes për mes territoret rumune. Ka shërbeyer si një kufi etnografik e kulturor midis krahinave rumune të Vllahisë dhe Moldavisë.

² Udhëheqës i revolucionit grek, princ i principatave rumune nga lagjia Fanar i Konstandinopojës.

e pësojnë për shkakun e tij. Turma është e marrë, kurrë nuk di se ç'bën.

Tregimi i funksionarit të rri më preku shumë. Më vinte keq për Kërxfhaliun. Për shumë kohë nuk dëgjova asgjë për fatin e tij. Disa vite më vonë, takova zyrtarin e ri. Filluam të shkëmbejmë dy llafe e të flasim për të kaluarën.

– Por shoku juaj Kërxfhaliu? – pyeta unë, – mos dini gjë çfarë ndodhi me të?
– Të jem i singhtë, e di, – u përgjigj ai – dhe më rrëfeu si më poshtë:

Kërxfhaliu, pasi e sollën në Jash, e paraqitën tek Pashai, i cili e dënoi me ngulje në hu. Ekzekutimin e anuluan për shkak të një feste dhe përkohësisht e burgosën.

Të burgosurin e ruanin shtatë turq (njerëz të thjeshtë dhe në shpirtin e tyre njëlloj hajdutë si Kërxfhaliu vetë); ata e respektonin, dhe, siç janë njerëzit e Orientit, ia dëgjonin gjithë kërshëri, historitë e tij të çuditshme.

Midis rojeve dhe të burgosurit u krijua një lidhje e fortë. Një herë Kërxfhaliu u tha: Vëllezër! Ora ime është e afërt. Asnjëri nuk mund ta shmangë fatin e tij. Së shpejti unë do ndahem nga ju. Do doja t'ju lë diçka si kujtim.

Turqit dëgjonin gjithë sy e veshë.
– Vëllezër, – vazhdoi Kërxfhaliu, – tre vjet më parë, kur plaçkitja bashkë me të ndjerin Mihallaqi, kemi fshehur në një gropë, në stepë jo larg Jashit⁷, një qyp me florinj. Siç duken bathët, as unë, as ai nuk do ta përdorim kurrë këtë thesar. Ç'ti bësh, kështu paska qenë e thënë: merreni ju dhe ndaheni mes jush barabar.

Turqve për pak u iku mendja. Puna tani ishte sesi ta gjenin vendin e bekuar? Vranë mendjen dhe përfundimisht vendosën që vet Kërxfhaliu t'i çonte te vendi.

U ngrys. Turqit i liruan prangat nga këmbët e të burgosurit, ia lidhën duart me litar, dhe bashkë me të u nisën nga qyteti drejt stepës.

Kërxfhaliu i udhëhoqi, duke mbajtur një drejtim, nga një kodrinë tek tjetra. Po ecnin e ecnin pa mbarim. Më në fund, Kërxfhaliu ndaloi afër një guri të madh, numëroi njëzet hapa drejt jugut, ndaloi dhe tha: “Këtu”.

Turqit filluan të përgatiten për të gërmuar. Katër nga ata nxorën jataganët e tyre dhe filluan të gërmojnë dheun. Tre nga ta, bënin roje. Kërxfhaliu u ul mbi gur dhe filloi të ndiqte punën e tyre.

– He pra? Akoma? – pyeste ai, – s'arritët të gjeni gjë?

– Jo akoma, – iu përgjigjën turqit, dhe vazhduan të punonin me kaq vrull, sa djersa ju shkonte çurg.

Kërxfhaliu filloi të humbte durimin.
– Ç'njerëz që jeni? – po thoshte ai. – As dheun të gërmoni mirë nuk dini. Unë do ta kisha mbaruar këtë punë për dy minuta! Më zgjidhni duart dhe më jepni një jatagan.

Turqit u menduan pak dhe filluan të këshillohen mes tyre. – Edhe nëse do t'i zgjidhim duart, e do t'i japim jataganin, çfarë do na bëjë? Ai është një, dhe ne jemi shtatë. – Dhe turqit i zgjidhën duart dhe ja dhanë jataganin.

Më në fund Kërxfhaliu ishte i lirë dhe i armatosur. Merre me mend sesi duhet të ndihet ai në atë moment!.. Filloi të gërmonte dheun me shpejtësi, rrojat e ndihmohnin... Papritur ai nguli jataganin në një nga ta dhe, duke e lënë jataganin ngulur në gjoksin e tij, mori nga brezi i tij dy pistoletë.

Gjashtë të tjerët, duke e parë Kërxfhaliun të armatosur dhe me dy pistoletë, ia mbathën me të katra.

Kërxfhaliu tashmë po merret me hajdutëri nëpër rrethinat e Jashit. Pak kohë më parë ai i shkruajti qeveritarit, dhe i kërkoi pesë mijë lei, duke e kërcënuar që, në rast mospranimi, do t'i vinte zjarrin Jashit derisa zjarri të arrinte deri tek vet godinat e qeveritarit. Të pesë mijë leit iu dhanë menjëherë.

E pra, ky, është Kërxfhaliu!

⁷ Kryeqyteti i Principatës së Moldavisë, tashmë një nga qytetet më të mëdhenj në Rumani.

Tregimi “Kërxfhaliu” i Pushkinit, dy skica origjinale të Pushkinit për luftëtarët shqiptarë dhe kontaktet ruso-shqiptare në Besarabi

nga Dr Dorian Koçi

Njohja dhe rizbulimi i shqiptarëve dhe kulturës së tyre në fillim të shekullit të XIX, është një proces që erdhi gradualisht duke ndërthurrur në vetvete shumë faktorë. Së pari, territoret shqiptare në luftërat Napoloniane u gjendën në mes të interesave të Fuqive të Mëdha të kohës, të cilat interesin e tyre politiko-ushtarak e përkthyen shumë shpejt dhe në interes kulturor. Egzistenca e Pashallëkëve shqiptarë gjysëm autonome në jug dhe në veri të të vendit dhe përfshirja e tyre në lojën diplomatike në rajon i ktheu shumë shpejt ato në vende të vizitueshme dhe të admirueshme ku nuk shikohej vetëm interesi gjeostrategjik por filloi të studjohej dhe kultura, gjuha dhe traditat zakonore që mbarte popullsia e tyre. Pas vitit 1809, vit që shënon vizitën e Bajronit dhe mikut të vet Hobhouse në Prevezë, Janinë dhe Tepelenë, territoret shqiptare nisën të jenë pjesë e turit të madh kulturor anglez që zhvilloin të rinjtë aristokratë anglezë që prej shekullit të XVI.

Një numër i madh udhëtarësh, diplomatësh, tregtarësh pasuan vizitën e famshme të lordëve anglezë për t'u njohur me Ali Pashën e famshëm që ishte memorizuar si personazh letrar tek poema romantike “Shtegtimet e Child Haroldi”-it, por në të njëjtën kohë u njohën gjatë udhëtimeve të tyre dhe me shqiptarët dhe kulturën e tyre. E bukura, piktoreskja dhe sublimja nën efektin e Romantizmit, rrymës më të re letrare që kish filluar të përshkronte letrat evropiane si një rrymë mendimi dhe shpërthimesh lirike po aq dhe revolucionare filloi të lërë gjurmët e veta në këtë rizbulim kulturor të Shqipërisë dhe shqiptarëve nga elita evropiane e kohës. Mirëpo ky proces nuk do të ecte paralelisht si në perëndim, po ashtu dhe në lindje. Nëse gjatë kësaj kohe shikojmë një seri veprash të botuara të autorëve anglezë dhe francezë të cilat krijojnë dhe prezantojnë në Europë imazhin e Shqipërisë dhe shqiptarëve, gjejmë shumë më pak fragmente të pranisë së tyre në letërsinë dhe literaturën e udhëtimit ruse.

Në këtë drejtim nuk është se ka influencuar largësia gjeografike si mund të mendohet në pamje të parë, pasi të paktën që nga vitet e luftës Ruso-Turke 1768-1774 dhe ekspeditës së Orlovit në More në 1770-1771, prania ruse në Mesdhe sa vjen dhe rritet. Përveçse luftës tjetër Ruso-Osmane 1787-1792 dhe dërgimit të vazhdueshëm të agentëve për të rekrutuar popullsinë luftarake të Epirit, prania ruse do kulmojë me themelimin e Republikës së Shtatë Ishujve Jonianë në 1800-1807, tashmë si aleatë me Perandorinë Osmane. Konventa ruso-osmane e muajit prill 1800 krijoi Republikën e Shtatë Ishujve dhe

me këtë sanksionoi vendosjen e rusëve në Ishujt Jonianë. Kjo konventë vendoste, që edhe qytetet e bregdetit të pushtuara nga forcat e Ali Pashë Tepelenës, të konsideroheshin si prona të Sulltanit, por Ali Pashë Tepelena edhe pse largoi forcat e veta nga këto qytete, arriti ta manipulonte të dërguarin e sulltanit. Prania e rusëve në Ishujt jonianë, ndërhyrja e mëparshme e tyre në Pargë si dhe përpilimi i konventës i ashpërsoi marrëdhëniet diplomatike midis dy palëve. Diplomatët rusë filluan të ndjekin politikën e mëparshme të venedikasve, duke nxitur e përkrahur elementin e krishterë shqiptar, si suliotët dhe himariotët, si dhe bllokun feudal të Shqipërisë së Jugut të udhëhequr nga veziri Ibrahim Pasha i Beratit, Mustafa Pashë Koka i Delvinës dhe bejlerët e Çamërisë. Në vitin 1798, Mustafa Pashë Koka iu ishte drejtuar për ndihmë rusëve për të rifituar Pashallëkun e Delvinës, mirëpo në tetor 1799, Ali Pashë Tepelena e detyroi t'i nënshtrohej me forcën e armëve. Kur rusët e detyruan Portën e Lartë të nënshkruante traktatin e 21 prillit 1800, ata kërkuan që drejtimi i sanxhakut të Delvinës t'i jepej agjentit të tyre, Mustafa Pashës⁸. Për shtatë vjet rusët do të qeverisin të vetëm nga Korfuzi, Republikën e Shtatë Ishujve por do të kenë

⁸ *Historia e popullit shqiptar*, Toena, Tiranë: 2002, fq. 643

dhe kontakt të ngushtë me popullsinë e bregut shqiptar, si dhe me suliotët pasi nën asistencën e tyre do të krijohet Regjimenti Shqiptar që do shërbente për mbrojtjen e ishujve dhe për të mbajtur larg synimet ekspansioniste të Ali Pashë Tepelenës. Ndërhyrja ruse u intensifikua më tepër pas emërimit të Kontit Mecenigo (1765-1836) si përfqësues të Rusisë në Ishujt Jonianë. Konti Mecenigos ishte nga Zakyntho, pasardhës i një familje shumë të njohur venedikase që kishte nxjerrë dhe Dozhë dhe diplomatë. Ai i përkiste degës së familjes Mecenigo që kishte sunduar për një kohë të gjatë në Zakyntho, kur Ishujt Jonianë kishin qenë nën sundimin venedikas. Në 16 gusht të vitit 1802, Konti Mecenigo zbarkoi në Ishujt Jonianë për ti vendosur nën kurorën ruse. Menjëherë ai nxorri një shpallje që i njoftonte qytetarët e Republikës së shtatë ishujve se ishte i dërguari i Carit të Rusisë për të vendosur rregullin dhe qetësinë në Ishujt Jonianë.⁹ Interesat ruse në rajon por edhe të klasës drejtuese të Ishujve Jonianë ishin që të kishin një territor sa më të gjerë influencash në bregun përballë, në mënyrë që të siguronin furnizime të vazhdueshme me grurë dhe drithëra. Në pranverën e vitit 1804, Ali Pasha u përgatit të dërgonte ushtritë e vet në viset bregdetare me pretekst se do të viltë taksat e skelave, që

⁹ Enciklopedia Greke : Zëri Georges Mecenigos



kishte marrë në sipërmarrje nga Kapudan Pasha. Qëllimi i tij ishte të rrethonte Çamërinë, që ta nënshtronte me lehtësi. Në qershor të atij viti, me nxitjen e Mecenigos, përfaqësuesit rus në Korfuz, bejlerët çamë formuan “Lidhjen e Çamërisë”. Në këtë hynë dhe të mërguarit suliotë të Korfuzit. Mes të besëlidhurve shquheshin emrat e bejlerëve të Çamërisë: Pronjatëve, Balo Husos të Margëlliçit, Dajlananjëve të Konispolit, Abdurrahim Zigurit të Varfanjit, Dematëve dhe Sejkatëve të Filatit. Kjo lidhje udhëhiqej nga Mustafa Pasha i Delvinës. Në dispozitat e marrëveshjes, që u nënshkrua më 27 qershor 1804, parashikohej që gjatë kohës që këta bejlerë do të luftonin kundër Ali Pashës, qeveria ruse do t’i furnizonte çdo muaj me 100 fund barot, 200 fund plumb dhe 1000 kg drithëra.¹⁰ Këtyre forcave iu bashkangjitën edhe luftëtarët e Regjimentit Shqiptar të Korfuzit, me suliotë, himariotë dhe të tjerë shqiptarë të dëbuar nga territoret e kontrolluara nga Ali Pashë Tepelena. Këto forca ishin të organizuara në 6 kompani të këmbësorisë së lehtë nën komandën e Gjeneralit Anthres të kombinuara me katër kompani himariotësh nën komandën e Kolonelit Beckendorf.¹¹ Por, ndryshimi i beftë në politikën e Portës së Lartë si dhe shpërthimi i luftës Ruso-Turke 1806-1812, e minimizoi rrezikun rus dhe i dha mundësi Ali Pashë Tepelenës, që të hidhej në sulm për të nënshtruar bejlerët e Çamërisë. Nga e gjithë kjo periudhë qeverisje ruse në fakt kemi vetëm raporte diplomatike, shumë të vlefshme dhe të rëndësishme për gjendjen politike dhe administrative të Pashallëkut të Janinës, por mungojnë vepra kulturore si shënimet e udhëtimit të William Martin Leake, Dr Henri Holland, Francois Pouqueville etj.

Çuditërisht, prania dhe imazhi i shqiptarëve në letërsinë e kultivuar ruse do të vinte jo nga administrata e shtatë ishujve, por nga prania e shqiptarëve si pjesë e Regjimentit të shenjtë të krijuar nga Aleksandër Ipsilanti¹² në prag të shpërthimit të Revolucionit Grek në provincat Danubiane. Shqiptarët ishin vendosur që në fillimet e themelimit të qytetit të Odesës, ku shërbenin si mercenarë dhe tregtarë të vegjël, të njohur si me emrin arnautë. Qyteti i Odesës, ishte një qytet kozmopolit ku gjendeshin të gjitha popullsitë. Në vitet 1823-1824, aty ishte i internuar shkrimtari i madh rus Pushkin që shkroi se “ajri është i mbushur me Europë”. Në Odesë ka dy rrugë, Arnauti i vogël dhe Arnauti i madh, të cilat sot quhen ulica albanske dhe që dëshmojnë praninë shqiptare në këtë qendër të madhe urbane e port të rëndësishëm të Detit të Zi. Shkrimtari i madh romantik Pushkin, i ndodhur në internim në Besarabi, në Kishinev (sot Kishinau – kryeqyteti i Republikës së Moldavisë), do të jetë dëshmitar i shpërthimit të kryengritjes së Aleksandër Ipsilantit dhe të luftimeve me forcat otomane. Revolta greke për çlirimin nga sundimi osman preokupoi mendjen e Pushkinit herë pas here, duke lënë një përshtypje të vazhdueshme në krijimtarinë e tij letrare. Ai shprehu ndjenjat e tij filohelenike për “përpjekjet fisnike të një populli në procesin e rilindjes”, në një numër poezish, letrash, shënimesh, ditarësh, fragmente dhe histori të frymëzuara nga ngjarjet e vitit 1821 në provincat rumune dhe revolucionin në Greqinë kontinentale. Në shkrimet e tij të papërfunduara, “Note sur la Revolution d’Ipsilanti” dhe “Note sur Penda-Deka”, Pushkini planifikoi të

shkruajë një përmbledhje të shkurtër të lëvizjes Heteriste në provincat Danubiane dhe rreth veprimtarisë së oficerëve heteristë Konstandin Penedekas, Konstantin Dukas dhe Vasilis Karavias, të cilët i takoi në Kishinev pas dështimit të kryengritjes në principatat rumune. Ai bisedoi me ta në disa raste në shtëpinë e mikut të tij, Ivan Petrovich Liprandi, një kolonel që shërbente në ushtrinë ruse. Pushkini mbledhi nga ta informacione nga heteiristë të lidhje me kryengritjen Hetairiste në Principatat dhe historisë së rumunëve, duke e frymëzuar atë për të shkruar dy legjenda historike, «Duca» dhe «Dafna» dhe Dabizha nga historia e kaluar e Moldavisë, megjithëse origjinalet nuk janë më të gjata¹³. Por mes forcave të “Filiki Eterisë”, merrnin pjesë shumë shqiptarë, përshtkrimi piktoresk i të cilëve do

fisnik dhe romantik, përdorimi i të cilave filloi para, gjatë dhe pas përfundimit të fushatave heteriste në principatat.¹⁴ Debate të shumta ka pasur në kritikën letrare nëse personazhi letrar Kërkhaliu është një person historik pjesëmarrës në fushatën e Ypsilantit apo është një personazh fiktiv, frut i ndodhive anekdodike të dëguara nga Pushkini gjatë qëndrimit të tij në Moldavi e që talenti i tij letrar e ktheu në një simbol të heroit rrebel e popullor që revoltohet kundër padrejtësisve. Shumica e historianëve, shkrimtarëve dhe kritikëve letrarë pajtohen se Kërkhaliu është një histori e shkurtër që ka të bëjë me një episod nga lëvizja Heteriste në Principatat Danubiane. Por ata nuk bien dakord për përmbajtjen e tij, paraqitjen e fakteve dhe, veçanërisht, nëse Kërkhaliu ishte një karakter historik apo i trilluar.



të jetë i pranishëm në tregimin “Kërkhaliu”, botuar për herë të parë në 1 dhjetor 1834. Tregimi është një jehonë jo vetëm i kujtimeve të drejtpërdrejta të Pushkinit ndaj shpërthimit të revolucionit grek por edhe një ilustrim i motiveve romantike të karektereve të fortë dhe piktoreskë nga Ballkani. Pushkini në tregimin “Kërkhaliu” ndërthuri stilin historik dhe fantastik të rrëfimit i cili ishte mbizotërues në epokën e romantizmit gjatë dekadave të para të shekullit të 19-të. Në përdorimin këtyre formave, ai prezantoi tregime të besueshme, informuese dhe të dëshmitarëve okularë, sëbashku me legjendat dhe përrallat për heronjtë rebelë popullorë. Në këtë mënyrë, ai krijoi një rrëfim letrar të një karakteri trim,

Këto çështje i ndau studiuesit pushkinianë në dy grupe: një grup që konsideron se heroi i tregimit të Pushkinit është fryt i fantazisë, fiktiv, inekzistent, i idealizuar dhe karakter romantik - krijim i imagjinatës së poetit. Ata pretendojnë se vetë emri Kërkhali¹⁵ ishte një referencë e përgjithshme dhe sinonim të një brigandi, klefti ose hajduti, i cili shpesh bashkohej si mbiemër për individë

¹⁴ James J. Farsolas. Historical reality and legend in Alexander Pushkin’s short story *Kirdjali* — an episode from the Greek insurrection of 1821 in the Romanian principalities.. University of South Carolina Coastal Carolina University Myrtle Beach, S.C., U.S.A., fq 66-67.

¹⁵ Gjatë shekullit të XVIII kështu quheshin forcat e parregullta osmane të cilët përdornin qytetin Kirca Ali në Bullgari si një vend strehimi dhe furnizimi prej nga terrorizonin gjithë Ballkanin. Njësitë më të mira të këtyre forcave udhëhiqeshin nga Osman Pazvantoglu Pasha, i cili sundoi pjesën më të madhe të verilindjes teritoreve bullgare dhe deltës së Danubit deri në 1807. Në Shqipëri ka mbijetuar si mbiemër në formën Kërkhaliu(kujto emrin e një Heroi të Popullit nga Luma e Kukësit Hasan Kërkhaliu, 1902 - 1946)

që i përkisnin kombësive të ndryshme në të gjithë gadishullin Ballkanik. Duke përjashtuar pasazhe të caktuara, tregimi është, sipas tyre, një histori romantike dhe anekdotike, ndërsa protagonistit të saj i mungon identiteti historik dhe i përket fushës së legjendës popullore. Nga ana tjetër, grupi i dytë i kritikëve argumentojnë se Kërkhaliu ishte një person real historik; se ai luftoi në radhët e ushtrisë së Ipsilantit në provincat rumune; dhe se tregimi dhe skena të ndryshme të cilat Pushkini përshkruan në të, bazohen në fakte dhe burime historike. Në mbështetje të këtyre argumenteve, ata përdorën një numër dokumentesh bashkëkohorë, raporte të autoriteteve ruse të Besarabisë dhe raportet e agjentëve konsullorë të huaj në Principatat Danubiane.¹⁶ Pavarësisht këtyre

debateve, Beljinski kritiku më i madh rus i kohës besonte se Pushkini ishte bazuar në një histori të vërtetë. Ai shkruan se tema e tregimit “Kërkhaliu” ishte e bazuar në fakte historike. Në një karakterizim të shkurtër ai shkroi se “Kërkhaliu” është një histori mjeshtërore e një ngjarjeje të vërtetë”. Duke e lexuar atë, mund të ndihet “thjeshtësia e saj e natyrshme shkurtësia dhe energjia, poezia dhe qartësia e saj”¹⁷. Kërkhaliu dhe luftëtarët shqiptarë të përshkruar në tregim të kujtojnë personazhet e Bajronit në “Turkish Tales”. Gjatë gjithë karrierës së tij letrare, Pushkini dëshmoi një magjepsje të veçantë për brigandë dhe heronj popullorë nga historia e Rusisë dhe popujve të Ballkanit, jetën dhe aventurat e

¹⁶ James J. Farsolas. Historical reality and legend in Alexander Pushkin’s short story *Kirdjali* — an episode from the Greek insurrection of 1821 in the Romanian principalities. University of South Carolina Coastal Carolina University Myrtle Beach, S.C., U.S.A., fq 67.

¹⁷ Po aty, fq 73

¹⁰ Irakli Kocollari, *Policia sekrete e Ali Pashës*, Adel Print, Tiranë: 2009, fq. 32

¹¹ Irakli Kocollari, *Policia sekrete e Ali Pashës*, Adel Print, Tiranë: 2009, fq. 35

¹² Udhëheqës i Revolucionit Grek. (12 December 1792 – 31 January 1828). Ipsilanti ishte anëtar i një familje të shquar greke nga lagjia Fanar i Konstandinopojës, princ i principatave rumune në Danub, oficer kryesor i kavalërisë ruse gjatë luftërave Napoliane dhe udhëheqës i Filiki Eterisë-Shoqëria e Mique, organizatës sekrete që koordinoi fillimin e revolucionit grek.

¹³ James J. Farsolas. Historical reality and legend in Alexander Pushkin’s short story *Kirdjali* — an episode from the Greek insurrection of 1821 in the Romanian principalities. University of South Carolina Coastal Carolina University Myrtle Beach, S.C., U.S.A.

të cilëve ai i përshkroi në disa prej veprave të tij. Ai u intrigua veçanërisht nga individë që u rebeluan kundër shoqërisë sistemit, pabarazitsë dhe padrejtësive të tij. Ai u përpoq të “rehabilitonte” brigantët dhe rebelët bëmat e të cilëve kishin hyrë në traditën dhe këngët popullore, por që kishin qenë harruar ose lënë pas dore nga historia. Në të njëjtën kohë, ai bashkoi veprat e tyre legjendare dhe trilluese me fakte historike për të treguar se ç’faktorë të caktuar dhe forca formuan jetën e tyre dhe i bënë ata heronj popullorë. Ai studioi dhe përshkroi jetën e tyre bazuar jo vetëm në traditat gojore dhe popullore, por gjithashtu duke përdorur dokumentet zyrtare të cilat i hasi në zyrën e gjeneralit Ivan N. Inzov, guvernator i Bessarabisë, ose ndërmoi vetë studime hulumtuese. Ai përdori në romanet e tij historikë dhe anekdotikë dëshmitë e dëshmitarëve okularë dhe dëshmi të tjera nga përvoja e tij personale me individë që hasi në Rusinë jugore.¹⁸

Në këtë kontekst, përmendja shqiptarëve në Besarabi fiton dhe një rëndësi historike pasi është jo vetëm një komfirmim i pjesëmarrjes së tyre në fillimet e luftimeve të Revolucionit Grek, por në tregim kemi dhe një numër të saktë të tyre, rreth 600 veta. I interesuar për luftërat çlirimtare në Moldavi e Vllahi më 1821 kundër pushtimit osman, nën udhëheqjen e Vladimireskut dhe Ypsilantit, Pushkini shkruan për betejën e Skulenit. Beteja afër Skulenit, siç duket, nuk u përshkrua nga asnjë me gjithë të vërtetën e saj ngjethëse. Imagjinoni 700 burra- arnautë, shqiptarë, grekë, bullgarë, që s’kishin idenë më të vogël për artin ushtarak, duke u prapsur nën vështrimin e pesëmbedhjetë mijë kalorësve turq.¹⁹ Pushkini rrëfen me simpati në tregimin e tij për trimërinë e një shqiptari, të quajtur Koçandoni. “Koçandoni, një burrë shumë i fortë, ishte plagosur me heshtë në bark. Me një dorë ai kish ngritur shpatën, me tjetrën kish kapur heshtën, e kish ngulur më thellë brenda vetes, në mënyrë që të mundej të godiste me shpatë armikun e tij, dhe sëbashku me të, kish rrënë për tokë.”²⁰

Pushkini shkruan në tregimin e tij “Kërxhaliu” se pas disfatës ...rreth gjashtëqind arnautë u shpërndanë nëpër gjithë Besarabinë; pavarësisht se nuk dinin sesi të mbijetonin, ata i ishin mirënjohës Rusisë për mbrojtjen e dhënë duke i lejuar të kalojnë në bregun tonë. Ata bënëin një jetë të plogët, por jo të shthurrur. Mund t’i shikoje gjithmonë nëpër kafenetë alla turke të Basarabisë, duke tymosur me nargjile të gjata e ruftur gllënkë pas gllënke llumin e kafes në filxhane të vegjël. Mëngoret e tyre plot qëndisma dhe opingat majëmprehta me xhufkat e kuqe sipër kishin filluar të griseshin, por festet e tyre me xhufkë vazhdonin t’i mbanin ende në kokë,ndërsa pistoletat dhe jataganët u dilnin sipër silaheve të gjera. Asnjëri nuk ankohej për ta dhe as që nuk mund t’u vinte mendja, që këta burra të urtë e paqësorë ishin të famshmit kryengritës të Moldavisë, miqtë e Kërxhaliut të frikshëm, dhe akoma më tepër që ai vetë ndodhej mes tyre.²¹ Të kësaj periudhe janë dhe dy vizatime origjinale të Pushkinit të luftëtarëve shqiptarë që ai i hasi në Besarabi. Pushkini shpesh vizatonte skica bardhezi si në letrat e tij personale, ashtu edhe në faqet e dorëshkrimeve të tij. Si një drejtim tjetër i krijimtarisë së tij, skicat e Pushkinit - aq të dashura në Rusi sa janë përpiluar dhe botuar shumë herë - por mbeten pothuajse të panjohura në

vende të tjera.²² Edhe pse Pushkini është botuar herët në Shqipëri që në vitin 1922 në asnjë përmbledhje tregimesh, dramash apo poezish nuk ka qenë e shoqëruar me skicat gravurat të vizatuara nga poeti. Skica pasqyron dy luftëtarë shqiptarë me gjithë elementët e veshjes tradicionale shqiptar: fustanellë,mëngore, silah, armë brezi dhe opinga me xhufka. Të tillë i përshkruan shqiptarët dhe në tregimin “Kërxhaliu” kur shkruan se mëngoret e tyre plot qëndisma dhe opingat majëmprehta me xhufkat e kuqe sipër kishin filluar të griseshin, por festet e tyre me xhufkë vazhdonin t’i mbanin ende në kokë, ndërsa pistoletat dhe jataganët u dilnin sipër silaheve të gjera.²³Një tjetër interesim dhe përmendje e shqiptarëve në krijimtarinë e Pushkinit është në poemën e lënë dorëshkrim kushtuar Jorgo Olimpiotit. Pushkini filloi të shkruante një poezi të gjatë me titull “Poema e Heteristit” (Iordaki Olympioti), ose i njohur më mirë si Jorgo ose Jorgoqisis Olympioti²⁴. Në të, ai dëshironte të përshkruante betejën e fundit vendimtare të Heteristëve në manastirin e Secu²⁵, pavarësisht faktit se nuk e përfundoi kurrë atë. Ai la vetëm një synops të përafërt:

Dy Arnautë përpiqen të vrasin Aleksandër Ypsilantin. Georgakis i vret ata. Në mëngjes ai u tregon Arnautëve për arratisjen e Ipsilantit [drejt territorit austriak]. Georgakis merr komandën e ushtrisë dhe shkon në male, i ndjekur vazhdimisht nga turqit. Secu²⁶.

Dhe strofa e parë e poemës:

Në fusha, male dhe pyll
Nata perëndon e qetë;
Dhe nën kulmin e errët të qiellit
... Ipsilanti po dremit.

Në 1833 ai shkroi, por la pa përfunduar, atë që duket të ishte një studim i gjatë në lidhje me Ipsilantin dhe ngjarjeve të kryengritjes hetairiste në provincat rumune, duke përfshirë disa kujtime personale të viteve të kaluara në jug të Rusisë. Në synopsin e përafërt shkruhet:

Kishinev — Ardhja ime në Kaukaz dhe Krime — Orlov — Ipsilanti—Kamenka — Pusi — Revolucion i Grek — Liprandi — Viti 1812—Mort de sa femme — Le renégat — Pashai i Erzerum.²⁷

Këto shënime e synopse në arkivin e Pushkinit si dhe skicat e vizatuara nga ai vetë për dy karaktere shqiptarë nuk kanë qenë të njohura për publikun shqiptar pavarësisht faktit që vepra e Pushkinit po bëhet gati një shekull që ka filluar të përkthehet në shqip. Përkthimi i parë i krijimtarisë së Pushkinit i përket korrikut të vitit 1922 në shtypin periodik, tek revista Shkëndia e Korçës. Tek nr. 1 e më pas edhe në numrat 2 e 3 të saj gjendet e përkthyer drama “Kalorësi dorështrenguar”. Në vitin 1923 po tek Shkëndia, në nr.5 dhe 11 do të përkthehet drama “Rusallka”. Në fund të tyre nuk shënohet emri i përkthyesit, por kuptohet se është Milto Sotir Gurra sepse

²² Ilia Blinderman, Revered Poet Alexander Pushkin Draws Sketches of Nikolai Gogol and Other Russian Artists. Open culture.com.

²³ “Kërxhaliu” Përktheu nga rusishtja:Stela Koçi. Suplementi “Rilindësi” 25.10.2015, fq 19-20.

²⁴ Udhëheqës i Revolucionit Grek(1772-1821) Ai u shqua për aktivitetet e tij në Principatat Danubiane ku gjeti dhe vdekjen në Manstirin Secu.

²⁵ Beteja e Skulenit u zhvillua në 29 qershor në fshatin Skulen i pranë brigjeve të Prutit në Moldavi, midis forcave osmane të Sulltan Mahmudit II dhe forcave të Filiki Eterisë të udhëhequra nga princi George Catakouzenos . Beteja ndodhi si rezultat i masave ndërshtimore të ndërmarra nga otomanët pas dështimit të ekspeditës së Aleksandër Ipsilantit në dy principatat e Danubit dhe vinte menjëherë pasbetejës së Dragoshanit.

²⁶ Manastir në Rumani që shërbeu si fortesë për forcat e eteristëve kur shpërtheu revolta në principatat danubiane

²⁷ James J. Farsolas. Historical reality and legend in Alexander Pushkin’s short story *Kirdjali* — an episode from the Greek insurrection of 1821 in the Romanian principalities. University of South Carolina Coastal Carolina University Myrtle Beach, S.C., U.S.A., fq 59.




dy vjet më vonë, dy dramat e përkthyer a në revistën që ai drejtonte bashkë me një dramë tjetër do ti botonte, duke i ofruar lexuesve librin e parë të përkthyer dhe botuar në shqip nga Pushkini. Në vitin 1924, ky libër që përmbante tri drama të përkthyer a: “Mocarti dhe Saljeri”, “Kalorësi dorështrenguar”, “Rusallka”, u botua në Korçë. Libri nuk përmbante vetëm dramat e përkthyer a, por ishte i shoqëruar me “Biografia e Aleksandër Sergjevic Pushkin”, një paraqitje prej 4 faqesh rreth shkrimtarit si dhe i shoqëruar në fund me “Dy fjalë për tri dramat”, shënime të një nga kritikëve më të njohur, të asaj kohe, të letërsisë ruse të shek. XIX. V. G. Bielinskii.²⁸ Përkthimi i parë pas Luftës së II Botërore i përket vitit 1945, vargjeve të poezisë “Profeti” të përkthyer a nga Sotir Caci, tek “Bashkimi”, i shoqëruar me një tregim “Rob’ i Kahkazit” tek Rinia në 46 dhe “Katundi” tek Luftëtari në ‘47. Në këtë atmosferë me rastin e 150-vjetorit të lindjes së Pushkinit i tërënumri 4 i revistës letrare “Literatura jonë” botuar në 1949 do ti kushtohet kësaj figure dhe krijimtarisë së tij. Në këtë numër janë botuar një sërë artikujsh kritik nga Zihni Sako, Llazar Siliqi, Andrea Varfi, Xhemal Broja²⁹. Në po të njëjtën kohë si pasojë e sovjetizmit të plotë të kulturës shqiptare do të botohet një numër i plotë, numri 18 i revistës Shqipëri-BRSS (Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike) do t’i kushtohet 150-vjetorit të lindjes. Kjo revistë do të filloj të botohet në vitin 1947, dhe ishte organ i Shoqërisë për lidhje kulturore midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik, që do të botohet me këtë emër gjatë periudhës 1947-1951. Në faqet e saj do të ketë përkthime të shumta të Pushkinit, pornumri 18 do t’i kushtohet plotësisht këtij shkrimtari, madje në kopertinën e saj është portreti i shkrimtarit.³⁰ Leximi i ndryshëm sociologjik dhe intepretimi i kritikës shqiptare që iu bë veprës së Pushkinit gjatë periudhës së realizmit socialist nuk nxorri në pah sa duhet vlerat estetike të veprës së tij po aq sa dhe aspektet e tjera, e mes të tjerash dhe koleksionin e madh të skeqeve të tij në grafikë e pikturë çka e bën një nga shkrimtarët më të veçantë romantikë. Përkthimet e Pushkinit, në 10 vjeçarin e parë, pas luftës do të realizohen nga Andrea

²⁸ Anila Mullahi. *Ardhja e pushkinit* në gjuhën shqipe nëpërmjet përkthimeve dhe kritikës letrare. 220-vjetori i lindjes së poetit të madh rus A. S. Pushkin, Universiteti i Tiranës Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Departamenti i Gjuhëve Sllave E Ballkanike, fq 96.

²⁹ Po aty, fq 100.

³⁰ Po aty, fq 101



Varfi, Skënder Luarasi, Llazër Siliqi, Vedat Kokona, Zihni Sako, e më vonë në vitet ‘60-‘70 nga Lasgush Poradeci, Dritëro Agolli, V. Angoni, Jorgo Bllaci, Ismail Kadare, Petraq Kolevica etj.³¹

Janë të shumtë kritikët letrarë që kanë vënë re ngjashmëritë në krijimtarinë letrare midis Pushkinit dhe Bajronit, sidomos në subjektet e Ballkanit dhe Besarabisë dhe Kaukazit. Pikëtakimet e Pushkinit me Bajronin janë shumë të njohura për studiusit e letërsisë, sidomos në formën e romanit në vargje “Eugen Oneigini”, ku ndihet influenza e heroit tipik bajronian. Gjithësesi duhet pranuar se Romantizmi si rrymë letrare me adhurimin e vet ndaj së bukurës sublime, heronjve të veçantë krenarë, humor prishur, cinikë, rebelë, të trishtuar, përbuzës, hakmarrës të paepur, por prapë së prapë të aftë për të ndjerë një dhembshuri të thellë e të fortë, bën të mundur që autorët të ngjajnë mes tyre dhe jo domosdoshmërisht të influencoheshin nga njëri-tjetri. “Turkish Tales” të Bajronit dhe “Kerxhaliu” i Pushkinit kanë të përbashkët sfondin kulturor ku mbizotëron kostumi tradicional i shqiptarëve dhe veshja e tyre fustanella, ndaj nëse në fillimet e shekullit të XIX mund të flasim për një tipar karekteristik të shqiptarëve nga Adriatiku deri në Besarabi e Det të Zi, padyshim do të reshtonin të parën dhe si më përfaqësuese fustanellën. Me të vërtetë fillimi i shekullit të XIX ishte koha e revolucioneve dhe e fustanellës.

Bibliografi:

- Anila Mullahi. *Ardhja e Pushkinit* në gjuhën shqipe nëpërmjet përkthimeve dhe kritikës letrare. 220-vjetori i lindjes së poetit të madh rus A. S. *Pushkin*, Universiteti i Tiranës Fakulteti i Gjuhëve Të Huaja Departamenti i Gjuhëve Sllave E Ballkanike
- Enciklopedia Greke : Zëri Georges Mecenigos
- Historia e popullit shqiptar*, Toena, Tiranë: 2002
- Irakli Kocollari, *Policia sekrete e Ali Pashës*, Adel Print, Tiranë: 2009
- JAMES J. FARSOLAS. HISTORICAL REALITY AND LEGEND IN ALEXANDER PUSHKIN’S SHORT STORY KIRDJALI — AN EPISODE FROM THE GREEK INSURRECTION OF 1821 IN THE ROMANIAN PRINCIPALITIES. University of South CarolinaCoastal Carolina University Myrtle Beach, S.C., U.S.A.,

¹⁸ James J. Farsolas. Historical reality and legend in Alexander Pushkin’s short story *Kirdjali* — an episode from the Greek insurrection of 1821 in the Romanian principalities.. University of South CarolinaCoastal Carolina University Myrtle Beach, S.C., U.S.A., fq 60.

¹⁹ “Kërxhaliu” Përktheu nga rusishtja: Stela Koçi. Suplementi “Rilindësi” 25.10.2015, fq 19-20

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty.

³¹ Po aty, fq103

Në faqen 22 të *Historisë së Luftës Evropiane*, të Liddell Hart-it, lexon se sulmi i trembëdhjetë divizioneve britanike (të mbuluara nga një mijë e katërqind pjesë artilerie) kundër vijës Serre-Montauban, parashikuar për në 24 korrik 1916, u shty deri në mëngjesin e datës 29. Shirat e rrëmbyeshëm (shpjegon kapiteni Liddell Hart) qenë shkaku i kësaj shtyrjeje – që sigurisht nuk pati ndonjë rëndësi. Deklarata e mëposhtme, e diktuar, e kontrolluar dhe e firmosur nga doktor YU Tsun, profesor i vjetër i anglishtes në *Hochschule* të Tsingtao-s, hedh dritë të sigurt mbi këtë ngjarje. Mungojnë dy faqet e para.

“...dhe mbylla telefonin. Përnjëherë njoha zërin që ishte përgjigjur në gjermanisht. Ishte zëri i kapitenit Richard Madden. Madden-i në apartamentin e Viktor Runeberg-ut, do të thoshte fundi i anktheve dhe – por kjo dukej hiçmosgjë, ose *ashtu më ngjante mua* – i jetës sonë. Donte të thoshte se Runeberg-un, ja e kishin arrestuar, ja e kishin vlarë. Përpara se të perëndojë dielli i kësaj dite, mua më pret i njëjti fat. Madden-i qe i pamëshirshëm, ose më mirë ishte i detyruar të qe i tillë. Irlandez nën urdhërat e Anglisë, i akuzuar më parë si jo shumë i flaktë, e ndoshta i akuzuar edhe për tradhti, s’kish si të mos e kapte flurthi e të mos ishte mirënjohës për këtë të mirë që i binte prej qielli: zbulimi, kapja dhe ndoshta vdekja e dy agentëve të perandorisë gjermane? U ngjita në dhomën time; në mënyrë krejt absurde mbylla derën me çelës dhe u shtriva në shpinë në shtratin e ngushtë prej hekuri. Nga dritarja vështroja po ato pullaze të gjithëshme dhe diellin e orës gjashtë zënë nga retë. M’u duk e pabesueshme që kjo ditë pa parandjenja e pa simbole të qe dita e vdekjes sime të pashmangshme. Ndonëse më kish vdekur im atë, ndonëse e kisha kaluar fëmijërinë në një kopsht simetrik të Hai Feng-ut, edhe mua më kishte ardhur radha të vdisja. Pastaj vrave mendjen dhe kuptova se gjithçka që ka për të ndodhur, do të ndodhë tani, pikërisht tani. Kalojnë shekujt dhe vetëm tani, në të tashmen ndodhin gjëra. S’numërohen njerëzit që janë në ajër, në tokë, në det dhe gjithçka që ndodh realisht, më ndodh mua... Kujtimi gati i pahonepsshëm i surratit prej kali të Madden-it, m’i fshiu këto përcartje. Në mes urrejtjes dhe tmerrit (tani s’ma bën syri tërë të flas për tmerrin, tani që jam tallur paq me Richard Madden-in, tani që qafa ime e ka me hak litarin) mendova se ai luftëtar shkumëzues dhe pa dyshim i lumtur, nuk dyshonte aspak se unë kisha në dorë të Fshehtën. Emrin e vendit të saktë ku gjendej fusha e re e artilerisë britanike mbi Ancre. Një zog vijëzoi qiellin e hirtë dhe verbazi unë e përfytyrova si avion dhe atë avion e ktheva në shumë avionë (në qiellin francez) tek fshinin nga faja e dheut me bomba vertikale fushën e artilerisë. Ah sikur goja ime, përpara se ta copëtoje plumbi, të mund të këlthiste atë emër që ta dëgjoni deri në Gjermani... Zëri im njerëzor qe shumë i dobët. Qysh mund ta shpija deri në vesh të Shefit? Në veshin e atij njeriu të molisur dhe të urreyer, që për Runeberg-un dhe mua dinte vetëm që ndodheshin në Staffordshire dhe priste më kot lajme nga ne në zyrën e tij të zbrazët në Berlin duke zhbhiruar pafundësisht gazetatat... Thashë me zë të lartë: *Duhet të arratisem*. U ngrita pa zhurmë, brenda një heshtjeje kotësisht të përkryer, sikur Madden-i të ishte tani duke më përgjuar. Diçka – mbase thjesht dëshira për t’i rrëfyer vetvetes se mundësitë që kisha qenë hiç – më bëri t’i ktheja xhepat nga ana tjetër. Gjeta ato që dija se do të gjeja. Orën amerikane, zinxhirin e saj prej nikeli dhe fushën katrore, mbajtësen e çelësave me çelësat kompromentues e të panevojshëm të apartamentit të Runeberg-ut, librezën, një letër që vendosa ta zhdukja në çast (por që nuk e zhduka), një koronë, dy shilinga dhe një cent, lapsin kuq e blu, shaminë, revolverin me një plumb. Në mënyrë krejt absurde, e peshova në dorë për t’i dhënë vetes kurajo. Mjegullazi mendova se një goditje pistolette mund të dëgjohej larg. Në dhjetë minuta e poqa planin tim. Libri i telefonave më dha emrin e njeriut të vetëm që mund ta jepte atë lajm: jetonte në rrethinat e Fenton-it, më pak se gjysmë ore rrugë me tren.

Jam burracak. Tani po e them, tani që kam përmbushur një plan, të cilin askush nuk ka për ta quajtur të rrezikshëm. Unë vetë e di sa i llahtarshëm qe zbatimi i tij. Nuk e bëra për Gjermaninë, jo. As që dua t’ia di për atë vend barbar që më detyroi të zhytem në fëlliqësinë e spiunllëkut. Përkundrazi, njoh një anglez – një njeri të thjeshtë – që për mua s’vlen më pak se Gëtja. Nuk fola më shumë se një orë me të, por gjatë asaj ore ai qe vetë Gëtja. E bëra të gjithën këtë sepse e ndieja që Shefi s’ua kishte fort besën njerëzve të sojit tim – paraardhësve të shumë të vërshojnë brenda meje. Unë desha të provoja se një i verdhë mund t’i shpëtonte ushtritë e tyre. Veç kësaj unë duhet t’i ikja kapitenit. Duart dhe zëri i tij mund të trokisnin në derë nga çasti në çast. U veshja pa zhurmë, u përshëndosha me veten në pasqyrë, zbrita, bëra sytë katër duke kontrolluar rrugën e qetë dhe dola. Stacioni i trenit nuk ishte larg shtëpisë, por m’u duk më e udhës të merrja një makinë. Mendova se kështu rrezikoja më pak të më njihnin; puna është se në rrugën e shkretë e ndieja veten pafundësisht të dukshëm dhe të prekshëm. Më kujtohet se i thashë shoferit të ndalonte pak përpara hyrjes kryesore. Zbrita me një avashllëk të vullnetshëm e

JORGE LUIS BORGES

KOPSHTI ME SHTIGJE QË BIGËZOHEN

Përktheu nga origjinali
Mira Meksi


pothuaj të dhimbshëm. Do të shkoja në fshatin Ashgrove, por e preva biletën për një stacion më larg. Treni nisej pas pak, më njëzet e pesëdhjetë minuta. Nxitova këmbët; treni tjetër nisej më njëzet e një e gjysmë. Platforma qe pothuaj e shkretë. Përshkova vagonat: më kujtohet se pashë disa fshatarë, një grua veshur me të zeza, një djalosh që lexonte me zjarr *Analet* e Tacit-it, një ushtar të plagosur dhe të lumtur. Vagonat lëvizën më në fund. Një burrë që e njihja, vrapoi më kot deri te kufiri i platformës. Ishte kapiteni Richard Madden. I sflitur, duke u dridhur, u kruspulloso në cepin tjetër të ndenjësës, larg xhamit të frikshëm.

Nga sflitja, kalova në një lumturi pothuaj të turpshme. Mendova se dueli im tashmë kishte nisur dhe unë e kisha fituar davanë e parë, duke sfiduar, qoftë me ndihmën e atyre dyzet minutave, apo nga një fat i rastit, sulmin e armikut tim. Nxora përfundimin se kjo fitore hiçmosgjë, i hapte udhën fitores së plotë. I dhashë karar se nuk ishte fitore hiçmosgjë, sepse pa atë hapësirë të çmuar që më kishin dhënë në dorë oraret e trenave, tani do të isha, ja në burg, ja i vdekur. Arrita në përfundimin (jo më pak të stërholluar) se lumturia ime burracake provonte se isha i zoti ta shpija përpara aventurën. Nga kjo dobësi nxora forca që nuk më braktisën. Parashikoj se njeriu do t’i futet përherë e më tepër ndërmarrjeve mizore. Së shpejti në botë do të ketë veç luftëtarë dhe banditë. Atyre u jap këtë këshillë: *ai që i futet një ndërmarrjeje mizore, duhet të imagjinojë se tashmë e ka përmbushur detyrën, duhet t’i imponojë vetes një të ardhme që të jetë e pakthyeshme, ashtu siç është e kaluara*. Kështu veprova vetë, ndërsa sytë e mi prej të vdekuri ngujonin rrjedhën e asaj dite që ndoshta ishte e fundit, e po ashtu dhe nderjen e natës. Treni rrëshqiste butë mes mareve. U ndal pothuaj në mes të fushës. Askush nuk e njoftoi emrin e stacionit. “*Ashgrove-i*”? Pyeta disa fëmijë që rrinin në platformë. *Ashgrove-i*, m’u përgjigjën.

Një llambë ndriçonte platformën, por fytyrat e fëmijëve mbetën në zonën e errët. Njëri më pyeti: “*Ju po shkoni në shtëpinë e doktor Stephen Albert-it*”? Pa prituri përgjigje një

tjetër tha: *Shtëpia është larg që këtej, por do ta keni kollaj për ta gjetur po të merrni rrugën majtas dhe në çdo kryqëzim të ktheheni gjithmonë majtas*. U hodha një monedhë (të fundit), zbrita disa shkallë guri dhe hyra në rrugën e vetmuar. Kjo zbriste teposhtë ngadalë. Ishte prej balte. Sipër degëzimet e saj ngatërroheshin. Hëna e ulët dhe e rumbullakët dukej sikur më shoqëronte.

Për një çast mendova se Richard Madden-i kish depërtuar, në njëfarë mënyre, në planin tim të dëshpëruar. Shpejt kuptova se kjo qe e pamundur. Këshilla se përherë duhet të kthehesha majtas më kujtoi se kështu veprohej rëndom për të zbuluar oborrin qendror të disa labirinteve. Diç marr vesh nga labirintet; jo më kot jam stërnipi i Ts’ui Pen-it të famshëm që qeveriste Yunan-in dhe që hoqi dorë përkohësisht nga pushteti për të shkruar një roman, i cili do të qe ku e ku më popullor se *Hung Lu Meng-u*, si edhe për të ndërtuar një labirint ku të humbisnin të gjithë njerëzit. Këtij mudi të dyfishtë i kushtoi trembëdhjetë vjet, por një dorë e panjohur e vrau dhe romani i tij u gjykua si i pakuptimtë, ndërsa labirinti nuk u gjend askund. Nën hijen e pemëve angleze përsiatesha: labirintin e humbur e përfytyrova tek ngrihej i virgjër e i përkryer në majën e fshehtë të një mali; e përfytyrova të mbuluar nga orizoret a poshtë ujërave; e përfytyrova të pafund, jo të ndërtuar me ngrehina tetëkëndore apo me shtigje që kthehen mbrapsht, por me lumenj, provinca, mbretëri... E mendova si labirintin e labirinteve, si një labirint dredhashumë që zmadhohej pambarim, që nxinte brenda të kaluarën dhe të ardhmen dhe që, në njëfarë mënyre, përfshinte edhe yjësitë. I përhumbur në këto pamje mashtruese harrova që më përndiqnin. Për njëfarë kohe të papërcaktuar e ndjeva veten si një perceptues abstrakt i botës. Fusha e gjallë dhe e vagëlluar, hëna, fundmbrëmja vepuruan tek unë ashtu si rrëpira e udhës që nuk linte asnjë mundësi lodhjeje. Mbrëmja ishte e fshehtë, e paanë. Udhë zbriste dhe bigëzohej përmes luadheve tashmë të turbullta. Një muzikë e thekshme dhe si e rrokjësuar afrohej e largohej



me vajtje-ardhjen e erës, mbytur nga gjethet dhe largësia. Mendova se një njeri mund të ishte armik i disa njerëzve, por jo i një vendi, jo i xixëllonjave, i fjalëve, i kopshteve, i rrjedhës së ujrave, i perëndimit të diellit. Kështu mbërrita përpara një porte të madhe e të ndryshkur. Që nga kangjellat deshifrova një rruginë dhe një si lloj pavioni. Kuptova përnjëherë dy gjëra, e para e rëndomtë, e dyta e pabesueshme: muzika vinte nga pavioni, muzika ishte kineze. Prandaj dhe e kisha pranuar të plotë dhe të tërën, pa i kushtuar shumë vëmendje. Nuk më kujtohet në kishte çok, zile apo trokita me dorë. Shkëndijimi i muzikës vazhonte.

Por nga sfondi i shtëpisë së fshehtë po afrohej një fener: një fener që herë i ravijëzonte e herë i fshihte trungjet e pemëve, një fener prej letre në formë tamburi e ngjyrë hëne. E mbante në dorë një burrë i gjatë. Nuk ia pashë fytyrën, sepse më verbonte drita. Hapi portën dhe tha ngadalë në gjuhën time:

– E shoh që mëshirploti Hsi P’eng ka marrë përsipër të më lehtësojë vetminë. Ju, pa dyshim, kërkon të shihni kopshtin, apo jo?

Njoha emrin e njerit prej konsujve tanë dhe përsërita i turbulluar:

– Kopshtin?

– Kopshtin me shtigje që bigëzohen.

Diçka u lloçoit në kujtimin tim dhe me një siguri të pakuptueshme foli:

– Kopshtin e stërgjyshit tim Ts’ui Pen-it.

– Stërgjyshi juaj? Stërgjyshi juaj i lavdishëm? Hyni.

Shtegu me lagështirë gjarpëronte si shtigjet e fëmijërisë sime. Arritëm në një bibliotekë me libra të Lindjes dhe Perëndimit. Njoha disa vëllime në dorëshkrim (të veshur me mëndafsh të verdhë) të Enciklopedisë së Humbur, të cilën e drejtoi vetë Perandori i Tretë i Dinastisë së Shndritshme dhe që nuk shkoi kurrë në shtyp. Disku i gramafonit xhironte pranë një feniksi prej bronxi. Më kujtohet po ashtu, një vazo e madhe e familjes, ngjyrë rozë dhe një tjetër, shekuj më e vjetër se e para, në ngjyrën e kaltërt që artizanët tanë e kopjuan nga poçarët e Persisë...

Stephen Albert-i më sodiste duke buzëqeshur. Ishte (e thashë më lart) shumë i gjatë dhe me tipare të mprehta, me sy ngjyrë gri dhe mjekër po gri. Kishte tek ai diçka prej prifti, por edhe prej marinari; më pas më rrëfeu se përpara se “të ëndërronte të bëhej sinolog”, kishte qenë misionar në Tientsin.

U ulëm; unë mbi një divan të gjatë e të ulët, ai me shpinë nga dritarja dhe nga një orë e lartë, e rrumbullakët. Llogarita se përndjekësi im, Richard Madden-i nuk kishte për të arritur aty përpara një ore. Vendimi im i pakthyesëm mund të priste.

– Fat i çuditshëm, ky i Ts’ui Pen-it, – tha Stephen Albert-i. – Qeverisë i provincës së tij të lindjes, erudit në astronomi, në astrologji dhe në interpretimin e palodhur të librave kanonikë, shahist, poet i famshëm dhe kaligrafist. La gjithçka për të krijuar një libër dhe një labirint. Hoqi dorë nga kënaqësitë e studimit, të drejtësisë, femrave, nga banketet, nga vetë erudicioni, dhe u ngujua për trembëdhjetë vjet në Pavionin e Vetmisë së Qashtë. Pas vdekjes së tij, trashëgimtarët nuk gjetën veç dorëshkrime të ngatërruara. Familja, siç duhet ta dini besoj, deshi t’i digjte; por zbatuesi i tij testamentar – një murg taoist a budist – këmbënguli ta botonte.


– Ne të sojit të Ts’ui Pen-it, – iu përgjigja, – ende vazhdojnë ta urrejmë atë murg. Ai botim qe krejt pa mend. Libri s’është veçse një grumbull zhgaravinash kontradiktore. E kam studiuar një herë: në kapitullin e tretë hero i vdes, në të katërtin është i gjallë. Sa për ndërmarrrjen tjetër të Ts’ui Pen-it, Labirintin e tij...

– Ja tek është Labirinti, – tha duke më rrëfyer një tryezë shkrimi të lartë e të lyer me llak.

– Një labirint fildishi! – brita. – Një labirint liliput...

– Një labirint simbolesh, – më korrigjoi. – Një labirint i padukshëm i kohës. Mua, anglezit të pagdhendur më takoi ta zbuloj këtë mister të tejdukshëm. Pas njëqind vjetësh detajet janë pothuaj të pandreqshme, por nuk është e vështirë të kuptohet ajo që ndodhi. Ts’ui Pen-i kishte thënë: *Po shkoj të mbyllem, që të shkruaj një libër*. Dhe më pas: *Po shkoj të mbyllem që të ndërtoj një labirint*. Të gjithë i përfytyruan këto si dy vepra: askujt nuk i shkoi mendja se libri dhe labirinti ishin një vepër e vetme. Pavioni i Vetmisë së Qashtë ngrihej ndoshta në qendër të një kopshti të padepërtueshëm; pikërisht kjo i bëri njerëzit të mendonin për një labirint fizik. Ts’ui Pen-i vdiq; në tokat e tij të paana askush nuk mundi dot ta gjente labirintin. Rrëmuja që karakterizonte romanin e tij më dha idenë se ky ishte labirinti. Dy rrethana më dhanë në dorë zgjidhjen e saktë të problemit. E para: legjenda e çuditshme që rrëfente se Ts’ui Pen-i kish vendosur të ndërtonte një labirint krejt të pafund. E dyta: një fragment letre që zbulova.

Albert-i u ngrit. Më ktheu shpinën për disa çaste; hapi një sirtar të zi dhe bojë ari të tryezës së shkrimit. U kthye me një letër, e cila më parë kishte qenë ngjyrë e kuqe-alle, ndërsa tani ishte rozake, e hollë dhe me kutia. Ts’ui Pen-i e



kishte me hak famën si kaligraf i shquar. Lexova me pasion të pakuptuar fjalët që i kishte shkruar me një penë majëhollë një njeri i gjakut tim: *U lë shumë ardhmërive (jo të gjithave) kopshtin tim me shtigje që bigëzohen*.

I ktheva letrën në heshtje. Albert-i vazhdoi:

– Përpara se ta zbuloja këtë letër vrisja mendjen se qysh mund të ishte një libër i pafund. E vetmja hipotezë në të cilën arrita ishte se duhet të qe një volum ciklik, rrotullues. Një libër që ta kishte faqen e fundit njëlloj me të parën e të gëzonte kështu mundësinë për të vazhduar pafundësisht. M’u kujtua edhe nata që ndodhet në qendër të 1001 Netëve, kur mbretëresha Shahrazad (nga një lajthitje magjike e kopistit) zë e rrëfen fjalë për fjalë historinë e 1001 Netëve, duke rrezikuar të kthehet sërisht në natën kur po rrëfen historinë dhe kështu deri në pafundësi.

Imagjinova, gjithashtu, një vepër platonike, të trashëgueshme, e cila përcillet nga ati te biri dhe ku secili individ i ri shton një kapitull, apo korrigjon me kujdes të përdëlluar faqet e të moçmeve. Këto hipoteza më zbavitën. Por asnjëra prej tyre nuk dukej madje as larg e larg, se përkonte me kapitujt kontradiktorë të Ts’ui Pen-it. Ndodhesha në këtë mëdyshje kur më dërguan që nga Oksfordi dorëshkrimin që sapo këqyrët. U ndala, siç kuptohet, në frazën: *U lë shumë ardhmërive (jo të gjithave), kopshtin tim me shtigje që bigëzohen*. Përnjëherë kuptova; *kopshti me shtigje që bigëzohen* ishte romani kaotik. Frazja *shumëardhmërive (jo të gjithave)*, më shpuri në mendje imazhin e bigëzimit në kohë, jo në hapësirë. Rileximi i përgjithshëm që i bëra veprës, ma vërtetoi këtë teori. Në të gjitha krijimet fantastike, sa herë që njeriu ndeshet me disa mundësi, zgjedh njërën prej tyre dhe i asgjëson të tjerat. Në fantastikën e Ts’ui Pen-it të koklavitur, ai i zgjedh njëkohësisht të tëra. Krijon kështu ardhmëri të ndryshme, kohë të ndryshme që bëjnë dhe bigëzohen. Që këtej rrjedhin kontradiktat e romanit. Fang-u për shembull, mban një të fshehtë. Një i panjohur troket në derën e tij; Fang-u vendos ta vrasë. Natyrisht ka shumë zgjidhje të mundshme: Fang-u mund ta vrasë furracakun, furracaku mund ta vrasë Fang-un, të dy mund të shpëtojnë, të dy mund të vdesin, etj. Në veprën e Ts’ui Pen-it ndodhin të gjitha zgjidhjet; secila është pikënisja e bigëzimeve të tjera. Ka herë kur shtigjet e këtij labirinti mblidhen në një pikë: për shembull, ju tani vini tek unë, por në një nga të kaluarat e mundshme ju jeni armiku im, në një tjetër, miku im. Nëse pranoni të dëgjoni artikullimin tim të pashërueshëm, po ju lexoj disa faqe.

Fytyra e tij në qerthullin e gjallë të llambës, ishte padyshim, fytyra e një plaku, por kishte diçka të pathyeshme, të përjetshme. Lexoi me një saktësi të ngadaltë dy variante të një kapitulli epik. Në variantin e parë, një ushtri që shkon në luftë, kalon përmes një mali të shkretë; llahtari i shkëmbinjeve dhe errësirës i bën ushtarët ta përçmojnë jetën dhe ata e korrin fitoren me lehtësi. Në variantin e dytë, po ajo ushtri kalon përmes një pallati në festë; beteja e shkëlqyer u duket atyre si vazhdimi i festës dhe kthehen me fitore. I dëgjoja me një nderim të singertë ato fantazi të moçme, të cilat ndoshta s’do të më ngjanin aq të admirueshme sikur të mos qenë pjellë e mendjes së një njeriu të gjakut tim dhe sikur të mos m’i kthente sërisht, gjatë një aventure të dëshpëruar në një ishull perëndimor, një njeri që i përkiste një mbretërie të largët. Më kujtohen fjalët e fundit që përsëriteshin në të dy variantet si një komandë e fshehtë: *Kështu luftuan heronjtë*

me zemër të qetë e të lëvdueshme, me shpatë të furishme, të bindur për të vrarë dhe për të vdekur.

Që nga ai çast, rrotull meje, brenda trupit tim të errët, ndjeva një vrujim të padukshëm e të shenjtë. Nuk qe vrujimi i ushtrive që ndaheshin, shkonin paralel dhe më në fund puqeshin në një pikë; ishte një shqetësim më i pakapshëm, më i fshehtë dhe që në njëfarë mënyre, ato e paralajmëronin. Stephen Albert-i vijoi:

– Nuk besoj që stërgjyshi juaj i ndritur të ketë luajtur së koti me variantet e historisë. Nuk ka logjikë që të ketë sakrifikuar trembëdhjetë vjet për t’u marrë me një eksperiment të pafund retorik. Në vendin tuaj, romani është një gjeni letrar e dorës së dytë; ndërsa asaj kohe përçmohej. Ts’ui Pen-i qe një romancier gjenial, por ishte gjithashtu edhe një njeri i letrave që, pa dyshim, asnjëherë nuk e quajti veten romancier safi. Sipas dëshirës së bashkëkohësve – dhe siç e rrëfen ngulmazi jeta e tij – ai kishte shije metafizike dhe mistike. Polemika filozofike pushton një pjesë të mirë të romanit të Ts’ui Pen-it. E di mirë se problemi që e shqetësoi dhe e torturoi më tepër ishte problemi që kishte thellësinë e honit – koha. E megjithatë, ky është i vetmi problem që nuk preket askund te *kopshti*. Ai nuk e përdor fjalën që do të thotë *kohë*.

Si e shpjegoni ju këtë mangësi të vullnetshme?

Propozova zgjidhje të ndryshme; të gjitha të pamjaftueshme. I diskutuam. Më në fund, Stephen Albert-i më tha:

– Në një gjëegjëzë me temë nga loja e shahut, cila është fjala e ndaluar?

U mendova një grimë dhe u përgjigja:

– Fjala *shah*.

– Saktë, – tha Albert-i. – *Kopshti me shtigje që bigëzohen* është një gjëegjëzë gjigande apo një alegori, tema e së cilës është koha; kjo e fshehtë e ndalon përdorimin e emrit të saj. Ta përjashtosh *gjihtmonë* një fjalë, të përdorësh në vend të saj metafora të panevojshme, apo perifrastime të dukshme, është ndoshta mënyra më pedante për ta shprehur atë. Këtë metodë dredharake përdori i tërthorti Ts’ui Pen në të gjitha lakoret e romanit të tij të palidhur. Kam ballafaquar qindra dorëshkrime, kam korrigjuar gjithë gabimet që pat lënë pakujdesia e kopistëve, kam përfytyruar planin e këtij kaosi, kam ngritur në këmbë, ose kam kujtuar se kam ngritur në këmbë, rendin themeltar, kam përkthyer tërë veprën. Më rezulton se nuk ka përdorur asnjëherë të vetme fjalën *kohë*. Shpjegimi është i qartë: *Kopshti me shtigje që bigëzohen* është një imazh i paplotë, por jo i remë i universit, ashtu siç e konceptonte Ts’ui Pen-i. Ndryshe nga Newton-i dhe Schopenhauer-i, stërgjyshi juaj nuk besonte se kishte një kohë të njëjtë, absolute. Besonte se ekzistonte një seri e pafundme kohësh, një rrjet zmadhues e mendjemarrës kohësh divergjente, konvergjente dhe paralele. Kjothurimë kohësh që afrohen, bigëzohen, që priten apo që shpërfillen shekull pas shekulli, zaptin *të gjitha* mundësitë. Në shumën e këtyre kohëve, ne nuk ekzistojmë; në disa prej tyre ekzistoni ju, ndërsa unë jo. Në të tjera, unë po e ju jo; në të tjera ekzistojmë të dy. Në këtë kohë, të cilën po jua jep një rastësi e favorshme, ju keni ardhur në shtëpinë time. Në një tjetër, duke përshkuar kopshtin, ju më keni gjetur të vdekur; në një kohë tjetër, unë them po këto fjalë, por jam një gabim, një fantazmë.

– Në të gjitha kohët, – thashë me një drithërimë në trup, – unë e adhuroj rikrijimin që i keni bërë kopshtit të Ts’ui Pen-it dhe ju falenderoj.

– Jo në të gjitha, – murmuriti ai duke buzëqeshur. –Koha bigëzohet pafund drejt të ardhmeve pambarim. Në një nga ato unë jam armiku juaj.

E ndjeva sërisht atë vrujimin për të cilin tregova. M’u bë se kopshti i lagësht që rrethonte shtëpinë ishte mbushur deri në pafundësi me personazhe të padukshëm. Këta personazhe ishin unë dhe Albert-i, të fshehtë, punëshumë dhe shumëformësh në të tjera përmasa kohe. Ngrita sytë dhe ëndrra e ligë dhe e lehtë u shpërnda. Në kopshtin verdhë e zi ndodhej vetëm një njeri, por ky njeri ishte i fortë si një statujë, por ky njeri afrohej përmes shtegut dhe ishte kapiteni Richard Madden.

– E ardhmja ekziston tashmë, – u përgjigja, – por unë jam miku juaj. A mund ta këqyr edhe një herë letrën?

Albert-i u ngrit. Ashtu, i lartë, hapi sirtarin e tryezës së shkrimit. Më ktheu shpinën për një çast. Unë kisha bërë gati revolverin. E shkrepja me shumë kujdes. Albert-i u plas për tokë në vend, pa bërë as gëk, as mëk. Vdekja e tij qe e menjëhershme: vetëtimë.

Pjesa tjetër është irrealë, pakogjë. Madden-i ia behu dhe më arrestoi. U dënova me varje. Fitova poshtërsisht: i njoftova Berlinin emrin e fshehtë të qytetit që duhet të sulmonin. Dje e bombarduan: e lexova në po ato gazeta që i propozonin Anglisë enigmën e sinologut të famshëm Stephen Albert, që u vra nga i panjohuri Yu Tsun. Shefi e gjeti çelësin e enigmës. Ai e dinte se detyra ime ishte të tregoja (përmes tollovisë së luftës) qytetin e quajtur Albert dhe se nuk gjeta tjetër mundësi veç të vrisja një njeri me këtë emër. Ai nuk e di (askush nuk mund ta dijë) pendimin vdekjeprurës dhe lodhjen time të parrëfyeshme.

ALBANIANS in ART

Ferid HUDHRI

